



# LOGOS

REVISTË SHKENCORE



Kolegji Universitar "LOGOS"  
Adresa: Rr: "Dritan Hoxha"  
përballë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi"  
Tiranë, Albania

E-mail: [info@kulogos.edu.al](mailto:info@kulogos.edu.al)  
Cel: 00355693030277  
[www.kulogos.edu.al](http://www.kulogos.edu.al)

"LOGOS" REVISTË SHKENCORE

7

TIRANË, 2025

7



# **REVISTA LOGOS**

**Nr. 7**

Tiranë, 2025

## **Bordi i Revistës**

### **Kryeredaktor:**

Prof. Ilia Ninka

### **Anëtarë**

Prof. Dr. Artur Ribaj

Prof. Dr. Erleta Mato

Dr. Emira Spahaj

Prof. Asoc. Marsela Harizaj

Prof. Asoc. Ridvana Mediu

Prof. Asoc. Alma Barbullushi

MSc. Violeta Plepi

### **Redaktorë dhe korrektorë letrarë**

Prof. Dr. Erleta Mato

Prof. Asoc. Ridvana Mediu

MSc. Violeta Plepi

## PËRMBAJTJA

### SHKENCA MJEKËSORE

**Donika Mema & Co -Autor: Albana Fico, Alban Ylli, Eugena Tomini, Silva Bino, Blerina Kodra**

Tuberkulozi tek adoleshentët gjatë periudhës pre dhe post covid-19: sfidat dhe ndikimet .....4

**Alketa Bakiri & Sidorela Bilcari, Blerina Resulaj, Erjola Reufi, Ariol Rama, Ridvana Mediu, Tefta Rrota, Ervin Mingomataj**

Përcaktimi i grupeve të gjakut te studentët e laboratorëve mjekësorë dhe përshkrimi i gabimeve të mundshme të fazës pre analitike .....15

**PhD R Nezaj & MD V. Kamberi, MD A. Bitri, Msc R. Rroku.**

Ngrënia, dieta dhe ushqimi për infeksionin UTI tek të rriturit .....27

### SHKENCA EKONOMIKE

**Dr Romina Radoshniqi & Msc. Bledar Radoshniqi**

Punësimi në distancë: një studim krahasues ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë .....45

**MSc. Malvina Hysa, Prof. Asoc. Dori Risilia, MSc. Edisela Mena**

Vendimet financiare afatgjata në praktikën e investimeve .....62

### SHKENCA EDUKIMI

**Dr. Blerta Drenofci**

Arsimi online dhe i kombinuar në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri: sfidat dhe rruga përpara .....67

**Prof. Erleta Çelmeta, Dr. Emira Spahaj, MSc. Jora Mato.**

Arsimi dhe trajnimi online në nivel global .....81

### SHKENCA SOCIALE

**Marinela Pane & Rudina Rama & Juliana Ajdini**

Vlerësim cilësor i nevojave për shërbime në banesë për të moshuarit. (Një studim i fokusuar në Bashkinë Tiranë) .....94

### TUBERKULOZI TEK ADOLESHENTËT GJATË PERIUdhËS PRE DHE POST COVID-19: SFIDAT DHE NDIKIMET

**Donika MEMA**

Mjeke Epidemiologe, Programi Kombëtar i Tuberkulozit  
Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

**Co -Autor: Albana Fico, Alban Ylli, Eugena Tomini, Silva Bino, Blerina Kodra**

#### **Abstrakt**

##### **Hyrje**

Tuberkulozi është një sëmundje infektive e shkaktuar nga bakteri *Mycobacterium tuberculosis*. Sipas një raporti të raportit Global të Tuberkulozit 2023, rreth 1.4 milionë adoleshentë zhvillojnë TB aktiv çdo vit. Në gjithë botën gjatë vitit 2023, 55% e njerëzve që zhvilluan TB ishin burra, 33% ishin gra dhe 12% ishin fëmijë dhe adoleshentë.

##### **Objektivi**

Kryerja e studimit mbi tuberkulozin (TB) tek adoleshentët nga mosha 10-19 vjeç ka si qëllim të ofrojë njohuri të vlefshme për prevalencën, diagnozën, respektimin e trajtimit dhe faktorët psiko- socialë të lidhur me TB tek adoleshentët në Shqipëri .

##### **Materiali dhe metoda**

Për kryerjen e këtij studimi është përdorur studimi cross - sectional. Zgjedhja e metodës së kampionit siguroi që rezultatet e studimit të jenë përfaqësuese dhe të paanshme. Të përfshirë në studim ishin adoleshentët e moshës 10-19 vjeç, me TB të dyshuar ose të konfirmuar me TB për periudhën 2015- 2024.

##### **Rezultatet**

Një total prej 237 adoleshentësh të moshës 10-19 vjeç, ishin përfshirë në studim përgjatë periudhës 2015 – 2024. Sipas shpërndarjes gjinore, 64% ishin meshkuj dhe 36% ishin femra. Shumica e adoleshentëve, rreth 67% vinin nga zonat urbane, ndërsa pjesa tjetër 33% ishin nga rajonet rurale. Përqindja e TB në adoleshentë nga mosha 10-19vjeç për periudhën 2015- 2024, rezultoi mesatarisht 237 (6.7%) nga 3518 në total TB. Prej tyre, 65.4% (155 adoleshentë) kishin forma TB pulmonare dhe 34,6% (82 pjesëmarrës) kishin forma TB ekstrapulmonare.).

##### **Konkluzione**

TB e adoleshentëve kërkon një qasje më të fokusuar që trajton si aspektet mjekësore ashtu edhe psiko- sociale të kujdesit. Nevojiten studime të mëtejshme kërkimore për menaxhimin e TB në këtë grup moshe dhe për të siguruar që asnjë adoleshent të mos mbetet i pa trajtuar nga sëmundja e TB dhe hartimi i udhëzuesve për TB adoleshentët.

**Fjale kyçe:** *Tuberkulozi, adoleshentët, Covid-19*

##### **Hyrje**

Tuberkulozi është një sëmundje infektive e shkaktuar nga bakteri *Mycobacterium tuberculosis*. TB përhapet përmes ajrit kur një person i infektuar kollitet ose teshtin. Zakonisht prek mushkëritë, por mund të përfshijë pjesë të tjera të trupit. Adoloshenca është një periudhë me rrezik të lartë në jetën e një personi për infeksion të ri të tuberkulozit dhe progresion pasues drejt sëmundjes së tuberkulozit. Krahasuar me fëmijët, tuberkulozi në këtë grup moshë është gjithashtu më lehtë i transmetueshëm, duke i bërë adoleshentët të konsiderohen si një popullatë me rrezik të lartë për transmetimin e tuberkulozit në komunitet. Tuberkulozi ka qenë i njohur tek adoleshentët. Megjithatë, kjo situatë po ndryshon dhe tuberkulozi adoleshent kohët e fundit është njohur si një prioritet për shëndetin e adoleshentëve. Adoloshentët dhe të rinjtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të pacientëve që fillojnë trajtimin kundër tuberkulozit, kështu që përmirësimi i rezultateve të trajtimit në këtë popullatë është thelbësor për kontrollin global të tuberkulozit. Sipas një raporti të Raportit Global të Tuberkulozit 2023, rreth 1.4 milionë adoleshentë zhvillojnë TB aktiv çdo vit. Gjatë vitit 2023 në nivelin global, TB u kthye si shkaku kryesor i vdekjes në botë, pas 3 vitesh në të cilat u zëvendësua nga sëmundja korona virus (COVID-19). Vendet që janë më të prekura dhe kanë incidencë të lartë të TB në moshën e adoloshencës janë: India, Indonezia, Afrika e Jugut dhe Brazili. Rreth një e katërta e popullsisë globale vlerësohet të jetë infektuar me TB. Në gjithë botën gjatë vitit 2023, 55% e njerëzve që zhvilluan TB ishin burra, 33% ishin gra dhe 12% ishin fëmijë dhe adoleshentë të rinj. Ashtu si rajonet e tjera, Evropa përjetoi ndërprerje në diagnostikimin dhe trajtimin e TB gjatë pandemisë COVID-19. Studimet sugjerojnë një rënie prej 25-30% të rasteve të reja të TB-së në vitin 2020, me vonesat në trajtim që çuan në rezultate më të këqija për adoleshentët. Tuberkulozi në adoloshencë është një shqetësim i rëndësishëm shëndetësor global, pasi mund të shfaqet me simptoma dhe sfida të ndryshme në krahasim me të rriturit. Pas infeksionit, rreziku i zhvillimit të sëmundjes së TB është më i lartë në 2 vitet e para, afërsisht në 5%. Pandemia e COVID-19 ka sjellë vëmendjen globale ndaj sistemeve të shëndetit publik dhe dobësive të popullatave të ndryshme, përfshirë adoleshentët. Gjatë pandemisë, barra e tuberkulozit është komplikuar nga ndërprerjet në shërbimet e kujdesit shëndetësor, vonesat në diagnostikimin dhe një fokus i reduktuar në parandalimin dhe trajtimin e TB. Adoloshentët janë përballur me sfida të veçanta gjatë COVID-19 dhe ishin në një rrezik më të lartë të TB për shkak të ndryshimit të sistemit të tyre imunitar dhe sjelljeve sociale. Pandemia e COVID-19 ka çuar në ndërprerje të konsiderueshme në programet e TB në mbarë botën. Izolimi gjatë COVID-19 ndikoi rëndë në mundësinë për të diagnostikuar dhe trajtuar TB tek adoleshentët. Për më tepër, stafi i kujdesit shëndetësor shpesh u jepnin përparësi rasteve të COVID-19, duke çuar në zvogëlimin e zbulimit të TB dhe vonesa në diagnozë. Duke qenë se simptomat e tuberkulozit mund të jenë jo specifike ose të ngjajnë me ato të COVID-19, adoleshentët me simptoma të hershme të tuberkulozit mund të jenë diagnostikuar gabimisht ose të mos jenë diagnostikuar fare. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) vlerëson se adoleshentët e moshës 10-19 vjeç përbëjnë rreth 15-20% të të gjitha rasteve me TB në mbarë botën në periudhën e pandemisë COVID – 19. Studimet tregojnë se adoleshentët me HIV dhe TB kanë një rrezik më të lartë, duke përfshirë rritjen e vdekshmërisë, trajtimin e vonuar dhe komplikacione të tilla si TB rezistente. Raporti i OBSH në vitin 2021, vlerësoi se, numri i rasteve të reja me TB ra ndjeshëm me 25-30% globalisht në vitin 2020, për shkak të izolimit dhe ndërprerjeve në shërbimet e TB.

Pandemia e COVID-19 ka sjellë vëmendjen globale ndaj sistemeve të shëndetit publik dhe popullatave të ndryshme vulnerabil, përfshirë dhe adoleshentët. Menaxhimi efektiv kërkon

zbulim të hershëm, diagnozë të saktë dhe një qasje gjithëpërfshirëse trajtimi që përfshin një kombinim të barnave anti-TB për një periudhë të zgjatur, zakonisht 6 muaj. Terapia e vëzhguar drejtpërdrejt (DOT) shpesh rekomandohet për të siguruar aderimin dhe për të parandaluar rezistencën ndaj ilaçit. Në rajonet me prevalencë të lartë të TB-së, vaksinimi me vaksinën Bacillus Calmette–Guérin (BCG) mbetet një masë parandaluese, veçanërisht kundër formave të rënda të TB si meningjiti TB. Shfaqja e TB-së rezistente ndaj shumë barnave (MDR-TB) dhe TB-së gjerësisht rezistente ndaj ilaçeve (XDR-TB) paraqet një sfidë në rritje, duke kërkuar regjime të specializuara trajtimi. Menaxhimi i TB tek adoleshentët duhet të përfshijë gjithashtu gjurmimin e duhur të kontaktit dhe edukimin për të reduktuar rreziqet e transmetimit. Kërkohej veprim urgjent për t'i dhënë fund epidemisë globale të TB deri në vitin 2030, një synim që është miratuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh).

Pavarësisht se në vitin 2024 incindecë e TB në Shqipëri është e ulët rreth 8,7 për 100,000 banorë, rastet me TB janë kryesisht në moshën aktive të popullatës, çka tregon që ata gjithashtu kanë potencialin për përparim më të shpejtë nga infeksioni latent i TB-së, në sëmundjen aktive të TB-së.

## **MATERIALI DHE METODA**

Për kryerjen e këtij studimi është përdorur studimi cross - sectional. Ky studimi synon të ofrojë njohuri të vlefshme për prevalencën, diagnozën, respektimin e trajtimit dhe faktorët psiko-socialë të lidhur me TB tek adoleshentët. Zgjedhja e metodës së kampionit siguroi që rezultatet e studimit të jenë përfaqësuese dhe të paanshme. Gjatë studimit u mbledhën të dhëna për periudhën 2019 - 2024, të cilat janë të dobishme për të kuptuar prevalencën e TB tek adoleshentët dhe faktorët që ndikojnë në të. Të dhënat u mbledhën në bashkëpunim me Programin Kombëtar të Tuberkulozit, me Spitalet Rajonale dhe Njësitë e Kujdesit Shëndetësor Parësor në gjithë Shqipërinë. Popullata e përfshirë në studim: adoleshentët e moshës 10-19 vjeç me TB të dyshuar ose të konfirmuar, me TB pulmonar aktiv, me TB ekstrapulmonar, nga popullata me rrezik të lartë si migrantë dhe individë HIV pozitiv të diagnostikuar në Shqipëri nga viti 2019 deri në vitin 2024. Kryerja e studimit mbi tuberkulozin (TB) tek adoleshentët kërkoj shqyrtim të kujdesshëm të metodave të përdorura për mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave. Mbledhja e të dhënave u krye në sajë të kartelave të pacienteve duke u bazuar kryesisht në treguesit kryesor epidemiologjik dhe klinik si dhe në pyetësorët përkatës, kryesisht në informacionin për: moshën, gjininë, arsimin, statusin socio-ekonomik, kontaktet e mëparshme të TB, sëmundjet shoqëruese, faktorët e rrezikut të TB-së si statusi i HIV, në aderimin e trajtimit, raportimi i efekteve anësore, rezultatet laboratorike nga testimi i TB dhe suksesi i mjekimit. Duke përdorur një kombinim të mjeteve diagnostikuese, pyetësorëve, vlerësimeve vijuese dhe metodave cilësore, studimi tregoi një pamje më të mirë dhe të qartë të TB në këtë grup moshë, ku rezultatet e këtij studimi do të ndihmojnë në hartimin e strategjive më efektive të kontrollit të TB, rezultate më të mira për pacientët dhe reduktim të transmetimit të sëmundjes së TB-së.

## **Rezultatet**

Një total prej 237 adoleshentë të moshës 10-19 vjeç ishin përfshirë në studim përgjatë periudhës 2015 - 2024. Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 17.06 vjeç ( $\pm 1.8$ vjet). Përafërsisht 87% e pjesëmarrësve ishin midis 15-19 vjeç dhe 13% ishin midis 10-14 vjeç. Sipas

shpërndarjes gjinore, 64% ishin meshkuj dhe 36% ishin femra. Shumica e adoleshenteve rreth 67% vinin nga zonat urbane, ndërsa pjesa tjetër 33% ishin nga rajonet rurale. 65% e pjesëmarrësve vinin nga familje me të ardhura të ulëta dhe 35% ishin nga familje me të ardhura mesatare. Prevalenca e TB në adoleshentët nga moshë 10-19 për periudhën 2015- 2024 rezultoi mesatarisht 237 (6.7%) nga 3518 në total TB. Prej tyre, 65.4% (155 adoleshente ) kishin forma TB pulmonare dhe 34,6% (82 pjesëmarrës) kishin forma TB ekstrapulmonare. Gjatë kontrollit të personave të kontaktit të adoleshentëve me TB aktiv rezultoi që: prej 13.3% (42 nga 316 persona kontakti ) të cilët u testuan me tuberkulen test (TST) rezultuan pozitivë për infeksionin latent të TB (LTBI). Adoleshentët që referonin se herë pas here kishin jetuar dhe jashtë vendit në statusin e migrantit, rezultuan rreth 2% krahasuar me adoleshentët jo-migrantë që zinin rreth 4.7% me një sinjifikancë ( $p < 0.05$ ). Në vitin 2017 migrimi i moshës 10- 19 vjeç ka qenë më e theksuar ku dhe një pjesë e madhe e familjeve shqiptare emigruan në vendet si Gjermani, Francë dhe Itali. 68% e adoleshentëve të përfshirë në studim ishin testuar për HIV dhe vetëm një pacient 19 vjeç, student, rezultoi HIV-pozitiv. Nga mikroskopia e sputumit për TB kanë rezultuar pozitivë 47% të adoleshentëve me TB pulmonar. Testimi i shpejtë molekular me GeneXpert MTB/RIF, filloi për herë të parë në Shqipëri në Qershor të vitit 2019 dhe nga 2019 e deri në 2024 zbuloi sëmundjen e TB në 79.3% të adoleshentëve.

Nga ekzaminimet me radiografi të gjoksit u gjetën ndryshime në mushkëri për TB, në 70% të adoleshentëve të diagnostikuar me TB pulmonar. Format TB ekstrapulmonare ishin më të zakonshme për TB pleurit dhe versament pleural me 26% , nyjet limfatike në 2,5 % të rasteve, meningitet tuberkulare 1.7% të ndjekura nga format e tjera të rralla TB ekstrapulmonare në 4.4%. Trajtimi i mjekimit u bazua në protokollin klinike të mjekimit të TB nga 6 - 9 muaj. 94% e adoleshentëve me TB iu përmbajt regjimit të plotë të trajtimit ndërsa 6% humbën nga ndjekja ose e ndërprejnë trajtimin para kohe. Shkalla e përgjithshme e suksesit të trajtimit për TB ishte 94%. Një pacient me MDR-TB që u evidentua gjatë studimit e përfundoi me sukses mjekimin me medikamentet e linjës së dytë TB. Mjekimi i pacientit MDR-TB zgjati 18 muaj sipas protokollit të mjekimit. 1.7% e adoleshentëve me TB të cilët ndërprejnë mjekimin u rikthyen përsëri si pacient me TB brenda 12 muajve. Gjatë marrjes së mjekimit pacientët me TB të moshës 10 – 19 vjeç, referuan disa efekte anësore në muajin e parë të mjekimit. Efektet anësore më të zakonshme ishin të përziera (në 35% të rasteve), toksiciteti i mëlçisë (në 4%) dhe neuropatia periferike (në 1%). Adoleshentët me TB raportuan nivele më të larta të ankthit dhe frikës në krahasim me popullatën e përgjithshme adoleshente në javët e para të fillimit të mjekimit. 71% e pjesëmarrësve raportuan se kishin përjetuar stigmë sociale në lidhje me diagnozën e tyre të TB, me 47% që ndiheshin të izoluar nga miqtë dhe shoqëria apo të afërt të familjes. 16 % e adoleshentëve me TB të moshës 15 - 19 vjeç, referuan se pinin duhan në mënyrë të rregullt, dhe 10 % referuan se pinin rrallë, mesatarisht 1- 2 cigare në ditë. Djemtë adoleshentë ishin më të prirur për pirjen e duhanit sesa vajzat, por këto 3 vitet e fundit kishte një tendencë rritje edhe tek vajzat.

Adoleshentët me TB humbën mesatarisht 45 ditë shkollë gjatë trajtimit, dhe hasën vështirësi për t'u rintegruar në shkollë pas shërimit jo vetëm për mësimet, por dhe distancimit të shoqërisë. Adoleshentët që u përballën me nivele më të larta të stigmës sociale kishin një shkallë dukshëm më të ulët të ndjekjes së trajtimit ( $p < 0.01$ ). Ata me mbështetje të fortë familjare kishin më shumë gjasa t'i përmbaheshin regjimit të përshkruar për TB ( $p < 0.05$ ) pa pasur rrezik për ndërprerje të mjekimit. Terapia e vëzhguar drejtpërdrejt (DOT) u zbatua kryesisht në 90% të adoleshentëve, në mbështetje me personelin shëndetësor dhe familjarët e

tyre gjatë fazës së marrjes së mjekimit. Prevalenca TB është një çështje e rëndësishme shëndetësore në mesin e adoleshentëve, me 6.7% të adoleshentëve kryesisht TB pulmonare. GeneXpert MTB/RIF që ofron një diagnozë të shpejtë dhe të besueshme, veçanërisht në rastet e TB-së rezistente ndaj rifampicinës dhe radiografia e gjoksit janë mjete efektive për diagnostikimin e TB tek adoleshentët. Shkalla e suksesit të trajtimit ishte e lartë për TB pulmonare në 94 %, ndërsa 6% e adoleshentëve nuk e përfunduan trajtimin e tyre. TB ka një ndikim të rëndësishëm në shëndetin mendor të adoleshentëve dhe stigma vazhdon të jetë një pengesë për diagnostikimin e hershëm dhe respektimin e trajtimit. Duhet ndërhyrje të reja që të synojnë për përmirësimin dhe respektimin e trajtimit, për të reduktuar stigmën dhe për të adresuar sfidat e shëndetit mendor me të cilat përballen adoleshentët me TB.

Studimi vuri në dukje se, tek pacientët me tuberkuloz, adoleshentët ishin veçanërisht të prekshëm si ndaj TB ashtu edhe ndaj COVID-19, por format e TB Pulmonar ishin më të rënda gjatë COVID-19, se para COVID-19. Kjo si pasojë e vonës së kontrollit tek mjekët dhe frika ndaj pandemisë. Këto rezultate sugjerojnë se pandemia ka ndikuar ndjeshëm në kujdesin ndaj tuberkulozit për adoleshentët, duke e bërë më të vështirë diagnostikimin e sëmundjes TB. Studimi zbuloi se adoleshentët me TB raportuan se kishin përjetuar ankth dhe frikë gjatë trajtimit të tyre në kohën e pandemisë, kryesisht për shkak të stigmës dhe izolimit që erdhi nga diagnostikimi me TB, si sëmundje ngjitëse . Adoleshentët me TB u përballen me stigmë sociale, duke çuar në mungesat në shkollë, përjashtim social dhe vonesa në fillimin e trajtimit. Këto gjetje theksojnë nevojën për mbështetje të shëndetit mendor dhe strategji për reduktimin e stigmës në programet e TB për adoleshentët. Megjithatë duhet theksuar se gjatë pandemisë COVID-19, adoleshentët në marrjen e mjekimit kanë qenë shumë vigjilentë dhe të kujdesshëm ndaj sëmundjes së TB, gjë që çoi dhe në suksesin e mjekimit të tyre në 100% gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021.

## **DISKUTIMET**

Prevalenca e TB e gjetur në këtë studim përputhet me vlerësimet globale, ku adoleshentët shpesh nuk diagnostikohen ose keqdiagnostikohen për shkak të simptomave jo specifike dhe aksesit të vonuar në kujdesin shëndetësor. Shkalla e suksesit të trajtimit për TB pulmonare në këtë studim (94%) është më e lartë se mesatarja globale, e cila varion nga 80-85%. Ky rezultat nuk duhet të na vetëkënaqë, por të ndikojë në rritjen e vëmendjes së Shëndetit Publik për një kontroll sa më të mirë në shkollë, në luftën kundër TB. Për sa i përket ndikimit psiko-social, gjetjet tona për nivele të larta të stigmës dhe shqetësimit të shëndetit mendor tek adoleshentët me TB janë në përputhje me studimet e vendeve të tjera gjatë vitit 2019 dhe 2020. Adoleshentët me TB shpesh përjetojnë izolim social, ankth dhe frikë, të cilat mund të dëmtojnë respektimin e trajtimit dhe të përkeqësojnë rezultatet shëndetësore. Ky studim thekson rëndësinë e GeneXpert MTB/RIF në diagnostikimin e shpejtë të TB-së, veçanërisht në mjedise me shkallë të lartë të TB-së rezistente ndaj medikamenteve TB. Ndërsa pandemia COVID-19 ka krijuar sfida të rëndësishme për kontrollin e TB, ka disa masa që mund të merren për të siguruar që adoleshentët me TB të marrin kujdesin dhe vëmendjen që u nevojitet, vaksinimi me vaksinat e COVID-19 i adoleshentëve që kishin dhe sëmundjen e TB gjatë pandemisë sipas gjetjeve të studimit ishte në 5% për periudhën 2019 -2021 . Për të përmirësuar më shumë kontrollin e TB tek adoleshentët edhe pas pandemisë, është thelbësore të përqendrohemi në identifikimin e adoleshentëve që mund të jenë në rrezik të TB. Kjo përfshin integrim më të mirë të shqyrtimit të TB me kujdesin për COVID-19 dhe akses të përmirësuar në testim, veçanërisht për

adoleshentët në komunitetet me rrezik të lartë. Ndërsa sistemet e kujdesit shëndetësor u përshtaten me situatën e COVID-19, telemjekësia dhe konsultimet në distancë kanë rezultuar efektive në ruajtjen e vazhdimësisë së kujdesit. Adoleshentët me TB mund të përfitojnë nga konsultimet virtuale, të cilat mund ti ndihmojnë ata të qëndrojnë në rrugën e duhur me trajtimin e tyre dhe të marrin këshilla pa pasur nevojë të vizitojnë klinika të mbushura me njerëz. Fushatat ndërgjegjëse për TB dhe COVID-19 mund të ndihmojnë në reduktimin e stigmës dhe inkurajimin e adoleshentëve për të kërkuar kujdes mjekësor. Këto fushata duhet të përqendrohen në faktin se TB është e trajtueshme dhe e shërueshme, duke edukuar gjithashtu komunitetet për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit. Pas pandemisë COVID-19, fuqizimi i sistemeve të kujdesit ndaj tuberkulozit ishin thelbësore. Kjo tregon që institucionet e kujdesit shëndetësor të kenë burimet dhe infrastrukturën për të trajtuar TB në mënyrë efektive, veçanërisht për adoleshentët, por jo vetëm. Kujdesi i përmirësuar i bazuar në komunitet, programet e kontrollit të TB dhe Njësitë e Kujdesit Shëndetësor Parësor, të ndihmojnë për të arritur kontrollin e TB edhe në zona të largëta. Adresimi i nevojave të shëndetit mendor të adoleshentëve është kritik, veçanërisht për ata me TB. Sigurimi i këshillimit, grupeve mbështetëse të bashkëmoshatarëve dhe ndërhyrjeve psiko-sociale mund të ndihmojnë në reduktimin e stigmës që lidhet me TB dhe mbështetjen e adoleshentëve përmes sfidave të pandemisë. Forcimi i programeve HIV-TB, infeksioni i HIV dhe TB kërkon kujdes të integruar. Sigurimi që adoleshentët që jetojnë me HIV të testohen rregullisht për TB dhe të marrin trajtim të koordinuar për të dyja sëmundjet është jetike në menaxhimin e shëndetit të tyre. Fushata për reduktimin e stigmës me bazë në komunitet për të përmirësuar pranimin social të adoleshentëve me TB dhe për të promovuar përfshirjen e familjes dhe komunitetit në procesin e trajtimit. Adoleshentët duhet të shmangin kontaktin e ngushtë me individë që dihet se kanë TB aktiv, veçanërisht në mjedise si familjet ose hapësirat e mbushura me njerëz, ku rreziku i transmetimit është i lartë. Nevojiten më shumë studime të fokusuara në ndërhyrjet e shëndetit mendor dhe kujdesin e bazuar në komunitet për tuberkulozin për adoleshentët për të informuar politikat dhe ndërhyrjet e shëndetit publik. Studimi ynë thekson rëndësinë e diagnozës në kohë, mbështetjen e aderimit dhe adresimin e stigmës sociale që përfshin TB. Mjetet diagnostike të përmirësuara, ndërhyrjet psiko-sociale dhe strategjitë e shëndetit publik janë thelbësore për të reduktuar barrën e TB tek adoleshentët dhe për të siguruar rezultate më të mira trajtimi. Studimi i kryer tregoi se adoleshentët me TB pavarësisht frikës dhe stigmës, marrjen e medikamenteve TB e kanë kryer në 94% në mënyrë të rregullt gjatë periudhës 2015 – 2024. Shpërndarja e rasteve me TB në adolehencë është pothuajse në gjithë vendin, por numrat më të lartë janë evidentuar në Tiranë me 107 raste, Durrës 21 raste, Kukës 16 raste, Shkodër 14 raste dhe rrethet e tjera me raste më të pakta. Gjetjet tona sugjerojnë se COVID-19 ka ndikuar ndjeshëm në shërbimet e tuberkulozit edhe pse adoleshentët kanë pasur kryesisht më pak pasojë të rënda shëndetësore nga COVID-19 sesa të rriturit.


## **PËRFUNDIME**

TB e adoleshentëve kërkon një qasje më të fokusuar që trajton si aspektet mjekësore ashtu edhe psiko-sociale të kujdesit. Duke integruar diagnostikimin e shpejtë, mbështetjen e aderimit, shërbimet e shëndetit mendor dhe reduktimin e stigmës në bazë të komunitetit, sistemet e kujdesit shëndetësor mund të përmirësojnë rezultatet për adoleshentët me TB dhe të kontribuojnë në vazhdimësi për kontrollin e TB.


Nevojiten studime të mëtejshme kërkimore për menaxhimin e TB në këtë grup moshe dhe për të siguruar që asnjë adoleshent të mos mbetet i pa trajtuar nga sëmundja e TB.

Rritja e ndërgjegjësimit, programet e promocionit dhe aksesit më i mirë i kujdesit shëndetësor mund të bëjnë një rrugë të gjatë në përmirësimin e rezultateve për adoleshentët me TB, duke kontribuar përfundimisht në përpjekjet globale për të eliminuar tuberkulozin

Të dhënat sugjerojnë se TB dhe COVID-19 janë dy sëmundje që ngjasojnë shumë me njëra tjetrën në formën e përhapjes, por dhe në shenja, prandaj kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme. Tuberkulozi duhet të konsiderohet një faktor rreziku për sëmundjen e rëndë COVID dhe pacientët me TB duhet të kenë përparësi për përpjekjet parandaluese të COVID-19, duke përfshirë vaksinimin. Pas pandemisë COVID-19, është thelbësore që shërbimet për tuberkulozin e fëmijëve dhe adoleshentëve të jenë në qendër të planeve strategjike kombëtare. Si prioritet, është e domosdoshme të rishikohen politikat dhe udhëzimet kombëtare për trajtimin e TB për të rriturit, fëmijët dhe adoleshentët, duke u bazuar në planin global të veprimtarisë për TB për vitet 2023-2030 dhe në përpjekje me rekomandimet më të fundit të OBSH.Grafiku;1 Shpërndarja e rasteve me TB në adoleshencë 2015-2024




**Grafiku 2. Shpërndarja sipas grup moshave në vitet 2015- 2024**



**Tabela 1: Sipas grup moshave , gjinisë dhe formave të lokalizuara të TB**

| 10-14 vjeç |         | 15-19 vjeç |         |       |       | 10-14 vjeç |          | 15-19 vjeç     |          |                |            |
|------------|---------|------------|---------|-------|-------|------------|----------|----------------|----------|----------------|------------|
| Viti       | Meshkuj | Femra      | Meshkuj | Femra | Total | Ratio M:F  | Pulmonar | Ekstrapulmonar | Pulmonar | Ekstrapulmonar | Ratio P;EP |
| 2015       | 3       | 1          | 20      | 10    | 34    | 2,09       | 2        | 2              | 21       | 9              | 2,1        |
| 2016       | 2       | 5          | 23      | 11    | 41    | 1,56       | 3        | 4              | 23       | 11             | 1,7        |
| 2017       | 2       | 2          | 31      | 14    | 49    | 2,06       | 2        | 2              | 22       | 23             | 1          |
| 2018       | 3       | 0          | 18      | 9     | 30    | 2,3        | 3        | 0              | 17       | 10             | 2          |
| 2019       | 1       | 2          | 10      | 3     | 16    | 2,2        | 1        | 2              | 9        | 4              | 1,7        |
| 2020       | 1       | 1          | 9       | 4     | 15    | 2          | 2        | 0              | 10       | 3              | 4          |
| 2021       | 1       | 2          | 4       | 6     | 13    | 0,6        | 2        | 1              | 9        | 1              | 5,5        |
| 2022       | 1       | 1          | 7       | 5     | 14    | 1,3        | 2        | 0              | 8        | 4              | 2,5        |
| 2023       | 2       | 0          | 7       | 5     | 14    | 1,8        | 1        | 1              | 9        | 3              | 2,5        |
| 2024       | 1       | 0          | 6       | 4     | 11    | 1,75       | 1        | 0              | 8        | 2              | 4,5        |
| Total      | 17      | 14         | 135     | 71    | 237   | 1,78       | 19       | 12             | 136      | 70             | 1,9        |


**Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve me TB sipas rretheve**



**Tabela 2. Rezultati i mjekimit 2015-2024**

|       | Kuruar | Perfunduar | Nderprere | Not evalutated | Total |
|-------|--------|------------|-----------|----------------|-------|
| Viti  |        |            |           |                |       |
| 2015  | 6      | 28         | 0         | 0              | 34    |
| 2016  | 1      | 40         | 0         | 0              | 41    |
| 2017  | 10     | 35         | 3         | 1              | 49    |
| 2018  | 3      | 23         | 2         | 2              | 30    |
| 2019  | 4      | 12         | 0         | 0              | 16    |
| 2020  | 4      | 11         | 0         | 0              | 15    |
| 2021  | 2      | 11         | 0         | 0              | 13    |
| 2022  | 2      | 9          | 2         | 1              | 14    |
| 2023  | 1      | 10         | 1         | 2              | 14    |
| 2024  | 0      | 11         | 0         | 0              | 11    |
| Total | 33     | 190        | 8         | 6              | 237   |

**Grafiku 4. Suksesi i mjekimit**



## Burimi i të dhënave:

### 1: Programi Kombëtar i Tuberkulozit në Institutin e Shëndetit Publik

## REFERENCA

- Alene KA, Wangdi K, Clements AC. Impact of the COVID-19 Pandemic on Tuberculosis Control: An Overview. Trop Med Infect Dis. 2020 Jul 24;5(3):123 <https://doi.org/10.3390/tropicalmed5030123>. 16. Martinez L, Lo NC, Cords O, Hill PC, Khan P, Hatherill M, et al. Pediatric tuberculosis transmission outside the household: challenging

- historical paradigms to inform future public health strategies. *Lancet Respir Med*. 2019 Jun;7(6):544-552. [https://doi.org/10.1016/s2213-2600\(19\)30137-7](https://doi.org/10.1016/s2213-2600(19)30137-7).
- World Health Organization [homepage on the Internet]. Geneva: World Health Organization [updated 2020 Oct 14; cited 2022 Feb15]. Global tuberculosis report 2020. [Adobe Acrobat document, 232p]. Available from: <https://www.who.int/publications/i/item/9789240013131>.
  - World Health Organization. [homepage on the Internet]. Geneva:
  - World Health Organization [updated 2021 Oct 14; cited 2022 Feb 15]. Global tuberculosis report 2021. [Adobe Acrobat document, 57p]. Available from: <https://www.who.int/publications/i/item/9789240037021>.
  - World Health Organization. (2022). WHO consolidated guidelines on tuberculosis: module 5: management of tuberculosis in children and adolescents.
  - World Health Organization. <https://iris.who.int/handle/10665/352522>. License: CC BY-NC-SA 3.0 IGO
  - Global tuberculosis report 2024. The 2024 edition of the report is based primarily on data gathered by WHO from national ministries of health in annual rounds of data collection. In 2023,...<https://www.who.int/teams/global-tuberculosis-programme/tb-reports/global-tuberculosis-report-2024>
  - <https://jped.elsevier.es/en-pdf-S0021755719304966> Tuberculosis in childhood and adolescence a view from different perspectives
  - Global Burden of Tuberculosis in Adolescents and Young Adults: 1990-2019<https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/38482587/>
  - <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/38228528/> PMID: 38228528 DOI: 10.3760/cma.j.cn112338-20230726-00043
  - Group<https://publications.ersnet.org/content/erj/59/3/2102538#abstract>. The TB/COVID-19 Global Study
  - <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/36400083/>
  - [https://cdn.publisher.gn1.link/jornaldepneumologia.com.br/pdf/2022\\_48\\_6\\_3765\\_english.pdf](https://cdn.publisher.gn1.link/jornaldepneumologia.com.br/pdf/2022_48_6_3765_english.pdf) Clinical forms and diagnosis of tuberculosis in children and adolescents during the COVID-19 pandemic, Michely Alexandrino de Souza Pinheiro<sup>1 a</sup>, Rafaela Baroni Aurilio<sup>1 a</sup>, Ana Alice Amaral Ibiapina Parente<sup>1,2a</sup>
  - WHO coronavirus (COVID-19) dashboard. <https://covid19.who.int/> (accessed June 27, 2022).  
2 Ahmed S, Mvalo T, Akech S, et al. Protecting children in low-income and middle-income countries from COVID-19. *BMJ Glob Health* 2020; 5: e002844. 3 Smith C, Odd D, Harwood R, et al. Deaths in children and young people in England after infection during the first pandemic year. *Nat Med* 2022; 28: 185–92.
  - Roadmap towards ending TB in children and adolescents Third edition, <https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/373949/9789240084254-eng.pdf>
  - Tuberculosis action plan for the EHO European Region, 2023–2030, <https://www.who.int/publications/i/item/9789289060240>

# PËRCAKTIMI I GRUPEVE TË GJAKUT TE STUDENTËT E LABORATORËVE MJEKËSORË DHE PËRSHKRIMI I GABIMEVE TË MUNDSHME TË FAZËS PREANALITIKE

Alketa Bakiri; Sidorela Bilcari, Blerina Resulaj, Erjola Reufi;, Ariol Rama, Ridvana Mediu,  
Tefta Rrota, Ervin Mingomataj

1. Spitali Amerikan, Tiranë, Shqipëri
2. Kolegji Universitar “LOGOS”, Tiranë, Shqipëri
3. Albanian University, Tiranë, Shqipëri
4. Gemeinschaftspraxis für innere Medizin, Diabetologie und Allgemeinmedizin, Frankfurt/Main,  
Gjermani
5. GoGo Quinoa, Quebec, Kanada
6. Universiteti i Tiranës, Shqipëri
7. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë

*“The sun himself is weak when he first rises, and gathers strength and courage  
as the day gets on”  
Charles Dickens*

## Abstrakt

**Hyrje:** Testet për përcaktimin e grupeve të gjakut janë teste të thjeshta dhe të shpejta. Ato kanë rëndësi të veçantë për realizimin e transfuzioneve të sigurta dhe për parandalimin e sëmundjes hemolitike të porsalindurit.

**Qëllimi:** Qëllimi i studimit ka qenë evidentimi i rëndësisë së përcaktimit korrekt të grupeve të gjakut tek subjektet, përcaktimi i grupeve të gjakut sipas sistemit ABO dhe Rhesus tek studentët e Kolegjit Universitar Logos. Duke iu referuar literaturës dhe studimeve të mëparshme, synimi ishte të evidentoheshin gabimet më të shpeshta që ndodhin në fazën preanalitike. Gjatë ekzaminimit të studentëve u vlerësua dhe lidhja mes patologjive dhe grupeve të gjakut. Punimi kishte gjithashtu qëllim informues në lidhje me grupin e gjakut sipas sistemeve dhe shpërndarjen e tyre tek studentët.

**Materiali dhe metoda:** Në studim u përfshinë 100 studentë. Prej tyre 82% ishin femra dhe 18% ishin meshkuj. Moshë mesatare e studentëve që morën pjesë në studim ishte  $21.7 \pm 3.5$ . Për përcaktimin e grupit të gjakut u vlerësua gjaku kapilar. Vlerësimi i grupit të gjakut sipas sistemit ABO dhe Rhesus u krye përmes testit të aglutinimit.

**Rezultatet:** Në studimin e kryer grupi më i shpeshtë i gjakut ishte grupi 0 (48% të rasteve), pasuar nga grupi A (31%), grupi vijues ishte ai B (18%) dhe grupi më pak i shprehur ishte AB (3%). Shpërndarja e grupeve të gjakut sipas sistemit Rhesus (Rh) konsistoi në predominim të faktorit Rhesus pozitiv në 91% të rasteve, ndërsa subjektet me fenotip Rhesus negativ përbënin 9% të rasteve. Shpërndarja e faktorit Rhesus në grupet e gjakut konsistoi: grupi i gjakut A, RhD+: rezultoi në 30% të gjithë pjesëmarrësve në studim dhe Rh- 1%, grupi i gjakut B: RhD+ 16% dhe Rh-2%, grupi i gjakut AB: RhD+3% dhe Rh- 0%, ndërsa grupi i gjakut O: RhD+ 42% dhe Rh- 6%. Në bazë të vetë raportimit, patologjitë ishin të pranishme në subjektet me grup gjaku A (4%), grup gjakut B (2%) dhe në ata me grup gjaku O (4%) sipas përqindjeve të shprehura respektive.

**Diskutim:** Duke ju referuar literaturës mund të pohojmë se ka një lidhje mes patologjive dhe grupeve të gjakut, por sipas studimit tonë nuk u vu re një lidhje sinjifikante mes grupeve të gjakut dhe sëmundjeve. Në këto rezultate të studimit mund të kenë ndikuar një sërë faktorësh p.sh. mosha mesatarisht e re dhe shfaqja e patologjive me kalimin e viteve. Gjithashtu për një studim me natyrë epidemiologjike nevojitet të merret në shqyrtim një popullatë me një numër më të madh subjektsh. Vlerësimi i patologjive ngelet të plotësohet në të ardhmen përmes një studimi tjetër, ku këto sëmundje nuk do të vlerësohen vetëm përmes anamnezës, por duke u bazuar gjithashtu dhe në ekzaminime të tjera specifike në lidhje me patologjitë.

**Konkluzione:** Bashkërendimi i vlerësimit të kujdesshëm të pacientëve, të manifestimeve klinike të tyre e anamnezës së bashku me saktësinë e rezultateve diagnostike në testimet laboratorike duke përfshirë këtu dhe përcaktimin e saktë të grupeve të gjakut ka një rëndësi mjaft të madhe për diagnostikimin, trajtimin e sigurt dhe për të ofruar kujdesin efektiv optimal ndaj pacientit. Grupi më i shpeshtë i gjakut që u ndesh në popullatë ishte grupi i gjakut 0, grupi më i rrallë ishte grupi AB. Për sa i përket shpërndarjes së grupeve të gjakut sipas faktorit Rhesus në bazë të këtij studimi u vlerësua predominimi i subjekteve Rhesus pozitiv. U konstatua një numër i vogël subjektsh Rhesus negativ, pra vetëm një përqindje e vogël e femrave pjesëmarrëse në studim do të kishin nevojë të trajtoheshin për të parandaluar SHP (sëmundja hemolitike e të porsalindurit) në të ardhmen.

## I. Hyrje

Testi për përcaktimin e grupeve të gjakut është një test i thjeshtë dhe i shpejtë që kryhet në çdo laborator mjekësor (Shytaj K et al, 2007). Ky test konsiston në një ekzaminim të thjeshtë, por dhe shumë të rëndësishëm për përcaktimin e grupeve të gjakut sipas sistemit AB0 dhe atij Rhesus. Grupet e gjakut janë zbuluar në shekullin e 19-të dhe kanë qënë një hap i rëndësishëm në fushën e mjekësisë në lidhje me transfuzionet. Përpara këtij zbulimi mendohej se të gjitha qëniet e gjalla kishin grup gjaku të njëjtë dhe ky koncept i gabuar çoi më pas në transfuzione fatale. Përcaktimi i grupeve të gjakut bëhet në bazë të dy sistemeve kryesore AB0 me grupet A, B, AB,0 dhe sistemit Rh, sipas të cilit vlerësohet prania ose mungesa e antigjenit D në sipërfaqe të eritrociteve. Pra individët që kanë në sipërfaqe të eritrociteve antigjenin D klasifikohen si RhD pozitiv dhe ata që karakterizohen nga mungesa e këtij antigjeni klasifikohen si Rh-negativ. Sistemi Rhesus është njohur më vonë sesa sistemi AB0. Këto dy

sisteme ABO dhe Rh janë të pavarur nga njëri-tjetri. Antigjenët që përcaktojnë grupin e gjakut ABO nga përbërja kimike janë karbohidrate dhe lokusi që përcakton sistemin ABO lokalizohet në nivelin e kromozomit 9. Antigjenët që përcaktojnë sistemin Rh nga përbërja kimike janë proteina dhe lokuset që përcaktojnë sistemin Rh lokalizohet në nivelin e kromozomit 1 (Yamamoto F, 1990). Nga këndvështrimi klinik sistemi Rh është më i rëndësishëm se sistemi ABO, pasi sistemi Rh është më shumë antigjenik. Shënuesit antigjenikë që ndodhen në membranën e eritrociteve përcaktojnë dhe grupin e gjakut (Heier HE, 1994). Përcaktimi i saktë i grupeve të gjakut ka shumë rëndësi pasi na ndihmon në kryerjen me sukses të transfuzioneve të gjakut, në realizimin e sukseshëm të transplantave, në parandalimin e sëmundjes hemolitike të porsalindurit, në kërkimet në kriminalistikë dhe në studimin e popullatave të ndryshme (Urbaniak SJ, 2000; Letsky EA, 2000; Schafer AI, 2000; Schmidt P, 2001; Dean L, 2005, Mourant AE, 1954; Farhud DD, 2013; Mourant AE 1958).

## **Testet për përcaktimin e grupeve të gjakut**

### **Testi i aglutinimit**

Testi i aglutinimit për përcaktimin e grupeve të gjakut sipas dy sistemeve ABO dhe Rh është testi më i thjeshtë që përdoret shpesh në laboratorët mjekësorë. Reagentët që ndërmjetësojnë këto reaksione janë: Anti-A, Anti-B, Anti-AB për sistemin ABO dhe Anti-D për sistemin Rh. Këta janë reagentë të gatshëm që përmbajnë antitrupe për secilin grup gjaku. Reagentët përzihen me gjakun e pacientit, ku janë të pranishme eritrocite që kanë në sipërfaqen e tyre antigjenët që luajnë rol në tipizim. Miksimi në mënyrë të barabartë i antigjenëve që ndodhen në eritrocite dhe antitrupeve çon në formimin e aglutinimit. Në pllakën ku do të ndodhë aglutinimi përcaktohet dhe grupi i gjakut. Nëqoftëse aglutinimi ndodh pas rënies në kontakt të eritrociteve me antitrupe anti-A (drejtuar ndaj antigjenit A) grupi i gjakut rezulton A, nëqoftëse aglutinimi ndodh pas rënies në kontakt të eritrociteve me antitrupe Anti-B grupi i gjakut rezulton B dhe nëqoftëse aglutinimi ndodh pas rënies në kontakt të eritrociteve me antitrupe Anti-A, Anti-B grupi i gjakut rezulton AB. Nëse nuk vërehet aglutinim me antitrupe të drejtuar ndaj antigjenëve që i përkasin sistemit ABO atëherë individi rezulton me grup gjaku O. E njëjta procedurë ndiqet dhe për sistemin Rh: nëse aglutinimi formohet në kontakt me reagentin Anti-D individi rezulton Rh pozitiv. Ky test shfrytëzon parimin e bashkëveprimit antitrup antigjen (Schafer AI, 2001; Sulcebe G, 2001; Mingomataj E, 2011; Dean L, 2005; Auf der Maur C, 1993).

### **Testet e përputhshmërisë së kryqëzuar (Cross-matching)**

Testi i aglutinimit shërben për përcaktimin e pranisë së antigjenëve të sistemit ABO dhe Rh të grupeve të gjakut, por ekzistojnë dhe antigjenë të tjerë që janë më pak të zakonshëm, që nuk përcaktohen me anë të testit të aglutinimit, por që gjatë një transfuzioni gjaku mund të çojnë në reaksione hemolitike. Për të evidentuar antitrupe që ndodhen në serum të pacientit dhe për të parë nëse gjaku mund të përdoret për transfuzion përdoret testi i përputhshmërisë së kryqëzuar. Procedura konsiston në përzierjen e serumit të marrësit me qelizat e kuqe të dhuruesit që të vlerësohet nëse marrësi ka krijuar antitrupe ndaj antigjenëve të dhuruesit. Duhet

treguar kujdes që gjatë marrjes së mostrës gjaku i pacientit nuk duhet të jetë ruajtur më gjatë se 72 orë, pasi përmes kësaj metode sero logjike do të evidentoheshin antitrukat e pacientit. Gjithashtu, reaksioni duhet të realizohet në temperaturën 37 gradë Celsius. Përdoret serumet e pacientit që do të marrë gjakun, pasi në serum ndodhen antitrukat dhe merret gjaku i donatorit, pra masa eritrocitare pasi antigjenet janë të pranishëm në sipërfaqen e eritrociteve. Nëse gjatë miksimit të serumit dhe gjakut të dhuruesit nuk vërehet hemolizë atëherë ky gjak ishte i përputhshëm dhe mund të përdoret për transfuzione. Është shumë e rëndësishme që para çdo transfuzioni të kryhet ky test (Darrell J, 2000; Dean L, 2005).

## Testi Coombs

Testi Coombs shërben për vlerësimin e pranishmësisë së antitrupeve në sipërfaqe të eritrociteve ose në gjak. Ky test klasifikohet si:

- Coombs direkt
- Coombs indirekt

**Coombs direkt** është testi që përcakton praninë e antitrupeve që ndodhen në sipërfaqe të eritrociteve. Antitrukat mund të jenë të tipit IgG. Procedura konsiston në inkubimin e eritrociteve me reagentin antiglobulinë ose Coombs, e nëse aglutinimi ndodh testi rezulton pozitiv. Pra kemi prani të antitrupeve në eritrocite që do të çonte në shkatërrimin e tyre. Një rezultat pozitiv mund të jetë dhe për shkak të anemisë hemolitike autoimmune (Coombs RRA, 1945; Stanford Medicine, 2025; Dean L, 2005).

**Coombs indirekt** është testi që përcakton praninë e antitrupeve të lirë në gjak. Testi përcakton kryesisht antitrukat e tipit IgG. Procedura konsiston në miksimin e serumit të pacientit dhe reagentit Coombs dhe më pas inkubimin në temperaturën 37 gradë celsius. Nëse ky test rezulton pozitiv teste të tjera specifike duhet të kryhen më pas për të përcaktuar llojin e antitrupeve (Schafer AI, 2001; Shytaj K et al, 2007, Dean L, 2005).

Gabimet më të shpeshta që ndodhin në fazën pre analitike të përcaktimit të grupit të gjakut janë:

- Regjistrimi i gabuar i rezultateve pasi në laboratorë mund të drejtohen shumë pacientë për ekzaminime për përcaktimin e grupit të gjakut apo dhe gjatë regjistrimit të rezultateve mund të kryhen gabime.
- Ngatërrimi i radhës së reagentëve: Gjithmonë reagentët Anti-A, Anti-B, Anti-AB, Anti-D vendosen sipas një renditje të caktuar. Mos respektimi i kësaj renditjeje do të çonte në gabime.
- Reagentë të kontaminuar: duhet të tregohet kujdes që çdo reagent të ruhet i pastër dhe të mos ndodh kontaminimi me gjak ose me reagentë të tjerë.
- Miksimi i mostrave: mund të ndodhë që gjatë testit të ngatërrohen mostrat që duhen për miksim. Kjo ndodh kur duam të kryejmë teste të tjera si Cross-match ku do përziejmë serumet e marrësit me masën eritocitare të dhuruesit, për të zbuluar nëse gjaku mund të përdoret për transfuzion.

- Temperatura gjatë kryerjes së testit nuk duhet të jetë e lartë, pasi antitrukat e tipit IgM nuk reagojnë mirë në temperatura të larta dhe kjo mund të ndikojë në rezultate falls negative.

## **II. Qëllimi i studimit**


Studimi kishte për qëllim:

- Përcaktimin e shpërndarjes së grupeve të gjakut sipas sistemit ABO dhe Rhesus në studentët e Kolegjit Universitar Logos;
- Vlerësimin e riskut tek studentët për të patur fëmijë me SHP;
- Përcaktimin e gabimeve kryesore të fazës preanalitike;
- Vlerësimin e një lidhje të mundshme mes grupeve të gjakut dhe sëmundjeve;
- Informimin e studentëve në lidhje me grupin e gjakut që ata posedonin.

## **III. Materiali dhe metoda**

Në studim u përfshinë 100 studentë, nga të cilët 82 ishin femra dhe 18 meshkuj. Ekzaminimi i subjekteve të marrë në studim u krye përgjatë muajit maj të vitit 2016. Objekt i studimit ishin studentët e vitit të parë, të dytë dhe të tretë të degës Teknikë e Lartë Laboratorësh Mjekësorë në Kolegjin Universitar “Logos” (grupi i gjakut të ekzaminuar dhe patologjitë e pranishme). Për secilin student u hartua një skedë të dhënash personale. Për përcaktimin e grupeve të gjakut u vlerësua gjaku kapilar dhe u përdor testi i aglutinimit. Studentët u njohën me rezultatet e ekzaminimit.

Reagentët që u përdorën: alkool, pambuk, lancetë, pllakë për vlerësimin e aglutinimit, reagentët Anti-A, Anti-B, Anti-AB, Anti-D.




*Figura 3.1 Pamje nga puna në laborator.*

#### **IV. Rezultatet**

Nga 100 studentët e përfshirë në studim, 18 ose 18% ishin meshkuj dhe 82 ose 82% femra. Moshë mesatare e studentëve ishte  $21.7 \pm 3.5$ .


Shpërndarja e grupeve të gjakut sipas sistemit ABO paraqitet në grafikun 1. Nga të dhënat e studimit vërehej se grupi më i shpeshtë ishte grupi i gjakut 0, i cili përbënte 85% të popullatës nga të cilët 85.5% ishin femra dhe 14.5% meshkuj. Pas grupit 0 grupi më i shpeshtë ishte grupi A. Subjektet me këtë grup përbënin 31 % të pjesëmarrësve në studim, ku 87.1 % ishin femra dhe 12.9 % ishin meshkuj. Grupi i gjakut vijues për nga shpeshtësia ishte grupi B, rezultuan 18% e subjekteve të marrë në studim me këtë grup gjaku dhe nga këta 72.2% ishin femra dhe 27.8% meshkuj. Grupi i gjakut më pak i shprehur në studentët që u përfshinë në studim ishte grupi AB, që përbënte 3% të ekzaminuarve dhe nga këta 66.6% ishin femra dhe 33.3% meshkuj.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas sistemit ABO të gjakut




Në grafikun 2 në vijim paraqitet shpërndarja e grupeve të gjakut sipas sistemit Rhezus. Vërehej një predominim i antigenit D në studentët pjesëmarrës dhe konkretisht 91% e personave të ekzaminuar ishin Rhezus pozitiv dhe prej tyre 85.7% rezultojnë femra dhe 14.3% meshkuj. Vërehej një numër i vogël studentësh që u konstatuan Rhezus negativ, pra vetëm 9% e tyre dhe prej tyre 55.6% ishin femra dhe 44.4% meshkuj.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas sistemit Rhezus




Grafiku 3 paraqet sëmundjet e raportuara tek studentët ku përfshiheshin: patologjitë gastrointestinale që ishin të pranishme në 3% të pjesëmarrësve, nga të cilët 66.7% ishin femra dhe 33.3% meshkuj, anemia u vlerësua e pranishme vetëm në 5% të subjekteve të marrë në studim dhe ishin 100% femra, ndërsa me perikardit, kiste (intervente për to), infeksione stafilokoksike dhe mbartës të talasemisë rezultuan vetëm 1% e studentëve dhe 100% ishin po ashtu të gjinisë femërore.

Grafiku 3. Variabiliteti i patologjive të raportuara nga subjektet




Grafiku 4 paraqet shpërndarjen e patologjive gastrointestinale sipas grupeve të gjakut dhe nga të dhënat rezultoi se: vetëm 1% e subjekteve me grup gjaku A shfaqën probleme gastrointestinale dhe ishin 100% meshkuj. Ndërsa nga studentët me grup gjak B dhe 0, 10% e tyre shfaqën patologji gastrointestinale dhe ishin 100% femra. Nga studimi rezultoi se patologjitë gastrointestinale sipas sistemit Rhexus ishin të pranishme në studentët RhD+ vetëm në 3% të tyre, nga të cilët 66.7% ishin femra dhe 33.3% ishin meshkuj.

Grafiku 4. Shpërndarja e patologjive gastrointestinale sipas grupeve të gjakut



Patologjitë hematologjike janë paraqitur në grafikun 5. Rezultuan me anemi dhe mbartës të talasemisë 2% e studentëve me grup gjaku A, 1% nga ata me grup gjaku B, dhe 3% e tyre me grup gjaku O, të gjitha femra. Sipas faktorit Rhexus, nga subjektet që rezultuan RhD+ vetëm 5% e tyre kishin sëmundje si anemi apo raportonin të ishin mbartës të talasemisë, ndërsa nga ata Rh- vetëm 1% e tyre, të gjitha femra.

Grafiku 5. Patologjitë hematologjike (anemi/talasemi e mbartur) të shpërndara sipas sistemit ABO dhe Rhexus



## V. Diskutim

Ky studim u realizua duke kryer testin e përcaktimit të grupit të gjakut tek 100 studentët e Kolegjit Universitar “Logos”. Për përcaktimin e grupit të gjakut u vlerësua gjaku kapilar dhe përcaktimi i grupeve të gjakut u bazua në testin e aglutinimit duke respektuar raportin 1 me 1 (një pikë gjak për një pikë reagent) dhe duke shmangur gabimet e mundshme të fazës pre analitike. Në përfundim të mbledhjes së të dhënave u analizuan të dhënat e grumbulluara dhe u ndërtuan grafikët dhe tabelat përkatëse.

U përcaktua shpërndarja e grupeve të gjakut sipas sistemit ABO. Nga studimi rezultoi që grupi i gjakut që u has më shpesh ishte grupi 0. Ai ndiqej nga grupi A, e më pas vjen ai B, ndërsa grupi më i rrallë rezultoi AB. Shpërndarja e grupeve të gjakut sipas sistemit Rhexus rezultoi me predominim të subjekteve Rhexus pozitiv.

Sipas literaturës (O'Donnell JS, 2001; Jill JC, 1987; Miller LH, 1976) vërehen shoqërime të grupeve të veçanta të gjakut me disa sëmundje. Ulcera gastrike haset më shpesh tek personat me grup gjaku O, subjekte këta që kanë prirje për përqendrim të ulura të faktorit Ëillebrand dhe faktorit VIII, faktorë të cilët përfshihen në koagulimin e gjakut (Alkebsi L et al, 2018) . Personat me grup gjaku A janë më shumë të rrezikuar për të pasur kancer të stomakut (Yu H et al, 2020). Gjatë studimit tonë nuk u vu re një lidhje sinjifikante midis sëmundjeve të përmendura dhe grupeve të gjakut, kjo ndoshta dhe për shkak të numrit të vogël të rasteve të përfshira në studim. Po kështu, duke pasur parasysh që për këto sëmundje u mor në konsideratë anamneza dhe jo vlerësimi nga mjeku specialist apo përmes ekzaminimeve të tjera laboratorike dhe konfirmuese diagnostike. Në këto rezultate ndikoi dhe fakti që mosha e subjekteve të përfshirë në studim ishte mjaft e re e të rinjtë natyrisht preken nga një numër i reduktuar patologjish. Megjithatë, kemi parasysh dhe faktin që një numër pacientësh edhe pse janë të

prekur nga patologjitë (si anemia, gastritis, etj.) nuk kanë informacion për to, dhe nuk i janë nënshtruar ekzaminimeve të ndryshme të mëparshme për to. Duke qenë se në studim mosha mesatare ishte mjaft e re, dhe duke qenë se të rinjtë nuk pranojnë ose pohojnë me lehtësi praninë e patologjive kur ju kërkohen të dhëna në lidhje me to, mund të rezultojë një prani e parëndësishme sëmundjesh në popullatën e marrë në studim. Për këto arsye, për të vlerësuar në mënyrë reale shëndetin e punonjësve të laboratorit dhe të tjerëve shërbejnë kontrollet e vazhdueshme për një diagnostikim dhe vlerësim në dinamikë.

Gjatë kryerjes të testit të përcaktimit të grupeve të gjakut u tregua kujdes në lidhje me parandalimin e gabimeve që ndodhin gjatë fazës pre analitike. Reagentët u vendosën sipas një renditjeje të caktuar (Antikorpet Anti-A, Anti-B, Anti-AB, Anti-D). Gjatë kësaj procedure është respektuar raporti i barabartë 1 me 1 (një pikë gjak është miksuar me një pikë reagent). Gjatë kryerjes së testit të aglutimit u tregua kujdes që reagentët dhe pllaka e qelqit të ishin të pastra, duke u shmangur kontaminimi. Po kështu, dhe regjistrimi i të dhënave u krye në mënyrë korrekte, të vëmendshme e në kohë. Testi është përsëritur nëse aglutinimi nuk ka qenë shumë i dukshëm, ndonëse për këtë qëllim mund të realizohet dhe vlerësimi i mëtejshëm mikroskopik (Shytaj K 2007; Sulcebe G. 2001).

## **V. PËRFUNDIME**

- Përcaktimi i grupit të gjakut realizohet prej vitesh, por sot duke iu referuar numrit në rritje të rasteve të aksidenteve, ndërhyrjeve kirurgjikale, numrit të lartë të lindjeve me secio cezarian, del si për detyrë përcaktimi i saktë i grupeve të gjakut për të realizuar transfuzione të sigurta apo për të parandaluar sëmundjen hemolitike të porsalindurit.
- Përveç grupeve të gjakut A, B, AB dhe O ekzistojnë dhe nëngrupet apo grupe të tjera të gjakut që nuk janë kaq të shpeshta, por që mund të jenë shkak i reaksioneve hemolitike gjatë transfuzioneve apo dhe shkaktarë të SHP.
- Para një transfuzioni gjaku është e rëndësishme që përveç testit të përcaktimit të grupit të gjakut, të kryhen dhe teste të tjera si ai i përputhshmërisë mes marrësit dhe dhuruesit (cross-match).
- Ndërsa vëmendja kryesore gjithmonë është përqendruar në fazën analitike, kërkohet sot për shkak të kërkesës së saktësisë së rezultateve në ekzaminime që është dhe qëllimi final i aktivitetit të punës në laborator, optimizimi e shmangia e gabimeve në fazën para analitike për shkak të kontributit të saj të rëndësishëm në gabimet totale laboratorike.

- Në shmangien e gabimeve një rol thelbësor luajnë programet e edukimit, trajnimit, metodat e automatizuara për vlerësimin e cilësisë së mostrës, monitorimi i cilësisë. Njohja me to e studentëve gjatë viteve të formimit akademik e përmes një gërshetimi të njohurive teorike e praktike, si dhe përmes studimeve të thjeshta statistikore e praktike, e të vazhdueshme dhe përtej ciklit të tyre të plotë të formimit janë gur themeli për të pasur profesionistë e ekzaminime të besueshme. Bashkëpunimi i mëtijshëm ndërmjet personelit laboratorik dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor është vendimtar për të rritur saktësinë dhe besueshmërinë e rezultateve diagnostike, duke përmirësuar qëllimin final të kujdesit ndaj pacientit.

## REFERENCA

- Blancher A. Evolution of the ABO supergene, ISBT Science Series 2013; 8(1): 201-206.
- Sulcebe G. Reaksionet imunologjike te aglutinit. Imunologjia, Tiranë 2001, p. 227-264.
- Mourant AE, Kopec AC, Domanieëska-Sobczak K. THE ABO BLOOD GROUPS. Blackwell Sci Publ, Oxford, 1958. Comprehensive Tables and Maps of World Distribution Occasional Publication No 13 of the Royal Anthropological Institute.
- Yamamoto F, Clausen H, White T, Marken J, Hakomori S. Molecular genetic basis of the histo-blood group ABO system. Nature 1990; 345: 229–233.
- Auf der Maur C, Hodel M, Nydegger UE, Rieben R. Age dependency of ABO histo-blood group antibodies: reexamination of an old dogma. Transfusion 1993; 33: 915-918.
- Stanford Medicine. The Coombs' test. Newborn Nursery 2025, Stanford University. <https://med.stanford.edu/neëborns/professional-education/jaundice-and-phototherapy/the-coombs-test.html>
- Dean L. Bethesda (MD): National Center for Biotechnology Information (US), 2005.
- O'Donnell JS, Lasffan MA. The relationship betëeen ABO histo-blood group, factor VIII and von Willebrand factor. Transfus Med 2001; 11: 343–351.
- Gill JC, Endres-Brooks J, Bauer PJ, et al. The effect of ABO blood group on the diagnosis of von Willebrand disease. Blood 1987; 69: 1691–1695.
- Nordin N, Ab Rahim SN, Wan Omar WFA, et al. Preanalytical Errors in Clinical Laboratory Testing at a Glance: Source and Control Measures. Cureus 2024; 16(3): e57243.
- Heier HE, Namork E, Calkoska Z, et al. Expression of A antigens on erythrocytes of weak blood group A subgroups. Vox Sang 1994; 66: 231–236.
- Shytaj K, Ceka Xh, Pulluqi P. Imunohematologjia, Albpaper - Tiranë, 2007, p. 96.
- Mingomataj E, Bakiri A. Imunologjia. Ufo Press, 2011.
- Farhud DD, Yeganeh MZ. A Brief History of Human Blood Groups. Iran J Public Health 2013; 42(1): 1–6.
- Alkebsi L, Ideno Y, Lee JS, Suzuki SH, Nakajima-Shimada J, Ohnishi H, Sato Y, Hayashi K. Gastroduodenal Ulcers and ABO Blood Group: the Japan Nurses' Health Study (JNHS). J Epidemiol 2018; 28(1): 34–40

- Yu H, Xu N, Li ZHK, Xia H, Ren HT, Li N, Wei JB, Bao HZH. Association of ABO Blood Groups and Risk of Gastric Cancer. *Scand J Surg* 2020; 109(4): 309-313.
- Kramp P. Blutgruppen und Blutfaktoren. In: Hofer H, Schulz AH, Starck D, editors. *Primatologia III*. Karger, Basel, 1960.
- Urbaniak SJ, Greiss MA. RhD haemolytic disease of the fetus and the newborn. *Blood Rev* 2000; 14: 44–61.
- Letsky EA, Leck I, Boëman JM. "Chapter 12: Rhesus and other haemolytic diseases". *Antenatal & neonatal screening* (2nd ed.). Oxford University Press, 2000.
- Miller LH, Mason SJ, Clyde DF, McGinniss MH. The resistance factor to *Plasmodium vivax* in blacks. The Duffy-blood-group genotype, FyFy. *N Eng J Med* 1976; 295(6): 302-304.
- Schmidt P, Okroi M. Also sprach Landsteiner – blood Group ‘O’ or Blood Group ‘NULL’, *Infus Ther Transfus Med* 2001; 28(4): 206–208.
- Schafer AI, Eds. *Goldman's Cecil Medicine*. 24th ed. Philadelphia, Pa: Elsevier Saunders; Goodnough LT. *Transfusion Medicine*, 2011: chap 180.

# NGRËNIA, DIETA DHE USHQIMI PËR INFEKSIONIN UTI TE TË RRITURIT

**PhD R Nezaj MD V. Kamberi, MD A. Bitri, Msc R. Rroku**

<sup>1</sup>*Faculty of Applied Sciences, Logos University College*

<sup>2</sup>*Faculty of Medical Technical Sciences, UMT*

<sup>3</sup>*Faculty of Biotechnology and Food, UBT*

<sup>4</sup>*Family Physician at Health Center No. 9 in Tirana*

## **Abstract**

Urinary tract infections (UTIs) are the most common infections, affecting millions of people each year. They are the most prevalent bacterial infections requiring medical attention, making urine one of the most frequently collected clinical samples for laboratory analysis. Complicated infections occur in patients with anatomical or functional abnormalities of the urinary tract, most commonly in women, when uropathogenic bacteria, usually *Escherichia coli*, ascend from the perineum to the bladder and overcome the host's innate immunity.

The accuracy of diagnosis is improved through urine analysis. Urine culture is crucial in severe, recurrent, or complicated infections and when the diagnosis is unclear, such as in children and the elderly.

Most women with symptoms identified through laboratory analysis do not require further investigation. However, for children, men, and patients with recurrent or severe infections, renal tract imaging, functional testing, and cystoscopy should be considered to rule out underlying anomalies.

Empirical antibiotic treatment, initiated based on symptoms and guided by urine analysis, is suitable for uncomplicated cystitis but should be adjusted based on culture results for more severe infections. Researchers don't think that diet can help prevent or treat bladder infections. Cranberry products including cranberry juice, extract, or pills do not treat existing bladder infections. Some research that cranberry products may help prevent bladder infections, but there isn't enough evidence to be sure. 3

For safety reasons, talk with your health care professional before using dietary supplements, such as vitamins, or any complementary or alternative medicines or medical practices.

Drinking enough liquids can keep you hydrated and help prevent or relieve bladder infections. Water is best.

Therefore, the aim of this study is to gain a deeper understanding of UTIs, their prevalence, the ages and genders most affected, and their prevention and Food treatment. Considering the high prevalence of UTIs, this study is significant as it provides updated information regarding age and gender based on current literature.

**Keywords:** *Urinary Tract Infections (UTI), Laboratory analysis*

**Reference:** [3] Cranberry. National Center for Complementary and Integrative Health. Updated May 2020. Accessed December 26, 2023. <https://nccih.nih.gov/health/cranberry> NIH external link, Last Reviewed April 2024

## **INFEKSIONI I TRAKTIT URINAR**

Infeksioni i traktit urinar (UTI) ndodh kur bakteret patogjene hyjnë në uretër dhe shkaktojnë infeksion dhe inflamacion. Mund të preket vetëm uretra (uretriti), por më shpesh infeksioni arrin në fshikëzën urinare (cistiti). Veshkat gjithashtu mund të përfshihen (pielonefriti),

ndonjëherë duke çuar në UTI të komplikuar, formimin e gurëve dhe/ose sëpseve, UTI-të ndodhin në të gjitha grup moshat. Patogjenët bakterialë e kanë origjinën kryesisht nga flora fekale. *Escherichia coli* (*E. coli*) janë më të zakonshmet ( $\approx 85\%$ ). *Staphylococcus saprophyticus*, *Klebsiella*, *Proteus*, *Enterococcus*, *Pseudomonas* dhe *Staphylococcus aureus* rezistent ndaj metilicilinës (MRSA) gjithashtu mund të shkaktojnë infeksion.

Është vënë re se në disa infeksione të traktit urinar të lidhura me *E. coli*, bakteret patogjene duket se vijnë nga ushqimi. Duke përdorur teknika të përputhjes gjenetike, studiues nga disa vende kanë zbuluar se patogjenet *E. coli* tek gratë me UTI shpesh e kanë origjinën nga produktet e pulës.[\[1\],\[2\]](#)

Tabela e shpendëve duket se vepron si një rezervuar për *E. coli* patogjene, një problem që mund të përkeqësohet nga rezistenca ndaj ilaçeve që lidhet me përdorimin e antibiotikëve në ferma. Cistiti është përgjithësisht një diagnozë klinike dhe ekzaminimi radiologjik zakonisht nuk kërkohet, përveç në raste të caktuara që përfshijnë fëmijë (p.sh., kur janë febrile, kur janë të pranishëm faktorë të njohur rreziku) ose tek meshkujt. Simptomat më të zakonshme të cistitit janë dizuria, shpeshtësia, urgjenca dhe shqetësimi suprapubik. Infeksionet e traktit urinar janë shpesh asimptomatike, megjithatë, veçanërisht tek të moshuarit. Mund të raportohet dhimbje në rajonin suprapubik dhe mund të shfaqet edhe hematuria dhe urina e turbullt. Pacientët me pielonefrit zakonisht paraqesin rritje të temperaturës, nauze/të vjella dhe dhimbje kostovertebrale ose në krah.

Tek personat e moshuar, konfuzioni dhe ndryshimet e tjera të statusit mendor mund të jenë shenjat e vetme të një infeksioni të traktit urinar. Te fëmijët, simptomat zakonisht përfshijnë nervozizëm, ndryshime në zakonet e të ngrënit, mosmbajtjeje dhe diarre. Të vjellat ose ndjesia e zbrazjes jo të plotë mund të jetë simptoma e vetme tek vajzat e reja.

### **Ndikimi i të ushqyerit në ITU**

Roli i dietës në parandalimin dhe trajtimin e infeksionit të traktit urinar mbetet i pazgjidhur. Siç u përmend më lart, bakteret patogjene me origjinë nga produktet e pulës mund të kalojnë nëpër traktin e zorrëve përpara se të arrijnë në uretrën. Mbetet për t'u përcaktuar nëse shmangia e kontaktit me pulën mund të zvogëlojë incidencën e ITU.

Disa strategji ushqimore me mbështetje anekdotike (p.sh. vitamina C, marrja e lartë e lëngjeve) nuk kanë demonstruar efektivitet klinik. Të tjera, si lëngu i boronicës së kuqe, janë dëshmuar efektivë në disa prova klinike. [9] Akoma të tjera, si trajtimi me probiotikë dhe dietat me fibra të larta, presin vlerësime të mëtejshme. Në studimet epidemiologjike ose klinike, faktorët e mëposhtëm shoqërohen me ulje të rrezikut:

**Ushqyerja me gji.** Imunoglobulina sekretore A (sIgA) në qumështin e gjirit parandalon zhvendosjen e baktereve të zorrëve nëpër mukozën e zorrëve duke bllokuar ndërveprimet midis baktereve dhe rreshtimit epitelial të zorrëve. Ushqyerja me gji gjithashtu ndryshon kolonizimin e zorrëve, duke arritur një prezencë të reduktuar të tipit P-fimbruar të *E. coli* të shoqëruar me rrezik më të lartë për ITU. [10] Foshnjat që nuk ushqehen me gji është treguar se kanë mesatarisht dy herë më shumë rrezik për ITU krahasuar me foshnjat që janë ushqyer me gji për të paktën 7 muaj. Përfitimet e ushqyerjes me gji janë veçanërisht të mëdha tek vajzat. Mund të zvogëlojë rrezikun e UTI edhe pas shkëputjes nga gjiri. [9]

**Lëngje që përmbajnë flavonoide.** Disa klasa të flavonoideve (p.sh., epikatekina) bllokojnë ngjitjen e fimbrisë *E. coli* në qelizat uroepiteliale. Ata gjithashtu mund të parandalojnë ITU me

mekanizma të tjerë, si për shembull rregullimi i ulët i gjeneve në E. coli përgjegjës për shprehjen fimbriale.

**Laktobacilet.** Provat e kufizuara sugjerojnë se gratë që konsumojnë pa recetë probiotikë Lactobacilli kanë një rrezik të ulur ndjeshëm (80% më të ulët) për UTI. [15] Nevojiten kërkime të mëtejshme për të vendosur shtamet më efektive.[16]

**Dietat me shumë fibra.** Kapsllëku është një faktor rreziku për UTI dhe UTI të përsëritura, megjithëse arsyet janë të paqarta. [17], [18] Studimet klinike nuk kanë vërtetuar ende dobinë e fibrave dietike për parandalimin e UTI, por rritja e ushqimeve me fibra të lartë tek personat me dieta me fibra të ulët është një strategji potencialisht e dobishme.

Rekomandohet ushqyerja me gji për të paktën 6 muaj, dhe nëse është e mundur më gjatë.

Për të rriturit që dëshirojnë të përdorin lëngje që përmbajnë flavonoid si masë parandaluese, lëngu i boronicës së kuqe të konsumuar 3 herë në ditë me vakte do të ishte i përshtatshëm.

**Urinary Tract Infection. (2023). In Barnard, N. D. (Ed.), Nutrition Guide for Clinicians (3rd ed.). Physicians Committee for Responsible Medicine.**

**[https://nutritionguide.pcrm.org/nutritionguide/vieë/Nutrition\\_Guide\\_for\\_Clinicians/1342042/all/Urinary\\_Tract\\_Infection](https://nutritionguide.pcrm.org/nutritionguide/vieë/Nutrition_Guide_for_Clinicians/1342042/all/Urinary_Tract_Infection)**

## 1.2 Klasifikimi i infeksioneve të traktit urinar

Infeksionet e traktit urinar (ITU) janë një problem shpeshherë i përjetuar nga shumë persona. Klasifikimi i infeksioneve të traktit urinar mund të bëhet në disa mënyra, duke u bazuar në lokacionin specifik të infeksionit dhe në natyrën e tyre. Këtu janë disa mënyra për të klasifikuar infeksionet e traktit urinar: (Hooton TM, Gupta K, 2019)

### Bazuar në lokacion:

**Cistit:** Përfshin infeksionet e zonës së fshikëzës (vezikulit); shoqërohen zakonisht nga simptoma si dhimbje gjatë urinimit, urinim i shpeshtë dhe ndjesi e djegies në traktin urinar.

**Pielonefrit:** Përfshin infeksionet e veshkave; mund të shoqërohet nga simptoma si dhimbje në pjesën e poshtme të kurrizit, ethe dhe ndërprerje të vazhdueshme e urinimit.

### Bazuar në origjinën e infeksionit:

**Infeksionet bakteriale:** Shkaktuar nga bakteret, ku bakteret hyjnë në traktin urinar dhe shkaktojnë infeksion.

**Infeksionet virale:** Shkaktuar nga viruset, por janë më të rralla në krahasim me infeksionet bakteriale.

### Bazuar në natyrën e infeksionit:

**Infeksion akut:** Zhvillohet shpejt dhe ka simptoma të forta.

**Infeksion kronik:** Zhvillohet gradualisht dhe mund të ketë simptoma të vazhdueshme ose periodike.

### Bazuar në grada të rrezikut:

**ITU e lehtë:** Mund të trajtohet me sukses me antibiotikë në nivelin e parë shëndetësor.

**ITU e mesme:** Mund të kërkojë trajtim më intensiv dhe mund të shoqërohet me simptoma më të forta.

**ITU e rëndë:** Mund të përfshijë komplikime serioze dhe kërkon trajtim të specializuar.

### Bazuar në popullsi:

**ITU në fëmijë:** Mund të ketë karakteristika të veçanta dhe mund të shpërndahe ndryshe në traktin urinar.

**ITU në shtatzëni:** Mund të ketë ndikim të veçantë të gratë shtatzëna dhe ka rreziqe të veçanta për fetusin.


Trajtimi i infeksioneve të traktit urinar zakonisht përfshin përdorimin e antibiotikëve dhe rregullimin e faktorëve rrezikues, si higjiena e mirë dhe uji i mjaftueshëm për të shmangur rikthimin e infeksionit. Është e rëndësishme të konsultoheni me mjekun për një vlerësim dhe trajtim të saktë. (Flores-Mireles AL, Walker JN, Caparon M, Hultgren SJ, publikuar në vitin 2015)

### 1.2.1 Faktorët predisponues të infeksioneve të rrugëve urinare

Infeksionet e rrugëve urinare janë infeksione që prekin aparatin urinar. Infeksioni shfaqet fillimisht në uretër ose në fshikëzën urinare. Nëse agjenti shkaktar i infeksionit përhapet duke u ngjitur nga fshikëza e urinës ose ureteri për në veshka, bëhet fjalë për infeksion ngjites. (Mody L, Juthani-Mehta M, 2014.)

Në pjesën më të madhe të rasteve (80%-90%), infeksioni rezulton nga bakteret (*E. coli*) (Theodor Escherich - *Escherichia coli* u zbulua për herë të parë në vitin 1885 nga mikrobiologu austriak Theodor Escherich)

Ai e përshkroi dhe e përcaktoi si një bakter normal të zorrës së njeriut. Infeksionet e rrugëve urinare janë më të shpeshta te femrat e rritura dhe foshnjat e gjinisë mashkullore. Femrat dhe meshkujt mbi 50 vjeç vuajnë pothuajse në mënyrë të barabartë nga infeksionet e rrugëve urinare. Rreth një në tre gra shtatzëna shfaqin të paktën një herë gjatë shtatzënisë ose pas lindjes një infeksion të rrugëve urinare.



**Figura nr.5**

Faktorët predisponues të infeksioneve të rrugëve urinare

### 1.2.2 Shkaqet e infeksioneve të rrugëve urinare

Pjesa më e madhe e infeksioneve të rrugëve urinare shkaktohen nga bakteri *E. coli*, që gjendet në zorrë. Në raste të rralla, përgjegjëse për infeksionin mund të jenë edhe baktere të tjera, viruse ose kërpudha. Në këto raste, agjenti shkaktar i infeksionit e ka origjinën në vaginë ose zorrë, nga ku prek uretrën ose fshikëzën e urinës. Në raste të rënda, ato ngjiten nëpërmjet ureterit dhe prekin veshkën.

Këta agjentë ngjiten në murin qelizor dhe shkaktojnë inflamacion. Disa baktere sekretojnë një enzimë, që e bën urinën alkaline, d.m.th. më pak acide. Mjedisi alkaline është tepër i favorshëm për bakteret, për pasojë ato shumohen shumë aty. Gjithashtu, urinat alkaline favorizojnë shumë edhe formimin e gurëve. (Xu L, Sun X, Ma X, 2018.)

#### **Mënyra të tjera të infektimit:**

- Bakteret arrijnë në aparatin urinar nëpërmjet qarkullimit të gjakut.

- Gjatë vendosjes dhe mbajtjes për një kohë të gjatë të kateterave urinare, infeksionet janë të shpeshta.
- Infektimet e drejtpërdrejta nga një vatër infeksioni në bark, p.sh., në peritoneum (peritonit) ose në zorrë (divertikulit). Te femrat, sëmundjet gjinekologjike si inflamacioni i tubave të Fallopit, mund të shërbejnë si vatër parësore e infeksionit.
- Faktorët e rrezikut ose sëmundjet që favorizojnë një infeksion të rrugëve urinare:

#### **Tek të dy gjinitë:**

- Diabeti i sheqerit.
- Çrregullimet e eliminimit të urinës, si pasojë e bllokimeve, ngushtimeve, pengesave ose inflamacioneve të rrugëve urinare.
- Formimi i gurëve në aparatit urinar (urolitiaza).
- Ekzaminimet e aparatit urinar me anën e instrumenteve mjekësore (eksplorimet, futja e kateterave).
- Dobësimi i aftësive mbrojtëse të organizmit (imunitetit).
- Sëmundjet metabolike (guta).
- Sasia e pamjaftueshme e lëngjeve të marra gjatë ditës dhe për pasojë volumi i pakët i urinës që eliminohet.
- Faktorët gjenetikë.
- Marrëdhëniet seksuale (veçanërisht ato anale).
- Transplanti i veshkave.

#### **Vetëm te meshkujt:**

- Hipotrofia ose kanceri i prostatës.
- Ngushtimi i prepuciumit (fimosi).
- Anomalitë e lindura, veçanërisht te djemtë e vegjël.

#### **Vetëm te femrat:**

- Shtatzënia.
- Mënyrat e kontracepsionit mekanik ose kimik (pomadat spermicide, steriletë, diafragmat, etj.).
- Te femrat, uretra është e shkurtër dhe i lejon bakteret të arrijnë në aparatit urinar shumë më shpejt se te meshkujt.
- Femrat që kanë disa antigjenë të grupit të gjakut duket se janë më të ndjeshme ndaj infeksioneve urinare; te femrat, shpesh mungojnë antitruapat e mukozës kundër bakterit E. Koli.

### 1.3 Infeksionet e traktit urinar

- Diagnoza e infeksionit të rrugëve urinare, e quajtur inflamacion i fshikëzës së urinës ose cistit, konsiston në një inflamacion të indeve që veshin rrugët urinare. Shkaku më i shpeshtë i kësaj sëmundjeje janë bakteret. Duke iu referuar strukturës së këtyre rrugëve, ureterët janë dy tuba (i majti dhe i djathti), që shërbejnë për të transportuar urinën nga të dy veshkat (përkatësisht e majta dhe e djathta) për në fshikëzën e urinës. Uretra është një kanal që shërben për ta nxjerrë urinën nga fshikëza e urinës, duke e eliminuar atë jashtë organizmit. Nëse përgjatë këtyre rrugëve ndodh shumëzim i shprehur i baktereve, kjo manifestohet menjëherë me djegie gjatë urinimit.



**Figura nr.8**

Infeksioni i traktit urinar

- Infeksionet e rrugëve urinare dhe të fshikëzës së urinës janë më të shpeshta te femrat, sepse rrugët urinare të femrës janë më të shkurtra se të mashkullit. Për këtë arsye, bakteret hyjnë më shpejt në fshikëzën e urinës, veçanërisht te femrat në moshë të re, me jetë seksuale aktive.
- Meshkujt e moshuar shfaqin më shpesh infeksione urinare (cistite). Kjo është e lidhur me zmadhimin e prostatës, që pengon rrjedhjen e urinës. Dallohen dy forma të infeksioneve të rrugëve urinare: infeksionet e rrugëve të poshtme urinare dhe ato të rrugëve të sipërme urinare. Në grupin e parë hyjnë infeksionet e uretrës dhe fshikëzës së urinës, ndërsa në grupin e dytë hyjnë infeksionet e veshkave.
- 

### 1.3.5 Parandalimi i ITU-ve

Parandalimi i Infeksioneve të Traktit Urinar (ITU-ve) është shumë i rëndësishëm për ruajtjen e shëndetit të përgjithshëm dhe për parandalimin e komplikimeve të mundshme. Ja disa këshilla dhe praktika për të ndihmuar në parandalimin e ITU-ve: (David Klumpp dhe hari Kumar, i botuar në vitin 2016)

1. **Hidratimi i mirë:**
  - Pini mjaftueshëm ujë çdo ditë. Hidratimi i mirë ndihmon në largimin e baktereve nga trakti urinar.
2. **Urinimi i rregullt:**
  - Mos e mbani urinën për një kohë të gjatë. Shkuarja në tualet sa herë që ndjeni nevojën ndihmon në parandalimin e rritjes së baktereve.
3. **Higjiena e mirë:**
  - Fshijeni zonën intime nga përpara prapa pas përdorimit të tualetit për të shmangur përhapjen e baktereve nga rektumi në uretrë.

- Lajeni zonën gjenitale me ujë të ngrohtë çdo ditë dhe shmangni përdorimin e sapunëve të ashpër që mund të iritojnë lëkurën.
- 4. **Përdorimi i tualetit para dhe pas aktivitetit seksual:**
  - Urinimi para dhe pas marrëdhënieve seksuale ndihmon në largimin e baktereve që mund të jenë futur në traktin urinar gjatë aktivitetit seksual.
- 5. **Veshje e përshtatshme:**
  - Veshjet e pambukut dhe veshjet e lirshme ndihmojnë në mbajtjen e zonës gjenitale të thatë dhe të ajrosur. Shmangni veshjet e ngushta dhe materialet sintetike që mbajnë lagështi.
- 6. **Shmangia e produkteve irrituese:**
  - Shmangni përdorimin e sprejeve intime, dushëve vaginale dhe produkteve të tjera që përmbajnë kimikate të ashpra që mund të iritojnë traktin urinar.
- 7. **Ushqimi dhe suplementet:**
  - Ushqimi i pasur me antioksidantë dhe konsumimi i lëngut të boronicës së kuqe (cranberry juice) mund të ndihmojnë në parandalimin e ITU-ve. Disa studime sugjerojnë se lëngu i boronicës së kuqe ka veti që pengojnë lidhjen e baktereve në muret e traktit urinar.
- 8. **Kontrollimi dhe trajtimi i shkaqeve themelore:**
  - Nëse keni kushte mjekësore që rrisin rrezikun e ITU-ve, si diabeti ose problemet e prostatës, është e rëndësishme të menaxhoni këto kushte në mënyrë të duhur.

Parandalimi i ITU-ve kërkon një qasje të kujdesshme dhe të disiplinuar ndaj higjienës personale dhe stileve të jetesës. Nëse keni infeksione të përsëritura të traktit urinar, është e këshillueshme të konsultoheni me një mjek për të gjetur shkakun dhe për të zhvilluar një plan të përshtatshëm parandalimi. (David Klumpp dhe Hari Kumar, i botuar në vitin 2016).

#### 1.4 Përparimet inovative teknologjike në mjekësinë laboratorike

Mjekësia laboratorike është pjesë përbërëse e ofrimit të shëndetit publik dhe kujdesit shëndetësor, dhe mbështetet në teknika të shumta analitike për të ofruar të dhëna objektive në kohë për profesionistët e kujdesit shëndetësor për të udhëhequr parandalimin, diagnostikimin, trajtimin dhe monitorimin e sëmundjeve.



**Figura nr.10**

**Kryerja e analizave**



Të nxitura dhe të përcaktuara nga një kulturë inovacioni, përparimet e fundit teknologjike kanë revolucionarizuar mjekësinë moderne laboratorike dhe i kanë shtuar vlerë dhe dukshmëri të rëndësishme rolit të saj në kujdesin shëndetësor dhe vendimmarrjen klinike.

Risitë e rëndësishme në automatizimin laboratorik, gjenomikën, spektroskopinë e rezonancës magnetike bërthamore, spektrometrinë e masës, mikrofluidikën dhe mjetet elektronike kanë ndryshuar fytyrën e kërkimit omikë.

Zbatimi në rritje i këtyre teknologjive, si dhe integrimi i tyre me mikroteknologjinë dhe testimin e pikës së kujdesit, ka kontribuar në përmirësimin e rezultateve të pacientit dhe ngushtimin e ndërfaqes klinike-laboratorike për të lehtësuar një qasje të kujdesit shëndetësor me në qendër pacientin. Megjithatë, për të përfituar në mënyrë adekuate këto përparime, nevojiten mjete të reja si inteligjenca artificiale dhe minierat e të dhënave për të shfrytëzuar potencialin emocionues të të dhënave të mëdha mjekësore që rrjedhin nga këto teknika të reja. ("Clinical Laboratory Diagnostics: Use and Assessment of Clinical Laboratory Results" nga Lothar Thomas, i botuar në vitin 2020.)

Rishikimi aktual ofron një përmbledhje të përparimeve të fundit teknologjike në mjekësinë laboratorike, me një diskutim kritik mbi dobinë e tyre klinike dhe perspektivat e ardhshme. Premtimi dhe potenciali për mjekësi precize dhe të personalizuar diskutohet dhe vlerësohet gjithashtu, me vëmendje të veçantë kushtuar kontigjencës së suksesit të saj në aftësitë e avancuara të teknologjisë së informacionit.

Në dekadat e fundit, laboratorët kanë adoptuar kryesisht analizues të automatizuar që kanë përmirësuar gjerësisht efikasitetin e testimit laboratorik, kostot dhe gabimet e drejtuara nga laboratorit. Për më tepër, përparimet analitike të rëndësishme në gjenetikë dhe gjenomikë, spektroskopia e rezonancës magnetike bërthamore (NMR), spektrometria e masës (MS) dhe mikrofluidika kanë paralelizuar rritjen e automatizimit laboratorik për të mundësuar një epokë të re të mjekësisë laboratorike. Në të vërtetë, zhvillimi dhe evolucioni i sekuencës së gjeneratës së ardhshme dhe njëqelizore e ka revolucionarizuar fushën e gjenomikës dhe transkriptomikës për të lejuar sekuencën e ADN-së dhe ARN-së të gjithë vlerë të njohur mjekësisë laboratorike në sektorin e kujdesit shëndetësor me performancë të lartë dhe kosto më të ulët (Stephen M. Genzen, i botuar në vitin 2019.)

**Figura nr.11**

Kryerja e analizave me teknologji inovative



Teknologjitë inovative kanë ndikuar ndjeshëm në fushën e mjekësisë laboratorike, përfshirë diagnozën dhe trajtimin e infeksioneve të rrugës urinare (ITU). Këtu janë disa përparime inovative në mjekësinë laboratorike, të cilat kanë aplikim kryesisht në diagnostikimin dhe menaxhimin e ITU:

## 1.4 Inteligjenca artificiale në zbulimin e të gjitha sëmundjeve

“Ekzistojnë shumë tituj në lidhje me njerëzit që tejkalojnë inteligjencën artificiale, por mesazhi ynë është që në rastin më të mirë mund të jetë ekuivalent,” sipas Dr Xiaoxuan Liu. Për shkak të këtyre kufizimeve, studiuesit kanë dalë në përfundim se fuqia e vërtetë diagnostikuese e inteligjencës artificiale “mbetet e pasigurt”. (Siobhan Wilson, Shannon Steele & Khosrow Adeli, botuar në vitin 2022).

Inteligjenca artificiale (IA) ka potencial të madh për të ndihmuar specialistët shëndetësorë në zbulimin e sëmundjeve duke përmirësuar diagnostikimin, përcaktimin e trajtimit, dhe shpërndarjen e kujdesit shëndetësor.

IA mund të përdoret për analizën e të dhënave të mëdha mjekësore, përfshirë rezultatet e testeve laboratorike, imazhet mjekësore (si radiografitë, CT skanet, dhe MRI), dhe informacionin e historisë së pacientit. Algoritmet e mësimi automatik mund të identifikojnë modele të fshehura që mund të mos dalin në mënyrë të qartë për syrin njerëzor.

Sisteme të bazuar në IA mund të zhvillojnë algoritme për diagnostikimin automatik të sëmundjeve. Për shembull, në fushën e radiologjisë, IA mund të ndihmojë në identifikimin e strukturave të anomalisë në imazhe. IA mund të përdoret për analizën e të dhënave gjenetike dhe kartografimin e gjenomikës për të identifikuar lidhjet midis variablëve gjenetike dhe rrezikut për sëmundjet. IA mund të zhvillojë modele të parashikimit të rrezikut për të zhvilluar sëmundje në të ardhmen, duke përfshirë faktorët gjenetikë, mjedisin dhe stilin e jetesës (Jiebo Luo, viti 2020).

Në bashkëpunim me bazën e të dhënave të mjekëve dhe informacionin e fundit shkencor, IA mund të ofrojë sugjerime për trajtimin dhe menaxhimin e sëmundjeve, duke pasur parasysh individualitetin e pacientit.

Sistemet e inteligjencës artificiale mund të ndihmojnë në monitorimin e shëndetit të pacientëve, duke analizuar të dhënat e përdorura nga pajisjet e monitorimit të shëndetit ose aplikacionet mjekësore dhe duke njoftuar mjekët për ndryshimet potenciale. IA mund të përdoret për të identifikuar trajtimet më efikase për pacientët, duke marrë parasysh faktorë të ndryshëm si gjenetika, përgjigjja ndaj trajtimit të mëparshëm dhe variabëlët mjedisore (Jiebo Luo, viti 2020).

Megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se përdorimi i IA në fushën e mjekësisë kërkon kujdes të madh dhe vlerësim të vazhdueshëm. Siguria, etika dhe privatësia e të dhënave janë shqetësime kryesore që duhet të trajtohen me kujdes kur përdoret IA në këtë kontekst. Bashkëpunimi i ngushtë midis specialistëve të shëndetit dhe inxhinierëve të IA është thelbësor për zhvillimin e teknologjisë, në mënyrë që të jetë në përputhje me nevojat dhe parashikimet mjekësore të përdoruesve përfundimtarë (Jiebo Luo, viti 2020).



Figura nr.13



## **MATERIALI DHE METODA**

### **2.1 Qëllimi dhe objektivat.**

#### **2.1.1 Objektivi i Përgjithshëm**

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë dhe të vlerësojë kontributin e metodave laboratorike në diagnostikimin e ITU-ve. Kjo përfshin analizimin e testeve të ndryshme laboratorike që përdoren për të identifikuar patogjenët përgjegjës për infeksionet e traktit urinar, si dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre në praktikën klinike. Punimi është realizuar me qëllim të rritjes së njohurive të përditësuara rreth infeksioneve të traktit urinar, bazuar në literaturën bashkëkohore, mënyrës së paraqitjes, faktorëve të rrezikut, si dhe kujdesit teknik për pacientët për analizimin e pacientëve me ITU, kujdesi i duhur që iu ofrohet pacientëve me ITU është një trajtim që përmirëson cilësinë e jetës së pacientit dhe po ashtu e ndihmon pacientin të ndihet më me vetëbesim në tejkalimin e sfidave të tyre jetësore.

#### **Materiali dhe metoda**

Në këtë studim janë përfshirë 70 pacientë të moshave të ndryshme, vlerësuar me Cell Counter (Ruby), në laboratorë të ndryshëm privatë në Tiranë si dhe në klinikën e Pediatriisë, reparti i Urologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, nga tetori 2023 deri në maj 2024. Subjektet e marra në studim janë shtresëzuar në bazë të ndryshimit të parametrave laboratorike si: hemograma, sideremia dhe ferritina.

Studimi i infeksioneve të traktit urinar (ITU) kërkon një qasje të përshtatshme për të kuptuar shkaqet, simptomat, trajtimin dhe parandalimin e tyre. Këtu janë disa metoda të cilat janë përdorur për studimin e infeksioneve të traktit urinar:

Shqyrtimi i librave, artikujve shkencorë, raporteve kërkimore dhe materialeve të tjera të besueshme në lidhje me infeksionet e traktit urinar është një hap i rëndësishëm për të kuptuar bazën shkencore dhe klinike të kësaj gjendjeje. Kërkimi në literaturën më të fundit në lidhje me të ushqyerit dhe dietat ushqimore për pacientët me infeksione të traktit urinar.

#### **Metodika**

Ky punim është një hulumtim retrospektiv i realizuar në periudhën kohore prej muajit Tetor 2023 deri në muajin Maj 2024. Gjatë realizimit të këtij punimi, janë analizuar të dhënat e 70 pacientëve me sëmundje të ndryshme në laboratorë të ndryshëm në Tiranë si dhe në klinikën e Pediatriisë, reparti i Urologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Të dhënat janë marrë nga regjistri i pranimit të pacientëve në repart, në listat e terapisë së pacientëve, në historitë e pacienteve si dhe jemi konsultuar me stafin e repartit për komplikimet më të shpeshta që ndodhin gjatë trajtimit të pacientëve të tillë.

Gjithashtu janë analizuar të dhënat për moshën, gjininë, kohëzgjatjen e hospitalizimit dhe në bazë të këtyre të dhënave të pacientëve, janë grupuar sipas gjinisë dhe sipas moshës së tyre në momentin e diagnostikimit. Të dhënat e fituara janë përpunuar në mënyrë statistikore dhe rezultatet e fituara janë paraqitur në mënyrë tabelore dhe me grafik. Janë llogaritur parametrat statistikor si: numri i përgjithshëm i femrave dhe i meshkujve, mesatarja aritmetike dhe përqindja. Për të gjithë pacientët e marrë në studim është ruajtur anonimat.

Kjo metodologji do të sigurojë një qasje të strukturuar dhe të detajuar për të analizuar rolin e ndihmesës laboratorike në diagnostikimin e infeksioneve të traktit urinar, duke kontribuar në përmirësimin e praktikave diagnostike dhe trajtimit të pacientëve.

- Ky studim ka si objektiv të përgjithshëm të paraqesë informacion më të përditësuar në lidhje me ITU, përhapjen e tyre, diagnostifikimin, trajtimin dhe parandalimin, si dhe sjelljet apo modelet e të ushqyerit të rekomanduara për këta pacientë.

## REZULTATET DHE DISKUTIME

Për realizimin e këtij punimi janë marrë në studim analizimi i mostrave të urinës për pacientët të përfshirë në mënyrë rastësore duke ruajtur anonimin dhe konfidencialitetin.

Analizë e thjeshtë e urinës: për të parë praninë e rruazave të bardha (leukociteve), rruazave të kuqe(eritrociteve) apo baktereve.

Një sasi urine e marrë në mes të rrjedhës është zakonisht e përshtatshme dhe është më e plotë dhe më e saktë urina e mëngjesit.

Kateterizmi i fshikëzës urinare duhet të bëhet për pacientët e pediatriisë, obezët, gratë që kanë menstruacione ose kanë rrjedhje vaginale dhe të dëmtuarat.


E rëndësishme është mënyra e marrjes së materialit: gjithmonë pasi është pastruar me antiseptik zona gjenitale, lihet të urinojë një sasi urine dhe më pas merret porcioni i mesit. Urokultura ose si quhet ndryshe mbjellja e urinës. Analiza laboratorike e urinës duhet të ndiqet menjëherë me një urokulturë.

Kjo analizë tregon se cilët janë bakteret përgjegjëse për infeksionin e shkaktuar. Nëpërmjet përgjigjes së uro kulturës më pas vendoset dhe mjekimi me antibiotikun e duhur për bakterin përgjegjës të infeksionit. Rritja e baktereve (uro kultura): tregon llojin e mikrobis shkaktues dhe medikamentin.

Bazuar në të dhënat nga protokollet “Ikeda”, “Genius Lab”, “Luramed”, klinika e Pediatriisë, reparti i Urologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për periudhën e 2023-2024, janë përfshirë 70 pacientë me infeksione të traktit urinar, dhe nga vetë fakti që klinikat janë private dhe numri i pacientëve është më i pakët nga spitalet publike, si dhe dhe numri i pacientëve është i kufizuar në studim kemi këto të dhëna.

| Emërtimi | Numri | %  |
|----------|-------|----|
| Femra    | 41    | 59 |

**Tabela 1. Numri i femrave të trajtuara për ITU në vitet 2023-2024 (Për dy vitet së bashku marrë në studim)**



**Grafiku 1. Numri i femrave të trajtuara për ITU në vitet 2023-2024**

Siç vërehet nga grafiku i mësipërm nga totali i pacientëve (70) të trajtuar për ITU rezultojnë 59 % e tyre janë femra.

| Emërtimi | Numri | %   |
|----------|-------|-----|
| Meshkuj  | 29    | 41% |

**Tabela 2. Numri i meshkujve të trajtuar për ITU në vitet 2023-2024**




**Grafiku 2. Numri i meshkujve të trajtuar për ITU në vitet 2023-2024**

**Diskutim:** Nga analizimi i dy grafikëve të mësipërm, rezulton se nga 70 pacientë të marrë në studim, 41 femra (ose 59%) dhe 29 meshkuj (ose 41%) janë trajtuar me ITU gjatë viteve 2023-2024.

| Analiza               | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
|-----------------------|---------|-------|----------|
| Ngjyra                | 20      | 50    | 70       |
| Densiteti             | 22      | 48    | 70       |
| Niveli i pH           | 31      | 39    | 70       |
| Prania e glukozës     | 30      | 40    | 70       |
| Prania e ketoneve     | 31      | 39    | 70       |
| Prania e proteinave   | 21      | 49    | 70       |
| Prania e nitrateve    | 18      | 52    | 70       |
| Prania e eritrociteve | 25      | 45    | 70       |
| Prania e leukociteve  | 30      | 40    | 70       |

**Tabela 3. Numri i femrave dhe meshkujve të trajtuar për ITU (Urinë) në vitet 2023-2024**




**Grafiku 3 Numri i femrave dhe meshkujve të trajtuar për ITU (Urinë) në vitet 2023-2024**

**Diskutimi:** Nga analizimi i provave laboratorike rezulton se analiza e urinës tek femrat ka një ngjyrë të verdhë e fortë, ndërsa tek burrat ka një diferencë të dukshme, duke e analizuar dhe grafikun e mësipërm, tregon se ITU është më i shpeshtë tek gratë se sa te burrat.

| Grup moshat | 0-18 | 19-40 | 41-60 | > 61 |
|-------------|------|-------|-------|------|
| Femra       | 7    | 30    | 27    | 6    |


**Tabela 4. Numri i femrave të marra në studim sipas moshës**



**Grafiku 4. Numri i femrave të marra në studim sipas moshës**

| Grup moshat | 0-18 | 19-40 | 41-60 | > 61 |
|-------------|------|-------|-------|------|
| Meshkuj     | 12   | 23    | 22    | 13   |

**Tabela 5. Numri i meshkujve të marrë në studim sipas moshës**




### Grafiku 5. Numri i meshkujve të marrë në studim sipas moshës

**Diskutim:** Siç shihet dhe në grafikun e mësipërm rreth 43% e femrave janë të prekura në grup moshën 19-40 vjeç dhe 38% në grup moshën 41-60 vjeç, kjo tregon se me ITU më të prekura sipas gjinisë dhe moshës janë femrat.

| Emërtimi i Analizës  | Femra |
|----------------------|-------|
| Kreatinina           | 41    |
| Urea                 | 39    |
| Niveli i acidit urik | 52    |
| Elektrolitet         | 50    |
| Albumina             | 55    |
| Leukocitet           | 51    |


Tabela 6. Krahasimi i analizave tek femrat, për analizat e mëposhtme.



Grafiku 6. Krahasimi i analizave tek femrat, për analizat e mëposhtme Diskutim:

| Emërtimi i Analizës  | Meshkuj |
|----------------------|---------|
| Kreatinina           | 29      |
| Urea                 | 31      |
| Niveli i acidit urik | 18      |
| Elektrolite          | 20      |
| Albumina             | 15      |
| Leukocitet           | 19      |

**Tabela 7. Krahësimi i analizave të meshkujt, për analizat e mëposhtme.**



**Grafiku 7. Krahësimi i analizave të meshkujt, për analizat e mëposhtme**

**Diskutim:** Siç shihet dhe në grafikun e mësipërm % e femrave është më e lartë se të meshkujt, kjo tregon se nga analizimi i provave laboratorike numri më i lartë i femrave është më i prekur me ITU se sa burrat.

## PËRFUNDIME

Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të rezultateve të analizave të urinës për 70 pacientë

me ITU të marrë në studim rezultoi se pacientët femra janë më të predispozuar për të shfaqur ITU se sa meshkujt.

Nga analizimi i provave laboratorike rezulton se analiza e urinës te femrat ka një ngjyrë e verdhë e fortë, ndërsa te burrat ka një diferencë të dukshme, kjo tregon se ITU është më i shpeshtë tek gratë se sa tek burrat.

Rreth 43% e femrave janë të prekura në grup moshën 19-40 vjeç dhe 38% në grup moshën 41-60 vjeç, kjo tregon se me ITU më të prekura sipas gjinisë dhe moshës janë femrat.

Nga kërkimi në literaturën më të fundit bashkëkohore dhe sitet më të besueshme si PubMed etj. mund të konkludohet në këto përfundime si më poshtë:

- **Roli kritik i diagnostikimit laboratorik:** Analizat laboratorike janë thelbësore në diagnostikimin e saktë të infeksioneve të traktit urinar (ITU). Ato ofrojnë informacione të detajuara për prezencën dhe llojin e patogjenit, ndihmojnë në përcaktimin e ndjeshmërisë së antibiotikëve dhe drejtojnë trajtimin e duhur.
- **Metodat e analizës:** Testet kryesore laboratorike përfshijnë analiza të urinës dhe kultura të urinës. Analiza e urinës ndihmon në zbulimin e leukociteve, nitriteve dhe baktereve në urinë, ndërsa kultura e urinës është standardi i artë për identifikimin e agjentëve patogjenë dhe ndjeshmërisë së tyre ndaj antibiotikëve.
- **Përdorimi i teknologjive të avancuara:** Teknologjitë moderne si PCR (reaksioni zinxhir i polimerazës) dhe metodat e tjera molekulare po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për diagnostikimin e shpejtë dhe të saktë të ITU-ve, veçanërisht për identifikimin e patogjenëve që nuk mund të rriten lehtësisht në kulturë.
- **Interpretimi i rezultateve:** Interpretimi i saktë i rezultateve laboratorike kërkon ekspertizë dhe përvojë. Mjekët duhet të jenë të vetëdijshëm për kufizimet dhe mundësitë e testimit laboratorik për të shmangur diagnozat e gabuara dhe trajtimet e panevojshme.
- **Ndikimi në trajtimin e pacientit:** Diagnostikimi i saktë laboratorik ndihmon në përshkrimin e trajtimit më efektiv, duke reduktuar përdorimin e panevojshëm të antibiotikëve dhe duke ndihmuar në luftimin e rezistencës ndaj antibiotikëve.
- **Parandalimi dhe menaxhimi i ITU-ve të përsëritura:** Për pacientët me ITU të përsëritura, analizat laboratorike mund të ndihmojnë në identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe në zhvillimin e strategjive për parandalimin e episodeve të ardhshme të infeksioneve.
- **Rëndësia e edukimit dhe trajnimit:** Edukimi i vazhdueshëm i profesionistëve shëndetësorë në interpretimin e rezultateve laboratorike dhe zhvillimet e fundit në teknologjitë diagnostikuese është i domosdoshëm për përmirësimin e kujdesit ndaj pacientëve me ITU.
- Studiuesit nuk mendojnë se dieta mund të ndihmojë në parandalimin ose trajtimin e infeksioneve të fshikëzës. Produktet e boronicës, duke përfshirë lëngun, ekstraktin ose pilulat e boronicës së kuqe nuk trajtojnë infeksionet ekzistuese të fshikëzës. Ka disa kërkime që produktet e boronicës së kuqe mund të ndihmojnë në parandalimin e infeksioneve të fshikëzës, por nuk ka prova të mjaftueshme për të qenë të sigurt.
- Suplemente dietike, të tilla si vitaminat, ose praktika mjekësore plotësuese ose alternative mund të përdoren pas këshillimit me profesionistët e kujdesit shëndetësor.
- Pirja e mjaftueshëm e lëngjeve mund të mbajë të hidratuar dhe të ndihmojë në parandalimin ose lehtësimin e infeksioneve të fshikëzës. Uji është më i miri.

## SHKENCA EKONOMIKE

### PUNËSIMI NË DISTANCË:

### NJË STUDIM KRAHASUES NDËRMJET ITALISË DHE SHQIPËRISË

PhD. **Romina RADONSHIQI**

Email: [romina.radonshiqi@kulogos.edu.al](mailto:romina.radonshiqi@kulogos.edu.al)

Lecturer, University College LOGOS

Tiranë, Albania

Msc. **Bledar RADONSHIQI**

Email: [info@blediradonshiqi.it](mailto:info@blediradonshiqi.it)

Eventalb

Milano, Italy

#### Abstrakt

Globalizimi dhe avancimi i teknologjisë së informacionit kanë sjellë transformime të thella dhe sfida të reja në tregun global të punës, duke ndryshuar mënyrën se si ne kryejmë detyrat tona profesionale. Një nga mundësitë më të reja dhe tërheqëse është punësimi në distancë, ose "remote work", i cili ka fituar gjithnjë e më shumë popullaritet, veçanërisht pas pandemisë. Ky model punësimi ofron mundësi për angazhime ndërkombëtare, duke mundësuar që individët të kontribuojnë për kompani të ndryshme, pa pasur nevojë të jenë fizikisht të pranishëm në vendin e punës. Për ata që kanë angazhime familjare apo obligime personale. Shumë të rinj nga fushat e teknologjisë së informacionit, artit, marketingut, përkthimit, arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit etj., kanë arritur të adaptohen mjaft mirë me konceptin e punës në distancë, duke u bërë profesionistë të lirë në nivel ndërkombëtar. Ky ndryshim i qasjes i ka mundësuar atyre të zhvillojnë karriera të suksesshme dhe të shfrytëzojnë mundësitë që ofron globalizimi dhe teknologjia moderne. Italianët kanë adaptuar më shpejt mundësinë e punësimit në distancë, ndërsa në Shqipëri, puna në distancë ka marrë zhvillim pas pandemisë së COVID-19. Kjo ka mundësuar krijimin e mundësive të reja profesionale për individët shqiptarë, duke iu ofruar mundësinë për të kontribuar në tregje globale dhe për të zhvilluar karriera ndërkombëtare, pa qenë e nevojshme të largohen nga vendi i origjinës. Ky studim ka qëllim të analizojë mundësitë dhe sfidat që ekzistojnë në punësimin në distancë duke u bazuar në aspektin krahasimor midis Italisë dhe Shqipërisë.

**Fjalët kyçe:** *tregje globale, punësim në distancë, fleksibilitet, punonjës, karrierë*

## **Hyrje**

Zhvillimi i tregtisë elektronike ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit në distancë, duke ndihmuar që këto dy fusha të ecin paralelisht. Pjesëmarrësit në tregtinë elektronike, si blerësit dhe shitësit, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e mundësive të reja për punë online, duke kërkuar shërbime të ndryshme që mund të ofrohen nga profesionistë të cilët mund të punojnë në distancë. Italia si një vend i zhvilluar evropian me një treg pune të integruar ka njohur një ritëm të lartë të punës në distancë. Profesionistët shqiptarë, falë zhvillimeve të teknologjisë dhe platformave të punësimit online, kanë pasur mundësinë të punojnë online, duke konkurruar në tregun global. Kjo ka mundësuar që shumë profesionistë shqiptarë të ofrojnë shërbime për klientë ndërkombëtarë, duke përfituar mundësi punësimi që më parë do të ishin të vështira për t'u arritur. Megjithatë, një faktor tjetër ka qenë dhe mundësia për të ofruar shërbime me tarifa më të ulta se kolegët e tyre evropianë, një avantazh që ka lehtësuar hyrjen në tregje të huaja dhe ka krijuar mundësi për rritje dhe zhvillim profesional. Punonjësit shqiptarë të përfshirë në tregun e punësimit në distancë janë të kënaqur me pagesat që marrin për shërbimet që ofrojnë. Edhe pse ata e joshin tregun ndërkombëtar me tarifa më të ulëta se profesionistët e tjerë, pagesat që ata marrin mbeten shumë më të larta në krahasim me tregun e punës në Shqipëri. Kjo ofron mundësi për përmirësimin e kushteve ekonomike dhe rritjen e standardeve të jetesës, duke e bërë punën në distancë një mundësi atraktive për shumë individë.

## **Qëllimi i studimit**

Ky studim ka për qëllim të analizojë mundësitë dhe sfidat që ekzistojnë në punësimin në distancë, duke shqyrtuar aspekte të ndryshme që lidhen me këtë formë punësimi.

## **Objektivat e studimit**

- Të vlerësojmë ndikimin e punës në distancë në tregun global;
- Të identifikojmë rëndësinë e punës në distancë në Shqipëri dhe Itali;
- Të shqyrtojmë sfidat që lidhen me punësimin në distancë në të dy vendet;
- Të vlerësojmë mundësitë që lidhen me punësimin në distancë
- Të shqyrtojmë ndikimin e punës në distancë në mjedisin social dhe kulturor

## **Pyetja kërkimore**

Si ka ndikuar zhvillimi i teknologjisë dhe platformave të punësimit online në rritjen e mundësive për punësim në distancë në Shqipëri dhe Itali?

## **Hipoteza**

Zhvillimi i teknologjisë dhe rritja e përdorimit të platformave të punësimit online ka kontribuar në një rritje të ndjeshme të mundësive për punësim në distancë sepse ka rritur financat personale duke ndikuar në mirëqenien e të punësuarve.

## **Metodologjia e Studimit**

Ky studim nëpërmjet metodës deskriptive përpiket të marrë të dhëna në lidhje me sfidat dhe mundësitë e punësimit në distancë në Shqipëri dhe Itali, ku pyetësi është instrument kërkimi. Kampioni i marrë në studim janë të punësuar në distancë në Shqipëri dhe në Itali. Periudha e realizimit të anketës është nga muaji nëntor 2024 deri në muajin Shkurt 2025. Pyetësi është përkthyer në dy gjuhë Italisht dhe Shqip, pyetësi përbëhet nga pyetje të mbyllura: nis me pyetje hyrëse dhe më pas janë pyetje të cilat synojnë të vërtetojnë hipotezën e ngritur.

## **Kontributi i studimit**

Ky studim paraqet një kontribut të rëndësishëm për literaturën dhe kërkimin mbi fenomenin e punësimit në distancë në Shqipëri, pasi, deri tani, ka pasur një mungesë të dukshme të studimeve dhe të dhënave konkrete mbi këtë temë. Krahasimi i Shqipërisë me Italinë, një shtet i Bashkimit Evropian, e bën studimin edhe më interesant dhe të vlefshëm. Italia është një nga vendet që ka zbatuar politikat e punës në distancë në një shkallë më të gjerë dhe më të konsoliduar, duke krijuar mundësi për të analizuar zhvillimet dhe praktikën që janë aplikuar atje. Ky krahasim mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë dallimet e mundshme që ekzistojnë midis një shteti të Bashkimit Evropian dhe një vendi të Ballkanit, si Shqipëria, për sa i përket pranisë dhe implementimit të formave të ndryshme të punës.

Duke analizuar praktikën në një shtet të zhvilluar si Italia dhe duke i krahasuar ato me situatën në Shqipëri, studimi mund të nxjerrë në pah pengesat, mundësitë dhe sfidat që mund të hasen gjatë adoptimit të punës në distancë në një vend të Ballkanit. Ky krahasim gjithashtu mund të ofrojë një pasqyrë të vlefshme për politikëbërësit dhe bizneset shqiptare në mënyrë që të kuptojnë më mirë se si mund të adoptojnë dhe zhvillojnë këtë formë pune, duke marrë parasysh mësimet nga vendet e tjera evropiane.

## **Kufizimet e studimit**

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë dhe të analizojë fenomenin e punësimit në distancë në Shqipëri, një temë që është ende në zhvillim dhe pak e eksploruar. Edhe pse janë bërë përpjekje për të ofruar një studim cilësor, studiuesi është përballur me mungesë të studimeve dhe literaturës shkencore në lidhje me punësimin në distancë në Shqipëri.

Një tjetër kufizim i rëndësishëm është edhe kampioni i marrë në studim, i cili është relativisht i vogël. Ky faktor është kufizues edhe për shkak të kohës së kufizuar për të kryer studimin.

## **1. PUNËSIMI NË DISTANCË**

Puna në distancë nuk është një koncept i ri në fushën e kushteve të punës. Në 1972, Jack Nilles shpiku një term “telecommuting” që nënkuptonte të punoje nga shtëpia duke përdorur një telefon<sup>1</sup>. Përhapja e teknologjive, ekuilibri punë-jetë, mbingarkesa e punës, autonomia dhe fleksibiliteti janë studiuar ndaras që nga vitet tetëdhjetë, por në dekadat e fundit janë zhvilluar

---

<sup>1</sup> Antropov, S. (2008). Who and when invented remote work? [online] [cit. 2021-14-02]. Available: <https://www.kadrof.ru/history.shtml>

modele që i konsiderojnë këto elemente brenda një sistemi të integruar. Këto studime shqyrtojnë ndikimin e teknologjisë dhe mundësitë e fleksibilitetit në punë, duke balancuar jetën profesionale me atë personale, si dhe pasojat e mbingarkesës dhe autonomisë në performancën dhe mirëqenien e individëve. Në periudhën 2005-2020 puna në distancë u rrit në 159%<sup>2</sup>, dhe numri i punëve në distancë u rrit 30% nga 848 në 3144 në periudhën 2014-2019<sup>3</sup>. Punësimi në distancë është zbuluar dhe zbatohet gjithnjë e më shumë nga organizatat, falë teknologjive moderne si e-mail dhe video konferencat, që mundësojnë punën në kohën dhe vendin e preferuar nga punonjësit. Një formë e njohur është telekomunikimi, i cili përfshin punën nga shtëpia ose nga ndonjë adresë tjetër, duke përdorur pajisje të tilla si kompjuterë dhe telefona celularë<sup>4</sup>. Ky lloj fleksibiliteti mundëson balancimin e punës me përgjegjësitë familjare dhe ndihmon në rritjen e produktivitetit.<sup>5</sup> Megjithatë, ka dhe disa mangësi, si ndjenja e vetmisë dhe mungesa e bashkëpunimit social, të cilat mund të ndikojnë negativisht.

Interesi për punët fleksibël është rritur për shkak të ndryshimeve ligjore që u mundësojnë punonjësve të negociojnë kontratat e punës, zhvillimeve teknologjike dhe rritjes së njohurive të punëtorëve, të cilët fokusohen në rezultatet e punës në vend të prezencës fizike<sup>6</sup>. Ndryshimet demografike, si rritja e pjesëmarrjes së grave dhe baballarëve në forcën punëtore, gjithashtu kanë nxitur kërkesën për fleksibilitet në punë, duke ndihmuar në balancimin e jetës profesionale dhe private<sup>7</sup>. Organizatat që mund të përshtaten me këto ndryshime kanë mundësinë të tërheqin një fuqi punëtore më të kualifikuar dhe të rrisin performancën e tyre. Përfitimet kryesore për organizatat përfshijnë përmirësimin e performancës, lehtësimin e rekrutimit dhe mbajtjes së stafit, si dhe reduktimin e mungesave dhe vonesave.

Ka shumë faktorë të ndërvarur që përcaktojnë nëse njerëzit punojnë nga distanca i matet lehtësisht performanca<sup>8</sup>, por një faktor veçanërisht kritik është nëse punëdhënësit u besojnë punonjësve që të jenë produktivë edhe kur ata nuk mund të monitorohen nga afër<sup>9</sup>.

Referuar studimeve të kryera në Mbretërinë e Bashkuar organizatat më të vogla priren të jenë më të hapura ndaj punës në distancë<sup>10</sup>, gjë që ka kuptim duke pasur parasysh se ekzistojnë komunikime më të shpeshta midis menaxherëve dhe punëtorëve që ndodhen në këto mjedise, duke rritur besimin ndërpersonal. Hulumtimi nga Lee, R., & Perrin, A. (2016) thekson se të

<sup>2</sup> World Economic Forum (2020). The Future of Job: Report 2020. [online] [cit.2021-27-02]. Available: [http://www3.ëeforum.org/docs/WEF\\_Future\\_of\\_Jobs\\_2020.pdf](http://www3.ëeforum.org/docs/WEF_Future_of_Jobs_2020.pdf)

<sup>3</sup> International Labour Organization (ILO) (2020). An employers' guide on working from home in response to the outbreak of COVID-19. Geneva: International Labour Office

<sup>4</sup> Nilles, J.M. (2004). "Making telecommuting happen: A guide for telemanagers and telecommuters", New York: Van Nostrand Reinhold: 45

<sup>5</sup> Cooper, C., and Kurland, N. B. (2012). "Telecommuting, professional isolation and employee development in public and private organizations", *Journal of Organizational Behavior*, 23(4): 511–532.

<sup>6</sup> Stredwick Nohria, N. and Eccles, R.G. (2015). Face-to-face: Making network organizations work. In N. Nohria and R. G. Eccles (Eds.), *Networks and organizations*, Boston: Harvard Business School Press. *The work- family handbook: Multi- disciplinary perspectives, methods and approaches*: 611- 628

<sup>7</sup> Kossek, E. E. and Friede, A. (2016). The business case: Managerial perspectives on work and the family. In: Pitt- Catsouphes, M., Kossek, E. E. and Sweet, S. (eds.): 30

<sup>8</sup> Errichiello, L. and Pianese, T. (2016) Organizational Control in the Context of Remote Work Arrangements: A Conceptual Framework: 273–305.

<sup>9</sup> Harrington, S. J. and Ruppel, C. P. (1999) Telecommuting: a test of trust, competing values, and relative advantage. *IEEE Trans. Prof. Commun.*: 42, 223–239

<sup>10</sup> Mayo, M., Pastor, J.-C., Gomez-Mejia, L. and Cruz, C. (2009) Why some firms adopt telecommuting while others do not: a contingency perspective. *Hum. Resour. Manag.*, 48: 917–939.

dyja mënyrat e reja të punës dhe kompetencat e lidershipit luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e angazhimit organizativ, edhe kur konsiderohen në mënyrë të pavarur<sup>11</sup>. Ata ekzaminojnë në mënyrë specifike faktorët kyç si fuqizimi, besimi dhe menaxhimi i orientuar drejt prodhimit. Gjetjet e tyre tregojnë se kur punonjësit ndihen të fuqizuar dhe të vlerësuar, përkushtimi i tyre ndaj organizatës rritet, pavarësisht nëse ata punojnë në mjedise fleksibël.

Lake, A. (2015) konfirmon se në vendet e punës me shumë gjenerata, punonjësit preferojnë lidershipin që thekson ndërtimin e marrëdhënieve bazuar në besimin dhe besueshmërinë, në vend që të fokusohet vetëm në kompetencat personale ose largpamësinë<sup>12</sup>. Kjo preferencë është veçanërisht e përhapur tek gjenerata e mijëvjeçarit<sup>13</sup> dhe gjenerata Z<sup>14</sup>, të cilët janë më të prirur të kërkojnë liderë që nxisin një kulturë pune bashkëpunuese dhe ofrojnë mundësi për përmbushje individuale, në vend të atyre që i përmbahen një qasjeje të rreptë, të orientuar drejt detyrave.

Rëndësia e këtyre "aftësive të buta" përforcohet gjithashtu nga sondazhi i Deloitte 2018 mbi brezin Mijëvjeçar, i cili thekson se cilësitë si besimi, bashkëpunimi dhe përmbushja individuale shihen si thelbësore nga brezat e rinj në vendin e punës<sup>15</sup>. Kjo përputhet me konkluzionet e studimeve në lidhje me kërkesën në rritje për lidership që vlerëson njerëzit dhe marrëdhëniet, veçanërisht në mjediset e sotme të punës me shumë breza dhe fleksibël.

**Tabelë 1: Avantazhet dhe Disavantazhet e punës në distancë**

| <b>Avantazhe</b>                                 | <b>Disavantazhe</b>                                      |
|--------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|
| Ofron fleksibilitet maksimal                     | Izolim social                                            |
| Mundësi për të bërë më shumë se një punë         | Izolim Profesional                                       |
| Rrit produktivitetin e punonjësve                | Nevojë për t'u udhëhequr                                 |
| Ulet kostoja e mbajtjes së zyrave për biznesin   | Mungesë komunikimi                                       |
| Rreziku i infeksioneve është më i ulët           | Menaxhimi dhe mbikëqyrja më e vështirë                   |
| Ulja e shpenzimeve për udhëtimin e stafit        | Shpërqendrim                                             |
| Mundësi për të kursyer nga shpenzimet në punë    | Duhet të kesh një hapësirë larg zhurmave                 |
| Mundësi të lira për vetëvendosje                 | Vështirësi në punët si ekip                              |
| Mundësi për të punuar kudo                       | Vështirësi për matjen e performancës                     |
| Mundësi për t'u kujdesur për anëtarët e familjes | Monotoni                                                 |
| Shmangen politikat e zyrës                       | Probleme të vendosjes së balancës mes punës dhe familjes |

<sup>11</sup> Lee, R., & Perrin, A. (2016). Technology Adoption by Baby Boomers (and everybody else) | Pew Research Center. Retrieved November 25, 2018, from <http://www.pewinternet.org/2016/03/22/technology-adoption-by-baby-boomers-and-everybody-else/>

<sup>12</sup> Lake, A. (2015). The Smart working Handbook. Flexibility.co.uk Ltd. Retrieved from <http://www.flexibility.co.uk/SmartWorkHandbook/index.asp%5Cnwww.flexibility.co.uk>

<sup>13</sup> (Hero-Civic) ka lindur në epokën e globalizimit dhe të madh në rinovimi dhe përhapja e teknologjive të informacionit dhe komunikimit

<sup>14</sup> (Artist-Adaptive) sapo ka filluar të hyjë në fuqinë punëtore dhe të dhëna nga sondazhet sapo është mbledhur vitet e fundit


<sup>15</sup> Deloitte. (2018). Deloitte Millennial Survey. Retrieved from <https://www2.deloitte.com/global/en/pages/about-deloitte/articles/millennialsurvey.html>

|                                  |                                           |
|----------------------------------|-------------------------------------------|
| Diete ushqimore e shëndetshme    | Problem i sigurisë së të dhënave          |
| Përkujdesje më shumë për vete    | Varësi nga puna apo e kundërta dembelosje |
| Mundësi më tepër për të udhëtuar | Barrierat teknologjike                    |

Burimi: Klopotek. M (2017) përpunuar nga autori Radonshiqi. B (2024)

Forbes (2023) raportoi se përqindja e kompanive amerikane që ofrojnë opsione më fleksibël të punës u rrit nga 51% në fillim të 2023 në 62% deri në nëntor. Dhe shumë kompani më të vogla dhe me rritje më të shpejtë po adoptojnë punë fleksibël për të tërhequr dhe për të mbajtur talentet më të mirë. Punëtorët në distancë në SHBA kursejnë mesatarisht 55 minuta çdo ditë nga koha e udhëtimit, pasi nuk janë të detyruar të shkojnë në punë. Kjo i lejon atyre të shfrytëzojnë më shumë kohë për aktivitete të tjera, Në mbarë botën, mesatarja e kohës së udhëtimit të kursyer është 72 minuta për ditë. Për kompanitë, ky model i punës gjithashtu ka përfitime të konsiderueshme. Ato mund të kursejnë deri në 10,600 dollarë për punonjës në distancë, duke përfshirë koston e infrastrukturës dhe mbajtjes së zyrave. Kjo ka bërë që shumë kompani të vazhdojnë të ofrojnë mundësi pune nga distanca, madje edhe pas periudhës së pandemisë. Referuar studimit në Amerikë punonjësi mund të kursejë mesatarisht deri në 12,000 dollarë në vit duke punuar në distancë<sup>16</sup>.

**Grafikë 1: Përqindja e punonjësve që punojnë kryesisht në distancë në mbarë botën 2023, sipas industrisë**



Burimi: Statista (2024)

<sup>16</sup> [50 Eye-Opening Remote work Statistics for 2024](#) (aksesuar 20.12.2024)

Sipas Statista (2024) në vitin 2023, industria e teknologjisë kishte pjesën më të madhe të punonjësve në distancë në mbarë botën, me 67.8 për qind të punonjësve të industrisë së teknologjisë globalisht që punonin plotësisht ose kryesisht në distancë. Agjencitë dhe industria e konsulencës së bashku me industrinë e financave dhe të sigurimeve dolën në vendin e dytë dhe të tretë, me 50.6 dhe 48.7 për qind të punonjësve që punojnë kryesisht në distancë, respektivisht.

## **2. SOFTUERI I MONITORIMIT TË PUNONJËSVE**

Bossware ose tattleware është një software që përdoret për të ndjekur dhe mbikëqyrur aktivitetet e punonjësve në kompjuterët dhe pajisjet e tyre. Ky softuer mund të përfshijë gjurmimin e tastierës, regjistrimin e aktiviteteve online, përfshirjen e të dhënave GPS për të ndjekur vendndodhjen, dhe madje aktivizimin e kamerave të internetit dhe mikrofonave për të monitoruar punonjësit pa e ditur ata<sup>17</sup>.

Një aspekt i rëndësishëm i bossware është se mund të funksionojë në dy forma:

1. I dukshëm: Aplikacioni është i pranishëm në pajisje dhe mund të shikohet dhe ndoshta kontrollohet nga përdoruesi.
2. I fshehur: Ky është më shqetësuesi, pasi punonjësi nuk mund ta vërejë ose kontrollojë që është duke u monitoruar, dhe nuk ka informacion rreth asaj që po ndodh në pajisjen e tij.

## **3. NOMADËT DIGJITALE NË SHQIPËRI**

Për të adresuar këto sfidat ekonomike dhe për të stimuluar zhvillimin ekonomik, qeveria shqiptare ka filluar të krijojë mundësi për qëndrimin e të huajve në Shqipëri, përmes projekteve të tilla si "nomadët digjitalë". Bazuar Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit (2023) projekti "nomadët digjitalë" u lejon të huajve që punojnë online të jetojnë dhe të punojnë në Shqipëri, duke ofruar lehtësira fiskale dhe stimuj të tjerë. Nomadët digjitalë tani kanë një bazë të sigurt ligjore për zhvillimin e aktiviteteve të tyre profesionale në Shqipëri.

Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve", i miratuar nga komisioni parlamentar për Ekonominë dhe Financat, siguroi një liberalizim të plotë në fushën e taksave<sup>18</sup>. Punonjësit lëvizës digjitalë nuk do të konsiderohen si rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë prej 12 muajsh, çka do të thotë se ata përjashtohen nga taksat për një vit. Akomodimi i përshtatshëm për nomadët digjitalë në Shqipëri ofron përfitime të shumta, jo vetëm për ata, por edhe për ekonominë lokale. Ky model ndihmon në zhvillimin e startup-eve, rritjen e punësimit për të rinjtë shqiptarë dhe përmirësimin e të ardhurave të zonave ku strehohen nomadët. Pavarësisht se të ardhurat e nomadëve digjitalë ndryshojnë, rreth 35% e tyre fitojnë midis 50 mijë dhe 100 mijë dollarë në vit. Sipas Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (2024) Shqipëria është vërtet një mundësi ideale për nomadët digjitalë sepse Shqipëria ofron<sup>19</sup>:

- Lehtësira fiskale

<sup>17</sup> [Inside the Invasive, Secretive "Bossware" Tracking Workers | Electronic Frontier Foundation](#) (aksesuar 15.12.2024)

<sup>18</sup> [Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare](#) (aksesuar 15.12.2024)

<sup>19</sup> [Agjencia Për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore](#) (aksesuar 07.12.2024)

- Infrastrukturë teknologjike
- Kosto të ulët jetese
- Mjedis mikpritës
- Cilësi jetese (klime e favorshme)
- Bukuri natyrore


#### 4. Përmbledhje e Studimit

##### Metodologjia e Studimit


Ky studim do të shërbejë si një udhëzues, pasi në këtë punim është përdorur metoda deskriptive krahasuese. Puna është përqendruar në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit faktik, duke u larguar nga përdorimi i informacionit të paqartë dhe të parëndësishëm. Ky studim karakterizohet nga disa cilësi të rëndësishme, ndër të cilat mund të përmendim se është, në radhë të parë, informues dhe i thellë, dhe gjithashtu përfshin analiza praktike që janë të kuptueshme për të gjithë. Krahasimi i punonjësve në distancë në Shqipëri dhe Itali është një veçori që e bën këtë punim të ketë një kontribut të madh në fushën e ekonomisë së punës. Në këtë studim janë përdorur burime parësore dhe dytësore. Si burime parësore janë përdorur pyetësorë të drejtuar profesionistëve të lirë në Shqipëri dhe Itali, ndërsa si burime dytësore janë përdorur publikime nga autorë të huaj edhe nga autorë shqiptarë. Kampioni i marrë është rreth 100 profesionistë në Shqipëri dhe Itali. Këtë fakt mund ta konsiderojmë si një kufizim të kërkimit, por nisur nga koha e studimit (muaji nëntor 2024 deri në muajin shkurt 2025), mund të themi që ky studim ka një kontribut të veçantë. Pyetësori është përkthyer në dy gjuhë Italisht dhe Shqip dhe është kryer Online.

##### Të dhënat e studimit

**Grafikë 2.1: Gjinia e të anketuarve në Shqipëri**



**Grafikë 2.2: Gjinia e të anketuarve në Itali**



**Itali**

Burimi: Autorë (2025)

Sipas të dhënave, është vënë re se meshkujt dominojnë më shumë në tregun e punës në distancë, duke përbërë 70% të punonjësve në Shqipëri dhe 55% në Itali.

**Grafikë 2.3: Arsimi i të anketuarve në Shqipëri**



**Grafikë 2.4: Arsimi i të anketuarve në Itali**



Burimi: Autorë (2025)

Përmes studimit, mund të themi me siguri se punonjësit në distancë në Shqipëri dhe Itali janë kryesisht të arsimuar, me përqindje më të lartë që kanë përfunduar arsimin univeristar dhe pasuniveristar, sepse kjo mënyrë punësimi kërkon disa aftësi.

**Grafikë 2.5: Eksperienca e të anketuarve në Shqipëri**



**në Itali**

**Grafikë 2.6: Eksperienca e të anketuarve**



Burimi: Autorë (2025)

Referuar të dhënave, konkludojmë se në Itali punonjësit në distancë kanë më shumë vite pune dhe janë më të qëndrueshëm. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se ata janë njohur me këtë mënyrë punësimi përpara punonjësve shqiptarë.

**Grafikë 2.7: Sektorët e PD<sup>20</sup> në Shqipëri**




**Grafikë 2.8: Sektorët e PD në Itali**



Burimi: Autorë (2025)


Punonjësit në distancë në Itali dhe Shqipëri dominojnë në profesionet që lidhen me Teknologjinë e Informacionit dhe Programimin, të ndjekura nga Marketingu Digjital dhe Shërbimi i Klientit, i cili përfshin një gamë të gjerë sektorësh, veçanërisht në industrinë e tregjeve financiare.

**Grafikë 2.9: Paga e PD<sup>21</sup> në Shqipëri**



(2025)

**Grafikë 2.10: Paga e PD në Itali**




Burimi: Autorë

Shumica e të anketuarve, të cilët janë pjesë e punësimit në distancë, pohuan se ndihen të shpërblyer për shërbimin që ofrojnë ndaj kompanive të tyre. Rreth 90% e tyre (30% pohojnë shumë e lartë dhe 60% e lartë) shprehen të kënaqur, ndërkohë që për italianët, kjo formë punësimi ofron një pagë mesatare në krahasim me pagën mesatare kombëtare.

<sup>20</sup> Punë në distancë


<sup>21</sup> Punë në distancë

**Grafikë 2.11: Problemet teknike PD në Shqipëri Itali**



Burimi: Autorë (2025)

**Grafikë 2.12: Problemet teknike e PD në Itali**




Bazuar në studimet e realizuara për punonjësit në distancë, të dy vendet kanë hasur në sfida teknike gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Niveli më i lartë i këtyre problematikave është vërejtur në Shqipëri, gjë që mund të shpjegohet edhe nga fakti se këtu nuk ka një eksperiencë të gjerë në këtë lloj modeli punësimi.

**Grafikë 2.13: Përparësitë e PD në Shqipëri**




**Grafikë 2.14: Përparësitë e PD në Itali**




Burimi: Autorë (2025)

Referuar studimit të kryer në Shqipëri, shumica e punonjësve në distancë pohojnë se një prej avantazheve kryesore është pagesa e lartë (40%) për shërbimet që ata ofrojnë, duke pasur parasysh se niveli i pagave në Shqipëri është shumë i ulët krahasuar me pagat mesatare në BE. Një përparësi tjetër për shqiptarët është mundësia për të punuar me klientë ndërkombëtarë (30%). Ndërsa në Itali, një përparësi kryesore për punonjësit në distancë është fleksibiliteti i orareve të punës.

**Grafikë 2.15: Sfidat e PD në Shqipëri**



**Grafikë 2.16: Sfidat e PD në Itali**



Burimi: Autorë (2025)

Bazuar në të dhënat e studimit, sfidat e punonjësve shqiptarë ndahen në disa aspekte, si konkurrenca që ndjejnë nga profesionistët e tjerë ndërkombëtarë, izolimi social dhe problemet me menaxhimin e kohës. Ndërkohë, për punonjësit italianë, sfida kryesore e punësimit në distancë mbetet izolimi social, i cili ka një ndikim të konsiderueshëm në shëndetin mendor.

**Grafikë 2.17: Mirëqenia e PD në Shqipëri**




**Grafikë 2.18 Mirëqenia e PD në Itali**



Burimi: Radonshiqi. B (2024)


Referuar ndikimit pozitiv në shëndetin mendor, mund të themi se italianët janë më të ndjeshëm sesa shqiptarët. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se punonjësit shqiptarë janë më të motivuar nga pagesat e larta, çka ka një ndikim më të ulët në aspektin psikologjik. Për shqiptarët, mungesa e interaktivitetit dhe izolimi social nuk kanë një ndikim aq të theksuar sa tek italianët.

**Grafikë 2.19: Menaxhimi i kohës i PD në Shqipëri**



*në Itali*


**Grafikë 2.20: Menaxhimi i kohës i PD**



Burimi: Autorë (2025)


Referuar të dhënave, italianët dhe shqiptarët përballen me probleme në menaxhimin e kohës mes punës dhe aktiviteteve personale apo familjare. Kjo sfidë është e pranishme në të dyja vendet, pasi ndarja e kohës mes detyrave profesionale dhe angazhimeve personale mund të krijojë vështirësi në ruajtjen e ekuilibrit racional.

**Grafikë 2.21: Konfuzioni i detyrave i PD në Shqipëri në Itali**



Burimi: Autorë (2025)

**Grafikë 2.22: Konfuzioni i detyrave i PD**



Bazuar në të dhënat e studimit, mund të themi se punonjësit shqiptarë janë ndjerë më shumë konfuzë në ndarjen e detyrave sesa italianët. Kjo, pasi rreth 50% e të anketuarve në Itali pohojnë se nuk kanë pasur probleme me detyrat që u janë caktuar nga organizatat ku punojnë në distancë. Kjo tregon se punonjësit italianë kanë pasur më shumë qartësi dhe strukturë në organizimin e detyrave të tyre, ndërsa punonjësit shqiptarë kanë hasur vështirësi më të mëdha në menaxhimin e detyrave të caktuara. Kjo mund të lidhet me eksperiencën më të gjatë të italianëve në punën në distancë dhe mundësinë e një mbështetjeje më të mirë nga organizatat e tyre.

## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

- Punësimi në distancë ofron një zgjidhje efikase për të reduktuar shpenzimet e udhëtimit dhe të gjitha shpenzimet që lidhen me punësimin tradicional në zyrë. Kjo formë punësimi është një mundësi ideale për gratë që kanë fëmijë të vegjël, pasi ato mund të punojnë dhe të kujdesen për fëmijët e tyre në të njëjtën kohë.
- Italia e ka më të zhvilluar punën në distancë, krahasuar me Shqipërinë. Ky zhvillim i punës në distancë në Itali sepse bizneset italiane kanë adoptuar më shpejt teknologjitë e nevojshme për të mundësuar punën në distancë dhe për të mbështetur punonjësit në këtë model të ri pune.
- Punësimi në distancë ka hapur mundësi të reja për punonjësit shqiptarë, duke iu dhënë mundësinë të punojnë për kompani ndërkombëtare dhe të përfitojnë paga në nivele evropiane. Kjo mënyrë punësimi ka kontribuar në rritjen e financave personale dhe përmirësimin e mirëqenies së individëve.
- Si në Itali, edhe Shqipëria mund të adoptojë politika të punës fleksibël që lejojnë punonjësit të kombinojnë jetën profesionale dhe atë personale në mënyrë më efikase, duke rritur kështu produktivitetin dhe kënaqësinë në punë.
- Tregu Shqiptar duhet t'i mundësojë të rinjve më shumë informacione në lidhje me kompani ndërkombëtare që punësojnë në distancë, një strategji tjetër efikase do të ishte organizimi i trajnimeve për menaxhimin e punës në distancë. Trajnimet mund të përfshijnë zhvillimin e aftësive teknike dhe menaxheriale, të cilat janë thelbësore për punën në distancë dhe mund të ndihmojnë punonjësit të adaptohen më lehtë në këtë model pune.

## **REFERENCA**

- Antropov, S. (2008). Who and when invented remote work? [online] [cit. 2021-14-02]. Available: <https://www.kadrof.ru/history.shtml>
- Cooper, C., and Kurland, N. B. (2012). "Telecommuting, professional isolation and employee development in public and private organizations", *Journal of Organizational Behavior*, 23(4): 511–532.
- Deloitte. (2018). Deloitte Millennial Survey. Retrieved from <https://www2.deloitte.com/global/en/pages/about-deloitte/articles/millennialsurvey.html>
- Errichiello, L. and Pianese, T. (2016) Organizational Control in the Context of Remote Work Arrangements: A Conceptual Framework: 273–305.

- Harrington, S. J. and Ruppel, C. P. (1999) Telecommuting: a test of trust, competing values, and relative advantage. IEEE Trans. Prof. Commun: 42, 223–239
- International Labour Organization (ILO) (2020). An employers' guide on working from home in response to the outbreak of COVID-19. Geneva: International Labour Office
- Kossek, E. E. and Friede, A. (2016). The business case: Managerial perspectives on work and the family. In: Pitt- Catsouphe, M., Kossek, E. E. and Sweet, S. (eds.): 30
- Lake, A. (2015). The Smart Working Handbook. Flexibility.co.uk Ltd. Retrieved from <http://www.flexibility.co.uk/SmartWorkHandbook/index.asp%5Cnëëë.flexibility.co.uk>
- Lee, R., & Perrin, A. (2016). Technology Adoption by Baby Boomers (and everybody else) | Pew Research Center. Retrieved November 25, 2018, from <http://www.pewinternet.org/2016/03/22/technology-adoption-by-baby-boomers-and-everybody-else/>
- Mayo, M., Pastor, J.-C., Gomez-Mejia, L. and Cruz, C. (2009) Why some firms adopt telecommuting while others do not: a contingency perspective. Hum. Resour. Manag., 48: 917–939.
- Nilles, J.M. (2004). “Making telecommuting happen: A guide for telemanagers and telecommuters”, NewYork: Van Nostrand Reinhold: 45
- Stredwick Nohria, N. and Eccles, R.G. (2015). Face-to-face: Making network organizations work. In N. Nohria and R. G. Eccles (Eds.), Networks and organizations, Boston: Harvard Business School Press. *The work- family handbook: Multi- disciplinary perspectives, methods and approaches*: 611- 628
- World Economic Forum (2020). The Future of Job: Report 2020. [online] [cit.2021-27-02]. Available: [http://www3.weforum.org/docs/WEF\\_Future\\_of\\_Jobs\\_2020.pdf](http://www3.weforum.org/docs/WEF_Future_of_Jobs_2020.pdf)
- **Burime Interneti**
- [Agjencia Për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore](#) (aksesuar 07.12.2024)
- [The advantages and disadvantages of remote working from the perspective of young employees](#) (aksesuar 08.12.2024)
- [50 Eye-Opening RemoteWork Statistics for 2024](#) (aksesuar 20.12.2024)
- [Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare](#) (aksesuar 15.12.2024)
- [Inside the Invasive, Secretive “Bossware” Tracking Workers | Electronic Frontier Foundation](#) (aksesuar 15.12.2024)
- [Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare](#) (aksesuar 15.12.2024)

# VENDIMET FINANCIARE AFATGJATA NË PRAKTIKËN E INVESTIMEVE

**Malvina HYSA**

Kolegji Universitar “LOGOS”, Tiranë, Shqipëri

[malvina.hysa@kulogos.edu.al](mailto:malvina.hysa@kulogos.edu.al)

**Dori RISILIA**

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

[drisilia@ubt.edu.al](mailto:drisilia@ubt.edu.al)

**Edisela MENA**

Kolegji Universitar “LOGOS”, Tiranë, Shqipëri

[edisela.mena@kulogos.edu.al](mailto:edisela.mena@kulogos.edu.al)

## Abstrakt

Çdo vendim financiar është i lidhur ngushtë me zgjedhjen e burimeve të fondeve, për aktivitetet operative dhe investuese të kompanisë dhe qëllimi i tyre përfundimtar është rritja e kapitalit në kushte të përshtatshme.

Këto vendime kanë të bëjnë me përdorimin e fitimeve, tërheqjen e fondeve të marra hua dhe shlyerjen e kredive, si dhe krijimin e një strukture optimale të kapitalit.

Treguesit më të rëndësishëm të efektivitetit të vendimeve financiare afatgjata janë kostoja e kapitalit dhe leva financiare.

Kështu, norma e kthimit të kapitalit të investuar duhet të jetë më e lartë se kostoja e kapitalit të tërhequr. Rritja e vlerës së biznesit për pronarët e tij është qëllimi afatgjatë i vendimeve që merren.

Kompanitë, që ndjekin projektet e tyre të para të mëdha të investimeve mund të kërkojnë mbështetje profesionale në inxhinierinë e investimeve, modelimin financiar dhe menaxhimin e projekteve.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë, si aplikohen apo implementohen vendimet financiare afatgjata, në praktikën e investimeve të reja.

**Fjalët kyçe:** *vendime financiare, investime, kosto financiare, fonde*

## 1.1. BAZAT TEORIKE TË VENDIMEVE FINANCIARE

Një vendim mund të interpretohet si një zgjedhje e vetëdijshme dhe jo e rastësishme e një prej opsioneve për veprim (alternativat).

Procesi i vendimmarrjes në praktikën e investimeve përfshin sa vijon:

- *Njohja dhe përcaktimi i situatës aktuale.*
- *Kërkimi dhe identifikimi i mënyrave alternative të veprimit.*

- *Përzgjedhja e alternativës më të mirë dhe zbatimi i saj.*
- *Miratimi i vendimeve përfundimtare nga drejtuesit.*

Marrja e vendimeve për investime lidhet me menaxhimin e projektit dhe mund të konsiderohet si pjesë e tij.

**Menaxhimi i projektit** është një grup aktivitetesh që përfshijnë planifikimin, marrjen e vendimeve, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e projekteve (kryesisht ato komerciale). Një sistem efektiv menaxhimi kërkon marrjen e vendimeve të duhura. "E drejta" do të thotë të sjellësh rezultate të pritshme.

**Financimi** është një proces i bërjes së ndryshimeve në kapital.

Financimi mund të ndahet në pasiv, i cili konsiston në rritjen e kapitalit, dhe financim aktiv, i cili përfshin të gjitha aktivitetet që synojnë marrjen e kapitalit afatgjatë dhe afatshkurtër. Kjo përfshin çdo aktivitet që synon ruajtjen e likuiditetit, kontrollin e kostos, përgatitjen e dokumentacionit financiar dhe pasqyrave.

Menaxhimi financiar i shoqërisë konsiston në marrjen e burimeve të financimit për aktivitetet e shoqërisë (kapitalit) dhe vendosjen e tyre në mënyrë të tillë që të arrihet qëllimi financiar strategjik. Ky synim është në fund të fundit të maksimizojë përfitimet për pronarët dhe të rrisë vlerën e biznesit.

Këto vendime mbulojnë dy fusha kryesore.

**E para** mbulon menaxhimin e strukturës financiare dhe konsiston në marrjen e vendimeve në fushën e rritjes së kapitalit, në veçanti raportin e kapitalit të vet dhe kapitalit të huazuar (borxhit). Vendimet për të rritur pjesën e kapitalit aksionar rrisin pjesën e burimeve më të qëndrueshme të financimit, por kontribuojnë në procese të tilla si ndarja dhe ndryshimi i strukturës së kapitalit të vet, si dhe rritja e kostove si rezultat i emetimit të letrave me vlerë. Nga ana tjetër, vendimi për rritjen e peshës së kapitalit të huazuar shoqërohet me problemin e kushteve të huamarrjes.

Kjo është kritike për përcaktimin e kostove të shërbimit të borxhit dhe planifikimin për nevojat e ardhshme të financimit, pasi financimi afatgjatë është shumë i ndryshëm nga financimi i kapitalit.

**Fusha e dytë** mbulon menaxhimin e strukturës së aseteve. Qëllimi i vendimeve të marra është rritja ose zvogëlimi i vlerës së llojeve të caktuara të aseteve (pasuria fikse, kapital qarkullues). Vendimi për të rritur asetet shpesh çon në një rritje të potencialit prodhues të kompanisë, por detyron departamentin e menaxhimit të kërkojë burime shtesë financimi. Nga ana tjetër, vendimi për uljen e vlerës së aktiveve si rezultat i likuidimit të tyre i lejon kompanisë të rrisë burimet financiare, por mund të kufizojë potencialin e prodhimit. Koha, risku dhe vendimet financiare janë kategoritë kryesore mbi të cilat bazohet teoria moderne e menaxhimit financiar.

## 1.2 DETYRAT E MENAXHIMIT FINANCIAR

Detyrat kryesore të menaxhimit financiar përfshijnë:

- Rritjen e fitimeve, e cila është e nevojshme për zhvillimin e kompanisë.
- Maksimizimin e vlerës së biznesit për pronarët (aksionarët).
- Pagesën e borxhit lidhur me aktivitetet investuese.
- Ruajtjen e likuiditetit të kompanisë.
- Aftësinë paguese, e cila është gjithmonë e lidhur me likuiditetin financiar.
- Humbja ose zvogëlimi i likuiditetit rrezikon aftësinë e kompanisë për të gjeneruar fitime. Një problem tjetër është zvogëlimi i fleksibilitetit të veprimeve të menaxhimit gjatë marrjes së vendimeve. Ekziston gjithashtu rreziku i humbjes së interesit të investitorëve dhe përkeqësimit të pozicionit të kompanisë në treg.
- Vendimmarrja financiare duhet të bazohet në parimet e minimizimit të riskut, përmirësimit të raportit të ardhura/rrezikut, analizës së flukseve monetare, zgjedhjes së alternativave më të mira të investimit dhe kontrollit.

### **1.3 VENDIMET FINANCIARE AFATGJATA NË MENAXHIMIN FINANCIAR**

Menaxhimi financiar është procesi i marrjes së tre llojeve të vendimeve: operacionale, investuese dhe financiare.

Ky klasifikim rrjedh nga përkufizimet e zakonshme të përdorura në pasqyrat e flukseve monetare.

Të ashtuquajturat vendime operacionale përfshijnë menaxhimin e performancës aktuale financiare, duke përfshirë të ardhurat, kostot, fitimet, si dhe fluksin aktual të parasë dhe likuiditetin e kompanisë.

*Zgjidhjet operative përfshijnë:*

- Miratimin e parametrave të financimit.
- Planifikimin e nivelit të përfitueshmërisë së aktivitetit të biznesit.
- Zhvillimin dhe miratimin e një programi për aktivitetet aktuale të kompanisë.
- Gjetjen e mënyrave për të siguruar detyrimet aktuale të kompanisë.
- Kërkimin e parave të tepërta për investime afatshkurtra.

Vendimet për investime kanë të bëjnë me shpërndarjen e kapitalit. Ky grup zgjidhjesh përfshin:

- Vendimet në lidhje me aktivet fikse materiale.
- Vendimet në lidhje me aktivet financiare fikse/rrjedhëse.

Subjekti i vendimeve financiare është zgjedhja e burimeve të financimit për aktivitetet aktuale (operative) dhe investuese të kompanisë. Me fjalë të tjera, këto janë vendime për rritjen e kapitalit. Vendimet e financimit përfshijnë vendimet për rritjen e kapitalit të vet, përdorimin e fitimeve, tërheqjen e kredive, si dhe vendimet që krijojnë të ashtuquajturën strukturë optimale të kapitalit.

Treguesit kryesorë për vlerësimin e efektivitetit të këtyre vendimeve janë kostoja e kapitalit dhe shkalla e levës financiare.

## 1.4 LLOJET E VENDIMEVE FINANCIARE NË VARËSI TË FLUKSEVE TË PARASË

**Tabela 1**

| <b>Vendimet që çojnë në hyrje monetare dhe rritje të kapitalit të kompanisë</b>   | <b>Vendimet që çojnë në dalje monetare dhe ulje të kapitalit të kompanisë</b>                                         |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Marrja e kredive nga bankat                                                       | Shlyerja e kredive                                                                                                    |
| Tërheqja e kredive nga institucionet e tjera                                      | Shlyerja e letrave me vlerë të borxhit                                                                                |
| Emetimi i letrave me vlerë të borxhit për tregjet financiare vendase dhe të huaja | Pagesa për detyrime të tjera të shoqërisë                                                                             |
| Përdorimi i instrumenteve të borxhit                                              | Pagesat sipas marrëveshjeve të qirasë financiare                                                                      |
| Të ardhurat nga aksionet dhe kontributet në kapitalin e autorizuar                | Ulja e borxhit të varur                                                                                               |
| Hyrje të tjera financiare                                                         | Dividendë dhe pagesa të tjera për pronarët<br>Riblerja e aksioneve të vetë shoqërisë<br>Shpenzime të tjera financiare |

**Burimi:** Autori

## 1.5 AKTIVITETI FINANCIAR PËRGJATË PERIUDHAVE TË INVESTIMEVE TË REJA

Aktiviteti financiar ka të bëjë me blerjen/shlyerjen e detyrimeve të borxhit.

Këto janë transaksione me aksionarët, bankat dhe kreditorët e tjerë. Vendimet operative, investuese dhe financiare janë të rëndësishme për të arritur qëllimet e kompanisë.

Mund të flasim vetëm për një sekuencë të caktuar të tyre.

Procesi i menaxhimit financiar fillon me formulimin e nevojave, pra mundësive për fillimin e një biznesi dhe vazhdon me vendimin për ndryshimin e strukturës dhe nivelit të aseteve. Sigurisht, këto plane shoqërohen me mundësi dhe kushte të ndryshme financimi.

Vendimet për investime (identifikimi i nevojave) janë një parakusht për marrjen e vendimeve financiare. Kapitali i akumuluar lejon marrjen e vendimeve të përsëritura të investimeve, dhe më pas vendimet operationale që përcaktojnë zbatimin e biznesit kryesor të njësisë ekonomike. Vendimet operationale ndikojnë në rezultatet dhe rrjedhën e kompanisë. Duke formuar shpenzimet dhe të ardhurat, kompania gjeneron një rezultat financiar, i cili është pjesë e kapitalit të vet, kështu që ndikon në strukturën e kapitalit. Vlera e lartë e flukseve monetare pozitive nga aktivitetet operative lejon marrjen e vendimeve të reja për investime.

## 1.6 PËRFUNDIMET

- Vendimet e investimeve përcaktojnë shkallën dhe strukturën e aktiveve të prekshme të nevojshme për të drejtuar një biznes.
- Vendimet për investime kanë gjithashtu ndikim në madhësinë dhe strukturën e aktiveve financiare (investimet financiare). Ekziston një marrëdhënie e ngushtë midis vendimeve të investimeve dhe financiare.
- Vendimet për investime kanë të bëjnë me përdorimin e kapitalit.
- Vendimet e financimit kanë të bëjnë me marrjen e burimeve të financimit për këto asete (madhësia, llojet dhe struktura).
- Ato lidhen me zgjedhjen e llojeve dhe strukturës së burimeve të financimit, koston e mënyrave alternative të financimit të investimeve të planifikuara dhe strukturën e kapitalit, duke përfshirë pjesën e kapitalit të vet të formuar nga riinvestimi.
- Qëllimi i këtyre vendimeve është të arrihet efekti maksimal i mundshëm me profilin ekzistues të biznesit dhe një strukturë të qëndrueshme kapitali.
- Vendimet financiare afatgjata lidhen me praktikën e investimit. Të gjitha vendimet lidhur me rritjen e kapitalit, shlyerjen e borxheve dhe përdorimin e fondeve për aktivitete operative dhe investuese do të jenë të natyrës financiare.
- Vendimet financiare merren në bazë të planeve, kontratave, llogaritjeve dhe analizave të ndryshme paraprake.

## REFERENCA

- Agnew, J. 2023. Behavioral Finance and Retirement Planning in Defined Contribution Plans.
- Hilary, G. and R. D. McLean (eds.), Handbook of Financial Decision Making, Edward Elgar Publishing, Cheltenham.
- Ahern, K.R. and J. Peres. 2023. The Role of Media in Financial Decision-Making. In: Hilary, G. and R. D. McLean (eds.), Handbook of Financial Decision Making, Edward Elgar Publishing, Cheltenham.
- Ai, H. Frank, M. and Sanati, A. 2021. The trade-off theory of corporate capital structure. Oxford Research Encyclopedia of Economics and Finance.
- Baker, M. and J. Wurgler. 2011 Behavioral corporate finance: an update survey, National Bureau of Economic Research
- Bali, T. and Q. Wen, 2023. Preference for Lottery-like Securities. In: Hilary, G. and R. D. McLean (eds.), Handbook of Financial Decision Making, Edward Elgar Publishing, Cheltenham

# ARSIMI ONLINE DHE I KOMBINUAR NË SISTEMIN E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI: SFIDAT DHE RRUGA PËRPARA

**Dr. Blerta DRENOFCI**

blerta.drenofci@kulogos.edu.al

Departamenti Pedagogji – Psikologji

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor

### Abstrakt

Artikulli shqyrton gjendjen aktuale, sfidat dhe potencialin e arsimit online dhe atij të kombinuar në Shqipëri, brenda kontekstit më të gjerë të tendencave globale dhe evropiane. Përmes digjitalizimit, që gjithnjë e më tepër po bëhet pjesë integrale e arsimit modern, Shqipëria përballet me një mundësi unike për të integruar mësimdhënien online në sistemin e saj të arsimit të lartë. Megjithatë, ende ka pengesa të rëndësishme, të cilat përfshijnë që nga boshllëqet në legjislacion, infrastrukturën e pamjaftueshme, kapacitetet e stafit akademik, por edhe shqetësimet për garantimin e cilësisë.

Analiza fillon me shqyrtimin e arritjeve në nivel global dhe kornizat politike evropiane, korniza të cilat, theksojnë përfshirjen, kompetencën digjitale dhe sigurimin e cilësisë, duke ofruar një udhërrëfyes për integrimin e metodave inovative të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë. Dokumenti evidenton sfidat specifike për kontekstin shqiptar, por ofron gjithashtu rekomandime konkrete për hartimin e politikave dhe reformave institucionale.

**Fjalë kyçe:** *arsimi i lartë, mësimi online dhe i kombinuar, korniza politike evropiane, legjislacioni, politika dhe reforma institucionale*

### I. Hyrje

Në dekadat e fundit, mësimdhënia online dhe ajo e kombinuar janë konsoliduar si komponentë thelbësorë të arsimit të lartë, duke ndikuar ndjeshëm në transformimin e pedagogjive tradicionale dhe në riformësimin e parametrave të aksesit dhe fleksibilitetit në të nxënë. Vetëm në Shtetet e Bashkuara, gjatë semestrit të vjeshtës 2023, 54.3 % e studentëve universitarë ishin të regjistruar në të paktën një kurs online; 26.4 % ndiqnin ekskluzivisht studime në distancë, ndërsa 27.9 % ishin të përfshirë në programe të kombinuara që ndërthurin mësimdhënien online me atë ballë për ballë (National Center for Education Statistics, 2024).

Këto modalitete, të mbështetura në teknologjitë digjitale, kanë evoluar përtej rolit plotësues, duke u shndërruar në mjete kryesore për përmirësimin e cilësisë dhe për të përmbushur nevojat e një popullate studentore gjithnjë e më të larmishme – përfshirë profesionistë në punë, studentë nga zona të largëta dhe individë me aftësi të kufizuara. Si të tilla, ato përfaqësojnë shtylla qendrore të inovacionit akademik, që i mundësojnë institucioneve të arsimit të lartë të përgjigjen më mirë kërkesave të një shoqërie globale dhe të digjitalizuar (Allen & Seaman, 2017; Picciano, 2012).

Mësimdhënia online zakonisht përkufizohet si ofrimi ekskluziv i përmbajtjes edukative dhe ndërveprimit përmes platformave digjitale, ku të gjitha aspektet e procesit mësimor—nga leksionet dhe diskutimet deri te detyrat dhe vlerësimet—zhvillohen në mënyrë virtuale. Kjo qasje mundëson si angazhim sinkron, në kohë reale, ashtu edhe studim asinkron me ritme të vetë-përcaktuara, duke ofruar nivele të larta fleksibiliteti për studentët (Means et al., 2013). Megjithatë, literatura kritike thekson se përkundër fleksibilitetit të shtuar, formatet plotësisht online mund të vuajnë nga nivele më të ulëta angazhimi, mungesë ndërveprimi social dhe sfida në ruajtjen e cilësisë në vlerësim dhe në përvojat praktike (Jaggars & Xu, 2016; Dhaëan, 2020).

Ndërkohë, mësimdhënia e kombinuar (blended learning) përfshin një ndërthurje të menduar të mësimdhënies ballë për ballë me përbërës online, duke synuar të përfitojë nga pikat e forta të të dy metodologjive. Sipas Garrison dhe Vaughan (2008), ajo përfaqëson një formë të re të dizajnit mësimor që kërkon jo thjesht shtimin e teknologjisë, por një ri-konceptualizim të përvojës së të nxënit. Megjithatë, studime më të fundit kanë sugjeruar se suksesi i mësimdhënies së kombinuar varet ndjeshëm nga përgatitja e stafit akademik, përshtatja institucionale dhe investimi në dizajnin pedagogjik të kurseve (Hodges et al., 2020). Në mungesë të këtyre faktorëve, përfitimet e saj mund të mbeten të kufizuara.

Këto dy qasje ndryshojnë në varësinë e tyre nga prania fizike dhe ndërveprimi. Mësimdhënia online eliminon plotësisht nevojën për angazhim fizik, duke ofruar aksesueshmëri të pakrahasueshme për nxënësit që kanë kufizime për shkak të vendndodhjes, gjendjes shëndetësore ose orareve. Ndërkohë, mësimdhënia e kombinuar ruan strukturën e klasave tradicionale, ndërsa integron mjete digjitale për të përmirësuar rezultatet mësimore. Kjo ndërthurje mundëson një balancë midis fleksibilitetit dhe lidhjes ndërpersonale, duke e bërë atë një model të preferuar për institucionet që kërkojnë të modernizohen, pa braktisur kampuset fizike.

Transformimi i shpejtë i arsimit online dhe të kombinuar reflekton ndërthurjen e përparimeve teknologjike, ndryshimeve në filozofinë arsimore dhe kërkesës në rritje të shoqërisë për qasje të shkallëzuar dhe të përqendruar te nxënësi. Ky transformim u përshpejtua më tej nga pandemia COVID-19, e cila detyroi sistemet e arsimit të lartë në mbarë botën të kalojnë papritmas në modalitete online. Për shumë institucione, ky ndryshim theksoi si potencialin transformues ashtu edhe sfidat e natyrshme të arsimit online, duke nënvizuar nevojën për strategji të mësimdhënies hibride si një zgjidhje afatgjatë (Hodges et al., 2020). Universitetet tashmë, synojnë të shfrytëzojnë këto modalitete, jo vetëm për t'iu përshtatur kërkesave të një bote të globalizuar dhe të ndërlidhur, por edhe për të adresuar çështje të vazhdueshme të përfshirjes, fleksibilitetit dhe aksesueshmërisë (Means et al., 2013; Crawford et al., 2020).

Ky diskutim vjen në kohën e duhur në kontekstin shqiptar, ku sistemi arsimor ka nisur një proces ambicioz digjitalizimi si pjesë e përpjekjeve më të gjera për modernizimin kombëtar. Megjithëse vendi ka bërë përparime në adoptimin e teknologjive digjitale, sfida të tilla si infrastruktura teknologjike e pabarabartë, trajnimi i kufizuar i stafit akademik dhe pabarazitë në aksesin e studentëve, mbeten pengesa të rëndësishme. Sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri duhet të orientojë këto pengesa për të integruar plotësisht mësimdhënien online dhe të

kombinuar në mënyra që janë njëkohësisht efektive dhe krijojnë mundësi të barabarta. Ky dokument e vendos fokusin e tij brenda kontekstit kombëtar në zhvillim, duke njohur se integrimi i të dyja metodave përfaqëson jo vetëm një ndryshim cilësor arsimor, por edhe një hap më tej, në përputhje me tendencat globale të digjitalizimit.

## **II. Hulumtim në Literaturë**

Hulumtimet mbi arsimin online dhe të kombinuar janë fokusuar kryesisht në tre fusha kryesore: efektivitetin pedagogjik, integrimin teknologjik dhe ndikimin institucional. Studimet e hershme u përqendruan në realizueshmërinë e arsimit online si një zëvendësim ose shtesë për mësimdhënien tradicionale ballë për ballë. Harasim (2000) theksoi ndryshimin paradigmatic të mundësuar nga mjediset e të nxëniet të bazuara në kompjuter, duke nxjerrë në pah mënyrën se si platformat online kanë riformuluar ndërveprimin dhe bashkëpunimin midis studentëve dhe pedagogëve.

Studime të mëvonshme, si ato nga Graham (2006), Means et al. (2013), dhe Allen dhe Seaman (2017), kanë shqyrtuar efektivitetin e mjediseve të të nxëniet të kombinuar. Kërkimet kanë treguar në mënyrë të vazhdueshme se mësimi i kombinuar rezulton më efektiv sesa mësimdhënia tradicionale, veçanërisht në përmirësimin e rezultateve të studentëve, falë ndërthurjes së udhëzimeve online me ato ballë për ballë (Means et al., 2013). Gjithashtu, evidencat nënvizojnë potencialin e arsimit online për të adresuar nevojat e një popullate studentore të larmishme, përfshirë profesionistë në punë, studentë nga zona të largëta dhe persona me aftësi të kufizuara.

Avancimet teknologjike kanë qenë gjithashtu një fokus kryesor në studime të ndryshme. Hulumtimet nga Picciano (2012) dhe Hrastinski (2008) kanë eksploruar rolin e teknologjive në përmirësimin e angazhimit të studentëve dhe personalizimin e udhëzimeve. Këto studime theksojnë rëndësinë e shfrytëzimit të mjeteve të bazuara në të dhëna për të identifikuar studentët në rrezik, për të përmirësuar dizajnin e kurseve dhe për të mbështetur nevojat e larmishme të të nxëniet.

Studimet kanë nxjerrë në pah ndikimin më të gjerë të arsimit online dhe atij të kombinuar në sistemet e arsimit të lartë. Boëen et al. (2014) analizuan kosto-efektivitetin, duke treguar se si arsimi online mund të ulë kostot operacionale ndërsa zgjeron arritjen institucionale. Ndërkohë, studime si ato nga Yuan dhe Powell (2013) kanë shqyrtuar shkallëzueshmërinë, duke theksuar aftësinë e arsimit online për të akomoduar popullata të mëdha studentore dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar.

Në kontekstin rajonal, kërkime janë kryer mbi adoptimin e arsimit online në Evropën Juglindore, por Shqipëria mbetet ndjeshëm e nën-përfaqësuar. Studimet rajonale, si ato nga Komisioni Evropian (2021) dhe UNESCO (2021), kanë dokumentuar përpjekjet për të integruar arsimin digjital në sistemet e arsimit të lartë. Këto studime theksojnë sfida të përbashkëta, përfshirë hendekët digjitalë, infrastrukturën e kufizuar dhe nevojën për trajnimin e stafit akademik.

Në Shqipëri, kërkimet mbi arsimin online dhe të kombinuar mbeten të kufizuara, me pjesën më të madhe të analizave të zhvilluara pas pandemisë COVID-19. Ndër kontributet e pakta me karakter analitik është raporti i Institutit Shqiptar të Medias (2020), i cili dokumenton kalimin e menjëhershëm drejt mësimdhënies online gjatë periudhës së izolimit. Ky raport vë në dukje sfida të theksuara si aksesin e pamjaftueshëm në internet, pabarazitë në kompetencat digjitale dhe mungesën e një niveli të barabartë gatishmërie institucionale. Për pasojë, mësimdhënia

online në Shqipëri gjatë kësaj periudhe u karakterizua më shumë nga reagimi emergjent sesa nga një qasje e planifikuar si strategji.

### III. KORNIZAT POLITIKE PËR ARSIMIN ONLINE DHE TË KOMBINUAR

#### III.1. Korniza Politike Evropiane

Bashkimi Evropian (BE) ka zhvilluar politika dhe iniciativa gjithëpërfshirëse për të mbështetur integrimin e arsimit online dhe të kombinuar në të gjitha shtetet anëtare. Këto korniza synojnë të sigurojnë sisteme arsimore digjitale cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme, që adresojnë sfidat e epokës digjitale, duke promovuar akses të barabartë dhe inovacion.

Një nga iniciativat kryesore është *Plani i Veprimit për Arsimin Digjital (2021–2027)*<sup>22</sup>, një politikë kryesore e Komisionit Evropian e hartuar për të përshpejtuar transformimin digjital të sistemeve arsimore.

*Zona Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA)*<sup>23</sup> siguron një kornizë për harmonizimin e arsimit të lartë në të gjithë Evropën, duke përfshirë integrimin e modaliteteve online dhe të kombinuara. EHEA lehtëson njohjen e kualifikimeve të fituara përmes të nxënimit digjital, duke siguruar që programet online dhe të kombinuara të përmbushin standarde të rrepta të sigurimit të cilësisë.

*Procesi i Bolonjës*<sup>24</sup>, thelbësor për reformën e arsimit të lartë në Evropë, thekson përputhshmërinë dhe krahasueshmërinë e diplomave midis shteteve anëtare. Ai inkurajon adoptimin e metodave inovative të mësimdhënies, përfshirë teknologjitë digjitale, për të përmirësuar rezultatet mësimore dhe lëvizshmërinë e studentëve.

*Rekomandimet e Këshillit për Mësimin e Kombinuar*<sup>25</sup>, të miratuara në vitin 2021, përfaqësojnë një përpjekje të fokusuar për të integruar të nxënimit online dhe atë ballë për ballë si në arsimin e lartë ashtu edhe në atë parashkollor.

Mbështetja financiare luan një rol vendimtar në zbatimin e këtyre kornizave. Iniciativa të tilla si *Next Generation EU dhe Programi Evropa Digjitale*<sup>26</sup> alokojnë burime për përmirësimin e infrastrukturës digjitale në universitete, zhvillimin e kampuseve virtuale dhe nxitjen e partneriteteve publike-private në teknologjitë edukative.

Për më tepër, *Agjenda Evropiane për Aftësitë*<sup>27</sup> nënvizon rëndësinë e pajisjes së studentëve dhe punonjësve me aftësitë e kërkuara për epokën digjitale.

BE-ja gjithashtu mbështet iniciativat e arsimit të hapur, si *Konsorciumi Evropian i MOOC (EMC)*<sup>28</sup> dhe *Open Education Europa*<sup>29</sup>, të cilat synojnë të rrisin aksesin në materiale mësimore cilësore.

#### III.2. Korniza Politike Shqiptare për Arsimin Online dhe të Kombinuar

<sup>22</sup> <https://education.ec.europa.eu/focus-topics/digital-education/action-plan>

<sup>23</sup> <https://eha.info/>

<sup>24</sup> <https://education.ec.europa.eu/education-levels/higher-education/inclusive-and-connected-higher-education/bologna-process>

<sup>25</sup> <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-14484-2021-INIT/en/pdf>

<sup>26</sup> [https://next-generation-eu.europa.eu/index\\_en](https://next-generation-eu.europa.eu/index_en)

<sup>27</sup> <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/activities/digital-programme>

<sup>28</sup> [https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/policies-and-activities/skills-and-qualifications/european-skills-agenda\\_en](https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/policies-and-activities/skills-and-qualifications/european-skills-agenda_en)

<sup>29</sup> <https://emc.eadtu.eu/>

Në Shqipëri, integrimi i të mësuarit online dhe atij të kombinuar në arsimin e lartë është ende në fazat e tij fillestare. Ndërsa kornizat evropiane ofrojnë udhëzime të vlefshme, vendi ynë përballlet me sfida unike që lidhen me infrastrukturën, njohuritë digjitale dhe mbështetjen rregullatore. Megjithatë, zhvillimet e fundit politike tregojnë një angazhim në rritje për transformimin digjital të arsimit të lartë.

*Ligji Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor*<sup>30</sup> shërben si korniza kryesore legjislative për arsimin e lartë në Shqipëri. Edhe pse nuk adreson në mënyrë të qartë modalitetet e mësimdhënies online apo të kombinuar, ky ligj vendos strukturën themelore për institucionet e arsimit të lartë (IAL). Amendime të ardhshme në këtë ligj janë të nevojshme për të përfshirë plotësisht kërkesat e arsimit digjital.

*Strategjia Kombëtare e Arsimit (2021–2026)*<sup>31</sup> përcakton një vizion strategjik për modernizimin e sistemit arsimor të Shqipërisë, me një fokus të fortë në integrimin e teknologjive digjitale në arsimin e lartë. Kjo strategji përqendrohet në disa fusha kryesore: (i) Zhvillimi i Infrastrukturës Digjitale; (ii) Trajnimi dhe Zhvillimi i Mësuesve; (iii) Modelet e Mësimdhënies së Kombinuar; (iv) Përshtatjet Ligjore dhe Rregullatore; (v) Përmirësimi i Njohurive Digjitale

*Agjenda Digjitale e Shqipërisë*<sup>32</sup> (2015–2020, e zgjatur deri në 2030) plotëson strategjinë e arsimit të lartë, duke u përqendruar në zgjerimin e infrastrukturës broadband, promovimin e adoptimit të TIK dhe nxitjen e aftësive digjitale në të gjitha sektorët. Kjo agjendë është në përputhje të ngushtë me iniciativat e BE-së, duke reflektuar aspiratat e Shqipërisë për integrimin evropian.

*Pandemia COVID-19* shërbeu si katalizator për adoptimin e arsimit online në Shqipëri. Masat emergjente, të ndërmarra nga Ministria e Arsimit, mundësuan universitetet të kalojnë në klasa virtuale, duke përdorur platforma si Moodle dhe Microsoft Teams. Edhe pse këto përpjekje fillimisht ishin ad hoc, ato hapën rrugën për një qasje më sistematike në integrimin e të nxënit online në kurrikulat universitare.

Për të mbështetur këto nisma, Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), përditësoi standardet e akreditimit në vitin 2021<sup>33</sup> për të përfshirë programet e të nxënit në distancë. Këto standarde kërkojnë që universitetet të demonstrojnë gatishmëri teknologjike, të ofrojnë mbështetje të fortë për nxënësit online dhe të zbatojnë masa për të siguruar integritetin akademik në vlerësimet online.

## **IV. PËRPARËSITË E ARSIMIT UNIVERSITAR ONLINE DHE TË KOMBINUAR**

Hulumtimi mbi arsimin online dhe të kombinuar në universitete thekson një numër avantazhesh, veçanërisht në aspektet e fleksibilitetit, aksesueshmërisë dhe personalizimit. Më poshtë është një përmbledhje e gjetjeve kryesore nga studime të ndryshme:

<sup>30</sup> <https://european-net.org/2015/06/open-education-europa/>

<sup>31</sup> <https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/LAW-No-80.2015-ON-HIGHER-EDUCATION-AND-SCIENTIFIC-RESEARCH-IN-INSTITUTIONS-OF-HIGHER-EDUCATION-IN-THE-REPUBLIC-OF-ALBANIA.pdf>

<sup>32</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>

<sup>33</sup> ASCAL, 2021. *Accreditation Standards for Distance Education*. Albanian Quality Assurance Agency in Higher Education

*Fleksibilitet në të Nxënë:* Modalitetet online dhe të kombinuara u mundësojnë studentëve të mësojnë me ritmin e tyre dhe sipas orareve të përshtatura me nevojat e tyre, duke i bërë ato veçanërisht të dobishme për nxënësit jo tradicionalë, si profesionistët në punë dhe prindërit. Means et al. (2010) argumentojnë se një fleksibilitet i tillë lehtëson të nxënit gjatë gjithë jetës dhe përmirësimin e aftësive, duke u mundësuar individëve të balancojnë arsimin me angazhimet e tjera. Ky përfitim është veçanërisht relevant në Shqipëri, ku aksesueshmëria në arsim mund të jetë e pabarabartë dhe shumë studentë përballojnë punën dhe studimet njëkohësisht (Quka 2021; Xhelili 2021).

*Aksesueshmëri e Rritur:* Arsimi online është vlerësuar për aftësinë e tij për të reduktuar barrierat gjeografike dhe financiare, duke ofruar arsim cilësor për studentët në zona të largëta ose të nën-shërbyera (Allen & Seaman, 2017). Për Shqipërinë, ku zonat rurale shpesh vuajnë nga mungesa e infrastrukturës edukative, arsimi online ofron një mënyrë për të kapërcyer këto boshllëqe, megjithëse sfidat në depërtimin e internetit dhe aksesin në pajisje vazhdojnë të jenë të pranishme (Instituti Shqiptar i Medias, 2020).

*Personalizim i Përmirësuar:* Teknologjitë e të nxënit adaptiv i mundësojnë platformave online të përshtatin përmbajtjen sipas pikave të forta dhe dobësive të studentëve, duke përmirësuar angazhimin dhe rezultatet. Baker et al. (2019) theksojnë potencialin e këtyre mjeteve për të mbështetur stile të ndryshme të të nxënit, duke nxitur një qasje më gjithëpërfshirëse në arsim. Këto teknologji, megjithëse të nën shfrytëzuara në Shqipëri, përfaqësojnë një mundësi të rëndësishme për përmirësimin e të nxënit të personalizuar.

*Rezultate më të Mira në Arsimin e Kombinuar:* Hulumtimi tregon se studentët në mjedise të të nxënit të kombinuar shpesh performojnë më mirë sesa bashkëmoshatarët e tyre në mjedise tradicionale ose plotësisht online. Kjo i atribuohet kombinimit të ofrimit të përmbajtjes online dhe angazhimit ballë për ballë, që inkurajon një kuptim më të thellë përmes aktiviteteve të larmishme mësimore (Means et al., 2013). Ndërsa arsimi i kombinuar është adoptuar sporadikisht në Shqipëri, potenciali i tij për përmirësimin e rezultateve mbetet kryesisht i pa eksploruar.

*Efektiviteti i Kostos:* Arsimi online ka potencialin për të ulur kostot si për institucionet ashtu edhe për studentët duke ulur tarifat e shkollimit dhe duke reduktuar shpenzime si transporti dhe strehimi. Boëen et al. (2014) argumentojnë se ekonomitë e shkallës, të arritura përmes ofrimit digjital, mund të mbështesin rritjen institucionale pa kërkuar investime të konsiderueshme infrastrukturore, një konsideratë kritike për sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i cili ka burime të kufizuara (Xhelili, 2021; Quka, 2021).

*Zhvillimi i Aftësive:* Studimet tregojnë se arsimi online nxit aftësi të vlefshme si njohuri të digjitale, vetë-disiplina dhe menaxhimi i kohës, të cilat janë gjithnjë e më të rëndësishme në vendin modern të punës (Kintu et al., 2017). Kjo është në përputhje me përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për të pajisur fuqinë e saj punëtore me aftësitë e nevojshme për një ekonomi të digjitalizuar. Arsimi online ka përmirësuar gjithashtu të menduarit kritik, punën në grup dhe njohuri të digjitale midis studentëve. Ai ka nxitur gjithashtu një ndjenjë përgjegjësie dhe pjesëmarrje aktive (Qafëzezi, 2023).

*Rritje e Ndërveprimit dhe Bashkëpunimit:* Forumet online, tabelat e diskutimeve dhe mjetet bashkëpunuese inkurajojnë pjesëmarrje aktive, veçanërisht midis studentëve të ndrojtur ose introvertë, ndërsa promovojnë mundësi për rrjete globale. Hrastinski (2008) thekson potencialin e këtyre mjeteve për të pasuruar të nxënit peer-to-peer dhe diskutimet e larmishme, të cilat mund të jenë shumë të dobishme për sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri duke nxitur bashkëpunimin ndërkulturor dhe ndërdisiplinor (Qafëzezi, 2023).

*Shkallëzueshmëria:* Arsimi online ofron potencial të lartë shkallëzueshmërie, pasi mundëson përfshirjen e një numri të madh studentësh në të njëjtën kohë, pa kërkuar zgjerim proporcional të infrastrukturës fizike (Yuan & Poëll, 2013). Kjo veçori është veçanërisht e rëndësishme për universitetet shqiptare që synojnë të zgjerojnë aksesin në arsim, duke ruajtur njëkohësisht standardet e cilësisë dhe duke menaxhuar kufizimet buxhetore.

*Rezistenca ndaj Krizave:* Roli i arsimit online gjatë krizave, si pandemia COVID-19, theksoi vlerën e tij në sigurimin e vazhdimësisë së të nxënës (Hodges et al., 2020). Në Shqipëri, pandemia nxori në pah si mundësitë ashtu edhe sfidat e mësimdhënies online, duke theksuar nevojën për një infrastrukturë digjitale të fuqishme për të mbështetur qëndrueshmërinë në të ardhmen (Instituti Shqiptar i Medias, 2020).

*Përfitime Mjedisore:* Arsimi online redukton gjurmën e karbonit të lidhur me transportin dhe objektet e kampusit, duke mbështetur praktika të qëndrueshme në arsimin e lartë (Roy et al., 2008). Ky aspekt përputhet me objektivat më të gjera të qëndrueshmërisë të Shqipërisë si pjesë e përpjekjeve për integrimin evropian.

*Përmirësimi i Efektivitetit të stafit pedagogjik:* Modelet e kombinuara u ofrojnë stafëve pedagogjike të dhëna mbi performancën e studentëve përmes analitikës së të nxënës. Ato lehtësojnë ndërhyrjet e synuara dhe mbështetjen dhe inkurajojnë përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies (Picciano, 2012).

Mjediset e të nxënës online dhe të kombinuar lidhen me një *autonomi* më të madhe të studentëve, duke i fuqizuar ata të marrin kontrollin mbi edukimin e tyre dhe duke nxitur një ndjenjë pronësie. Mjediset e sipërpërmendura inkurajojnë të nxënës e drejtuar nga vetja dhe promovojnë të menduarit kritik dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve (Dabbagh & Kitsantas, 2012).

## **V. BOSHLLËQET DHE SFIDAT NË OFRIMIN E ARSIMIT UNIVERSITAR ONLINE DHE TË KOMBINUAR**

Hulumtimet identifikojnë një sërë sfidash që ndikojnë në efektivitetin e arsimit online dhe të kombinuar, përfshirë angazhimin e studentëve, përgatitjen e stafit pedagogjik dhe faktorë sistemikë. Një ndër pengesat më të mëdha mbetet hendeku digjital, i cili prek veçanërisht studentët në zona rurale ose të nën përfaqësuar, të cilët përballen me mungesë aksesimi në internet të qëndrueshëm dhe pajisje adekuate (Van Deursen & Van Dijk, 2019). Paralelisht, një pjesë e konsiderueshme e pedagogëve ndihen të papërgatitur për të hartuar dhe zbatuar mësimdhënie efektive në mjediset virtuale, duke përmendur mungesën e trajnimit profesional dhe mbështetjes teknologjike si pengesa kryesore (Baran et al., 2011). Këto vështirësi janë edhe më të theksuara në kontekste si Shqipëria, ku universitetet publike shpesh përballen me mungesë investimesh në infrastrukturë digjitale dhe zhvillim të stafit, duke thelluar pabarazitë ndërinstitucionale. Përveç këtyre sfidave strukturore, studimet kanë vënë në dukje ndikimet psikologjike të mjedisve të zgjatura online, përfshirë rritjen e stresit, lodhjes dhe shqetësimeve për shëndetin mendor të studentëve dhe mësimdhënësit (Besser et al., 2020). Në mënyrë të ngjashme, kalimi në format virtuale ka ngritur pikëpyetje mbi cilësinë e të nxënës, sidomos në disiplina që mbështeten në mësim praktik apo të bazuar në përvojë, si fushat STEM dhe ato profesionale (Jaggars & Xu, 2016).

*Mungesa e Angazhimit dhe Motivimit:* Një nga sfidat më të theksuara në arsimin online është ruajtja e angazhimit dhe motivimit të studentëve. Studimet tregojnë se pjesëmarrësit në kurset online përjetojnë shpesh nivele më të larta braktisjeje dhe rezultate më të dobëta krahasuar me

ata në mësimin tradicional ballë për ballë (Carter et al., 2020; Garrison & Vaughan, 2008). Mungesa e ndërveprimit të drejtpërdrejtë me stafin pedagogjik dhe bashkëmoshatarët, ndikon negativisht në ndjenjën e përgjegjësisë dhe përkatësisë, ndërsa përmbytja statike dhe interaktiviteti i kufizuar e thellojnë mosangazhimin. Në kontekstin shqiptar, ku mësimdhënia tradicionale është e bazuar fort në komunikim të drejtpërdrejtë dhe hierarkik, shumë studentë kanë hasur vështirësi në përshtatjen me format më të vetëdrejtura dhe autonome të të nxënës online (Hoxha & Toska, 2021; Quka, 2021).

*Akses i Pabarabartë në Teknologji:* Hendeku dixhital është një pengesë kritike për arsimin online, me studentët nga familje me të ardhura të ulëta ose nga zona rurale që preken në mënyrë disproporcionale nga akses i kufizuar në internet të besueshëm dhe pajisje. Van Deursen dhe Van Dijk (2019) theksojnë se pabarazi të tilla forcojnë pabarazitë ekzistuese, duke penguar studentët e pafavorizuar të marrin pjesë plotësisht në të nxënës online. Në Shqipëri, lidhja e internetit mbetet e paqëndrueshme, veçanërisht në rajonet e largëta, dhe shumë familje nuk mund të përballojnë blerjen e laptopëve ose tabletëve të nevojshëm për të nxënës efektiv online. Përdorimi i telefonave celularë si mjeti kryesor i të nxënës kufizon më tej aftësinë e studentëve për të ndërvepruar me platforma komplekse online (UNDP, 2020; World Bank, 2020).

*Ndërveprim Social i Kufizuar:* Arsimi online, shpesh redukton mundësitë për ndërveprime informale midis bashkëmoshatarëve dhe lidhje sociale. Hrastinski (2008) thekson ndikimin psikologjik të këtij reduktimi, duke përfshirë ndjenja izolimi dhe ulje të ndjenjës së përkatësisë. Për studentët shqiptarë, për të cilët angazhimi social është tradicionalisht i rrënjësuar në jetën e kampusit, kalimi në arsimin online ndërpreu këto lidhje kritike, duke lënë shumë prej tyre të ndihen të shkëputur dhe më pak të motivuar (Mehilli & Kadiu, 2021).

*Mbingarkesa nga Pavarësia në të Nxënës:* Arsimi online i vendos një përgjegjësi të konsiderueshme studentëve për të menaxhuar edukimin e tyre në mënyrë të pavarur, gjë që mund të jetë fuqizuese, por edhe mbingarkuese. Kumar et al. (2019) argumentojnë se vëllimi i materialeve online, i kombinuar me nevojën për vetë-disiplinë, mund të çojë në mbingarkesë njohëse dhe ulje të mbajtjes së njohurive. Studentët shqiptarë, shumë prej të cilëve nuk kishin përvojë të mëparshme me modelet e të nxënës të vetëdrejtuar, raportuan nivele të larta stresi dhe vështirësi për të balancuar studimet me përgjegjësi të tjera gjatë kalimit të shpejtë në arsimin online (UNESCO, 2020; World Bank, 2020).

*Sfida Teknike:* Navigimi në platforma online mund të jetë një detyrë sfiduese për studentët, veçanërisht kur ata hasin probleme teknike si defekte të softuerit, kohë të ngadalta të ngarkimit dhe mungesë të mbështetjes IT. Al-Fraihat et al. (2020) identifikojnë sfidat teknike si një burim kryesor zhgënjimi dhe mosangazhimi në mjediset e të nxënës online. Në Shqipëri, mungesa e sistemeve të standardizuara të menaxhimit të të nxënës midis universiteteve krijoi konfuzion shtesë, pasi studentët shpesh kërkohej të përshtateshin me platforma të shumta me nivele të ndryshme lehtësie në përdorim.

*Mungesa e Mundësive për të Nxënës Praktikisht:* Për disiplina që mbështeten shumë në përvoja praktike, si STEM dhe fushat profesionale, formatet online kanë vështirësi në përsëritjen e punës në laborator, praktikave dhe punës në terren. Jaggars dhe Xu (2016) vënë në dukje se ky hendek mund të çojë në mungesa të konsiderueshme në përvetësimin e aftësive dhe gatishmërinë për tregun e punës. Në Shqipëri, universitetet hasen sfida të konsiderueshme në përshtatjen e komponentëve praktikë të kurrikulës së tyre në formate online, duke lënë studentët në fusha si inxhinieria dhe shëndetësia veçanërisht të disavantazhuar (Komisioni Evropian, 2020).

*Shqetësimet për Vlerësimet Online:* Vlerësimet online kanë ngritur shqetësime rreth drejtësisë, besueshmërisë dhe integritetit akademik. Studentët shpesh i shohin provimet online si më pak

të drejta për shkak të dështimeve teknike, kriterëve të paqarta të vlerësimit dhe sfidave me mbikëqyrjen online (Sangster et al., 2020). Këto çështje ishin të përhapura në Shqipëri, ku universitetet kishin përvojë të kufizuar në zbatimin e metodave të sigurta dhe transparente të vlerësimit online. Si rezultat, shumë studentë shprehën skepticizëm për besueshmërinë e notave të tyre dhe të procesit të përgjithshëm të vlerësimit (Citozi & Shala, 2021; World Bank, 2020).

*Mungesa e Trajnimit dhe Mbështetjes Pedagogjike për Pedagogët:* Shumë pedagogë nuk kanë trajnimin dhe mbështetje pedagogjike, kur përdorin metoda mësimdhënieje online (Baran et al., 2011; Quka, 2021). Për më tepër, pedagogët raportojnë një ngarkesë më të madhe pune, pasi përgatitja dhe mirëmbajtja e kurseve online kërkon ndjeshëm më shumë kohë sesa mësimdhënia tradicionale. Kjo, mund të çojë në lodhje dhe ulje të kënaqësisë në punë (Cutri et al., 2020).

*Sfida për Shëndetin Mendor:* Përdorimi i zgjatur i platformave online është lidhur me rritje të stresit, lodhjes dhe problemeve të shëndetit mendor midis studentëve dhe pedagogëve. Besser et al. (2020) theksojnë fenomenin e "lodhjes nga Zoom-i" (*zoom fatigue*) dhe ndikimin e tij në përqendrim dhe mirëqenie.

*Barrierat Kulturore:* Rezistenca ndaj ndryshimeve është një tjetër çështje e ngritur nga literatura. Disa pedagogë janë rezistentë ndaj adoptimit të metodave të reja mësimore dhe teknologjive (Berge & Muilenburg, 2001). Në Shqipëri, preferenca për arsimin tradicional ballë për ballë vazhdon të jetë e fortë, me skepticizëm ndaj besueshmërisë dhe vlerës së diplomave online (Instituti Shqiptar i Medias, 2020).

*Sigurimi i Cilësisë:* Si studentët ashtu edhe mësuesit shprehin shqetësime për ruajtjen e cilësisë së arsimit në mjediset online (Means et al., 2013).

*Barazia dhe Gjithëpërfshirja:* Grupet e marginalizuara përballen me më shumë barrierë për suksesin në arsimin online. Nëse universiteti nuk është i përgatitur për të siguruar një arsim online të aksesueshëm dhe të përbalueshëm për të gjithë, mësimdhënia online mund të rezultojë në zgjerimin e pabarazive arsimore (Martin et al., 2020).

## **VI. DISKUTIME MBI DISA FAKTORË QË DUHEN MARRË NË KONSIDERATË GJATË HARTIMIT TË POLITIKAVE DHE PRAKTIKAVE PËR PËRMIRËSIMIN E ARSIMIT UNIVERSITAR ONLINE DHE TË KOMBINUAR NË SHQIPËRI**

Së fundmi, qeveria shqiptare ka bërë ndryshime të rëndësishme në rregulloret që lidhen me mësimdhënien online dhe arsimin në distancë, të cilat kanë kufizuar ose madje kanë çregjistruar programet e mësimdhënies online nga të qenit plotësisht të pranueshme brenda universiteteve shqiptare. Arsytet për këtë ndryshim janë të rrënjësura në shqetësime ligjore, institucionale dhe për sigurimin e cilësisë. Më poshtë ofrohet një shpjegim gjithëpërfshirës i arsyes pse mësimdhënia online dhe e kombinuar ka hasur kufizime në Shqipëri.

### **Boshllëqet në Legjislacion dhe Standardet e Akreditimit**

Një nga arsyet kryesore që mësimdhënia online nuk është plotësisht e pranueshme brenda universiteteve shqiptare është legjislacioni i paplotë ose kufizues. Ligji për Arsimin e Lartë (Ligji Nr. 80/2015), ndonëse lejon inovacionin dhe fleksibilitetin në mësimdhënie, nuk ka dispozita specifike dhe të detajuara për programet plotësisht online.

Çështje Kryesore Ligjore: (i) *Mungesa e Një Përkufizimi të Qartë për Diplomat Online*: Ligji nuk përcakton qartë sesi diplomat plotësisht online përshtaten në kuadrin e arsimit të lartë shqiptar. Kjo krijon një boshllëk rregullator, duke e bërë sfiduese për universitetet të legjitimojnë programe të tilla. (ii) *Sfida në Akreditim*: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ka standarde strikte akreditimi që favorizojnë modelet tradicionale, ballë për ballë. Shumë programe online nuk arrijnë të përmbushin këto kritere, veçanërisht në fusha si integriteti i vlerësimit dhe ndërveprimi midis mësuesve dhe studentëve. (iii) *Shqetësime për Njohjen Ndërkombëtare*: Qeveria shqiptare është e kujdesshme në lidhje me adoptimin e diplomave plotësisht online për shkak të shqetësimeve mbi njohjen e tyre në Evropë dhe më gjerë. Shumë vende evropiane ende favorizojnë modelet ballë për ballë ose të kombinuara mbi ato plotësisht online.

### **Shqetësimet për Sigurimin e Cilësisë**

Qeveria dhe ASCAL kanë ngritur shqetësime mbi ruajtjen e cilësisë së arsimit në programet online. Këto shqetësime lidhen me sigurimin që studentët marrin të njëjtin nivel të mësimdhënies, angazhimit dhe rigorozitetit akademik si në programet tradicionale në kampus.

Çështje Specifike të Cilësisë: (i) *Ndërveprimi dhe Angazhimi i Studentëve*: Programet plotësisht online shpesh kritikohen për mungesën e mundësive të mjaftueshme për ndërveprim midis studentëve dhe profesorëve, si dhe midis bashkëmoshatarëve, gjë që mund të ndikojë në përvojën e përgjithshme të të nxënësve. (ii) *Integriteti i Vlerësimeve dhe Provimeve*: Programet online përballen me sfida në sigurimin që provimet dhe vlerësimet kryhen në mënyrë të drejtë dhe të sigurt. Mjetet si mbikëqyrja online nuk përdoren gjithmonë, duke ngritur shqetësime për pandershmëri akademike. (iii) *Gatishmëria e Fakulteteve*: Shumë universitete në Shqipëri janë ende në procesin e trajnimit të pedagogëve për të mësuar në mënyrë efektive në mjedise online. Mungesa e aftësive të mësimdhënies digjitale ka kontribuar në dyshimet mbi cilësinë e arsimit online.

### **Përvoja gjatë Pandemisë dhe Kthimi tek Modelet Tradicionale**

Mësime nga Pandemia: (i) *Pabarazi në Akses*: Shumë studentë, veçanërisht në zonat rurale, nuk kishin akses në internet të besueshëm dhe pajisje, duke krijuar pabarazi në arsim. Kjo ngriti shqetësime rreth barazisë dhe aksesueshmërisë në arsimin online. (ii) *Rënie në Rezultatet e Nxënësve*: Reagimet nga studentët dhe mësuesit treguan se mësimdhënia plotësisht online shpesh çoi në angazhim më të ulët dhe rezultate më të dobëta në mësimdhënie, krahasuar me arsimin ballë për ballë. (iii) *Preferencat e Studentëve*: Anketat e zhvilluara pas pandemisë sugjeruan se shumë studentë preferonin modelet tradicionale ose hibride ndaj arsimit plotësisht online, veçanërisht për lëndët që kërkojnë mësim praktik ose të bazuar në përvojë.

Në përgjigje të këtyre çështjeve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë theksoi kthimin tek mësimdhënia ballë për ballë si modaliteti kryesor për universitetet, duke kufizuar rolin e arsimit online vetëm në modele plotësuese ose hibride.

### **Mungesa e Infrastrukturës dhe Gatishmëria Teknologjike**

Pavarësisht përparimit në digjitalizim, Shqipëria ende përballlet me sfida për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur arsimin plotësisht online: (i) *Hendeku Digjital*: Shumë rajone në Shqipëri ende vuajnë nga lidhja e dobët e internetit, duke e bërë të vështirë për studentët pjesëmarrjen në programe online. (ii) *Investime të Kufizuara në Teknologjinë Edukative*: Universitetet shpesh nuk kanë burime financiare për të investuar në teknologji arsimore të avancuar, si Sistemet e Menaxhimit të Nxënësve (LMS), mjetet e mbikëqyrjes dhe laboratorët virtualë, të cilat janë thelbësore për arsimin online me cilësi të lartë.

Hezitimi i qeverisë për të mbështetur fuqishëm mësimdhënien online buron nga njohja se infrastruktura e nevojshme ende nuk është vendosur plotësisht për të garantuar suksesin e saj në mbarë vendin

### **Mospërputhje me Standardet Evropiane të Arsimit të Lartë**

Shqipëria ka përshtatur sistemin e saj të arsimit të lartë me Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë përmes Procesit të Bolonjës. Megjithatë, shumë vende evropiane ende favorizojnë mësimdhënien e kombinuar (një përzierje midis mësimdhënies online dhe ballë për ballë) ndaj programeve plotësisht online, veçanërisht për diplomat universitare dhe profesionale. Diplomat e fituara plotësisht online mund të mos njihen ose të mos vlerësohen në mënyrë të barabartë në të gjitha vendet evropiane, veçanërisht për profesionet e rregulluara (p.sh., mjekësi, drejtësi, inxhinieri). Kjo ka çuar Shqipërinë të përqendrohet më shumë në arsimin ballë për ballë për të siguruar që diplomat e saj të mbeten konkurruese dhe të njohura ndërkombëtarisht.

## **VII. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E ARSIMIT ONLINE DHE TË KOMBINUAR NË SHQIPËRI**

Për të përfituar nga përparësitë e arsimit online dhe për të adresuar sfidat ekzistuese, Shqipëria ka nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse dhe me vizion për hartimin e politikave dhe reformimin institucional. Rekomandimet e mëposhtme synojnë të përmirësojnë qeverisjen në nivel kombëtar, duke fuqizuar universitetet për të avancuar infrastrukturën, kapacitetet, metodologjitë dhe mbulimin, si për studentët ashtu edhe për stafin mësimdhënës.

Për të përfituar në mënyrë të qëndrueshme nga potenciali i arsimit online dhe të kombinuar, Shqipëria ka nevojë për një qasje të integruar që kombinon reforma ligjore, investime teknologjike dhe ndërhyrje të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë dhe barazisë. Në nivel qeverisës, është e domosdoshme ndërtimi i një kornize ligjore gjithëpërfshirëse që njeh dhe rregullon arsimin online, përfshirë edhe transferimin dhe njohjen e krediteve. Po ashtu, nevojiten investime të qëndrueshme në infrastrukturën digjitale, politika aktive për të garantuar barazi dhe akses, rritje e kapaciteteve institucionale, mekanizma të fortë për sigurimin e cilësisë dhe mbikëqyrjen, si dhe nisma për ndërgjegjësim publik që e vendosin arsimin online në një kornizë të pranueshme kulturore. Këto hapa duhet të shoqërohen me përputhje të qartë me politikat evropiane për arsimin e lartë.

Në nivel institucional, universitetet duhet të përqendrohen në forcimin e infrastrukturës digjitale, zhvillimin profesional të stafit akademik përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe përmirësimin e mekanizmave të mbështetjes për studentët. Inovacioni në metodologjitë e mësimdhënies dhe zgjerimi i ofertës së programeve fleksibël dhe hibride janë gjithashtu thelbësore për të përmbushur kërkesat e një popullate studentore të larmishme. Politikat për gjithëpërfshirje duhet të jenë të qarta dhe të targetuara ndaj grupeve në rrezik të përjashtimit, ndërkohë që universitetet duhet të promovojnë të nxënit gjatë gjithë jetës si një komponent integral të misionit të tyre arsimor.

## **REFERENCA**

- ASCAL, 2021. *Accreditation Standards for Distance Education*. Albanian Quality Assurance Agency in Higher Education.
- Al-Fraihat, D., Joy, M., Masa'deh, R. & Sinclair, J., 2020. Evaluating e-learning systems success: An empirical study. *Computers in Human Behavior*, 102, pp.67–86.
- Allen, I.E. & Seaman, J., 2017. *Digital Learning Compass: Distance Education Enrollment Report 2017*. Babson Survey Research Group.
- Baran, E., Correia, A.P. & Thompson, A., 2011. Transforming online teaching practice: Critical analysis of the literature on the roles and competencies of online teachers. *Distance Education*, 32(3), pp.421–439.
- Bennett, S., Daëson, P. & Bearman, M., 2020. *Learning Design: Engaging Students in Learning through Constructive Alignment*. Routledge.
- Berge, Z.L. & Muilenburg, L.Y., 2001. Obstacles faced at various stages of capability regarding distance education in institutions of higher education: Survey results. *TechTrends*, 45(4), pp.40–45.
- Besser, A., Flett, G.L. & Zeigler-Hill, V., 2020. Adaptability to a sudden transition to online learning during the COVID-19 pandemic. *International Journal of Educational Research*, 98, p.101012.
- Bowen, W.G., Chingos, M.M., Lack, K.A. & Nygren, T.I., 2014. Interactive learning online at public universities: Evidence from a six-campus randomized trial. *Journal of Policy Analysis and Management*, 33(1), pp.94–111.
- Carter, R.A., Rice, M., Yang, S. & Jackson, H.A., 2020. Self-regulated learning in online learning environments: Strategies for supporting student success. *Educational Technology Research and Development*, 68, pp.1–15.
- Crawford et al., 2020. COVID-19: 20 countries' higher education intra-period digital pedagogy responses. *Journal of Applied Learning & Teaching* 3 (1), DOI:10.37074/jalt.2020.3.1.7
- Çitozi, R., & Shala, B. (2021). Online education in Albania: Assessment and evaluation challenges. *Journal of Educational Innovation and Research*, 5(1), 13–29.
- Council of the European Union, 2021. *Council Recommendations on Blended Learning in Education and Training*. Official Journal of the European Union.
- Cutri et al., 2020. Faculty readiness for online crisis teaching: transitioning to online teaching during the COVID-19 pandemic. *European Journal of Teacher Education* 43(4):523-541. DOI:10.1080/02619768.2020.1815702
- Dhawan, S. (2020). Online learning: A panacea in the time of COVID-19 crisis. *Journal of Educational Technology Systems*, 49(1), 5–22. <https://doi.org/10.1177/0047239520934018>
- European Commission, 2021. *Digital Education Action Plan (2021–2027)*. Available at: <https://education.ec.europa.eu>.
- European Commission, 2021. *European Skills Agenda*. Available at: <https://ec.europa.eu/skills>.
- European MOOCs Consortium, 2013. *MOOCs and Open Education: Implications for Higher Education*.
- European Commission. (2020). *Education and training during COVID-19 in the Western Balkans: Continuity and challenges*. European Commission. <https://ec.europa.eu>
- Garrison, D.R. & Vaughan, N.D., 2008. *Blended Learning in Higher Education: Framework, Principles, and Guidelines*. Jossey-Bass.
- Graham, C.R., 2006. Blended learning systems: Definition, current trends, and future directions. In C.J. Bonk & C.R. Graham (Eds.), *The Handbook of Blended Learning*. Pfeiffer.
- Harasim, L., 2000. Shift happens: Online education as a new paradigm in learning. *The Internet and Higher Education*, 3(1–2), pp.41–61.

- Hrastinski, S., 2008. Asynchronous and synchronous e-learning: A study of asynchronous and synchronous communication in online learning. *The Internet and Higher Education*, 11(3–4), pp.115–125.
  - Hodges, C., Moore, S., Lockee, B., Trust, T., & Bond, A. (2020). The difference between emergency remote teaching and online learning. *Educause Review*. <https://er.educause.edu/articles/2020/3/the-difference-between-emergency-remote-teaching-and-online-learning>
  - Hoxha, L., & Toska, A. 2021. Digital transformation in higher education: Challenges and opportunities for Albanian universities. *European Journal of Education Studies*, 8(8), 112–126. <https://doi.org/10.5281/zenodo.5041234>
- Instituti Shqiptar i Medias, 2020. Edukimi online në erën e Covid -19; diferencimi dixhital dhe sfidat e mësimit në distance. Tirane, Shqipëri.
- Qafzezi, E. 2023 Online Collaborative Learning in Higher Education in Albania: Some Necessary Innovations. *International Journal of Management, Knowledge and Learning* | ISSN 2232-5697.
  - Quka, N., 2021. Students' Impressions of Online Learning in Albania. *European Journal of Social Science Education and Research* May -August 2021 Volume 8, Issue 2.
  - Jaggars, S.S. & Xu, D., 2016. How do online course design features influence student performance? *Computers & Education*, 95, pp.270–284.
  - King, D., Geng, F. & Huan, Y., 2009. The challenges of assessing online learning. *Assessment & Evaluation in Higher Education*, 34(1), pp.5–14.
  - Kintu, M.J., Zhu, C. & Kagambe, E., 2017. Blended learning effectiveness: The relationship between student characteristics, design features and outcomes. *International Journal of Educational Technology in Higher Education*, 14(1), pp.1–20.
  - Kumar, P., Kumar, A., Palvia, S. & Verma, S., 2019. Online business education research: Systematic analysis and a conceptual model. *The International Journal of Management Education*, 17(1), pp.26–35.
  - Means, B., Toyama, Y., Murphy, R., Bakia, M. & Jones, K., 2013. *Evaluation of Evidence-Based Practices in Online Learning: A Meta-Analysis and Review of Online Learning Studies*. Washington, D.C.: U.S. Department of Education.
  - Mëhilli, B., & Kadiu, E. (2021). Social isolation and online education in Albanian universities during COVID-19. *Albanian Journal of Educational Studies*, 3(2), 25–42.
  - Ministry of Education, Sports, and Youth, Albania, 2021. *National Education Strategy 2021–2026*.
Shqipëria nuk bën përjashtim nga ky trend. Sipas Institutit të Statistikave (INSTAT, 2023), numri i qytetarëve të moshës 65 vjeç e lart përbën rreth 21% të popullsisë, ndërsa parashikimet për vitin 2050 e çojnë këtë përqindje në mbi 26%. Rritja e jetëgjatësisë, rënia e fertilitetit dhe emigracioni i lartë, sidomos i të rinjve, kanë ndikuar ndjeshëm në strukturën demografike, duke shtuar numrin e të moshuarve që jetojnë vetëm ose në kushte të vështira ekonomike. Paralelisht, raporti i varësisë për të moshuarit është rritur ndjeshëm, duke kaluar për herë të parë raportin e varësisë për të rinjtë (INSTAT, 2023).

Ndryshimet strukturore të familjes kanë luajtur gjithashtu një rol kyç. Familja tradicionale me shumë breza është në rënie, ndërsa modeli i bashkëjetesës ndërbreznore po zëvendësohet gjithnjë e më tepër nga forma të reja të jetesës individuale, veçanërisht në zonat urbane. Në mungesë të një sistemi të konsoliduar dhe të integruar të kujdesit shoqëror dhe shëndetësor për të moshuarit, Shqipëria përballlet me vështirësi në garantimin e mbështetjes së qëndrueshme për këtë grup moshë (HelpAge International, 2015; EHO, 2022).

Përballë këtij realiteti, zhvillimi i shërbimeve të kujdesit në banesë dhe hartimi i politikave të bazuara në evidencë për trajtimin e nevojave të të moshuarve është bërë i domosdoshëm. Reforma e shërbimeve sociale në Shqipëri gjatë dekadës së fundit ka synuar ndërtimin e një sistemi më gjithëpërfshirës, të decentralizuar dhe të orientuar drejt komunitetit (UNDP, 2021). Megjithatë, mbështetja institucionale për të moshuarit mbetet e fragmentuar dhe e kufizuar, sidomos në raport me nevojat komplekse që shfaqen në mjedisin e tyre familjar e social (INSTAT, 2023; MSHP, 2019).

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim synon të realizojë një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave për shërbime në banesë për të moshuarit në Bashkinë Tiranë, në funksion të përmirësimit të përgjigjes institucionale dhe hartimit të politikave të bazuara në evidencë. Qasja metodologjike ka përfshirë perceptimet dhe përvojat e vetë të moshuarve, të afërmeve kujdestarë si dhe profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale dhe shëndetësore për këtë grup.

### **Objektivat e studimit janë:**

- Të analizojë kuadrin politik dhe ligjor që rregullon mbrojtjen dhe kujdesin për të moshuarit në nivel qendror dhe vendor.
- Të identifikojë praktika dhe modele ndërkombëtare të shërbimit në banesë për të moshuarit, të përshtatshme për kontekstin shqiptar.
- Të vlerësojë tipologjinë dhe shtrirjen e shërbimeve ekzistuese në Bashkinë Tiranë dhe në çfarë mase ato përmbushin nevojat e moshës së tretë.
- Të eksplorojë perceptimet, qëndrimet dhe pritshmëritë e të moshuarve dhe të afërmeve të tyre lidhur me shërbimin në banesë.
- Të shqyrtojë kompetencat profesionale, njohuritë dhe kapacitetet e aktorëve që ofrojnë shërbime për të moshuarit në nivel vendor.
- Të hartojë rekomandime të bazuara në evidencë për përmirësimin e politikave, strukturave dhe praktikave ekzistuese të kujdesit në banesë.

Ky studim kontribuon në njohjen më të thelluar të nevojave reale të të moshuarve që jetojnë në komunitet dhe sfidave të aktorëve që ofrojnë kujdesin për ta. Rezultatet mund të shërbejnë si bazë për hartimin e strategjive të ndërhyrjes më të qëndrueshme dhe më të integruara, duke nxitur një qasje të koordinuar ndërmjet institucioneve publike, sektorit jofitimprurës dhe komunitetit. Për më tepër, ai synon të mbështesë politikë bërësit vendorë në përfshirjen e dimensionit të plakjes aktive dhe dinjitoze në politikat e zhvillimit social. Studimi paraqet gjithashtu vlera orientuese për studiuesit dhe profesionistët e fushës, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të praktikës dhe kërkimit shkencor në fushën e kujdesit ndaj të moshuarve.

### **Rishikimi i literaturës**

#### *Moshimi, konteksti global dhe lokal*

Moshimi i popullsisë përbën një nga tendencat më domethënëse demografike të shekullit XXI, me ndikime të thella në sistemet ekonomike, sociale dhe shëndetësore në mbarë botën. Ky fenomen është i pranishëm në pothuajse çdo vend dhe rajon, dhe pasqyron ndryshime strukturore të qëndrueshme në përbërjen e popullsisë (United Nations, 2015; Athenosy & Revenco, 2014; Bloom, Canning & Fink, 2012). Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, popullsia e moshës 65 vjeç e lart po rritet me ritme më të shpejta sesa çdo grup moshë tjetër (UN DESA, 2017). Në Bashkimin Evropian, më shumë se një e pesta e popullsisë tashmë është mbi 65 vjeç, dhe projektohet që kjo përqindje të vijojë të rritet ndjeshëm në dekadat në vijim (EUROSTAT, 2021a; 2021b). Konkretisht, numri i të moshuarve pritet të arrijë nga 90.5 milion në vitin 2019 në rreth 129.8 milion në vitin 2050, me një rritje të theksuar të grup moshat mbi 75 vjeç.

Edhe Shqipëria nuk përjashtohet nga ky zhvillim. Siç evidentojnë të dhënat e INSTAT (2015), vendi po përballlet me një rritje graduale të përqindjes së popullsisë së moshuar, për shkak të një kombinimi faktorësh si rënia e lindshmërisë, rritja e jetëgjatësisë dhe emigracioni i të rinjve. Projekti i INSTAT mbi projeksionet e popullsisë për periudhën 2019–2031 parashikon që mosha mediane do të rritet në 42.1 vjeç deri në vitin 2031 (INSTAT, 2019), duke sinjalizuar një plakje të mëtejshme të shoqërisë shqiptare dhe një rritje të presionit mbi sistemin e shërbimeve për të moshuarit.

Në nivel vendor, njësia administrative nr. 5 rezulton me numrin më të madh të të moshuarve në

Bashkinë e Tiranës, ndërkohë që njësia e Kërrabës ka numrin më të ulët. Këto të dhëna tregojnë për nevojën e domosdoshme për një hartëzim të saktë të të moshuarve që jetojnë vetëm dhe që janë në nevojë për shërbime në banesë. Njësitë e vlerësimit dhe koordinimit të nevojave pranë njësive administrative, të cilat ende nuk janë funksionalizuar plotësisht, pritet të luajnë një rol kyç në këtë drejtim.

### **Kuadri politik, ligjor mbi moshën e tretë në Shqipëri dhe institucionet përgjegjëse**

Politikat sociale për të moshuarit në Shqipëri mbështeten në dy shtylla themelore: përfitimet me karakter kontribuues dhe ato me karakter jo-kontribuues. Shtylla e parë përfshin pensionet dhe përfitimet e lidhura me kujdesin shëndetësor, ndërsa e dyta mbështetet te shërbimet e kujdesit shoqëror dhe institucionet që ofrojnë mbështetje për të moshuarit në nevojë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSMS) është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave në këtë fushë, ndërkohë që Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Shëndetit Publik dhe Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor janë përgjegjës për zbatimin e tyre (MSMS, 2019). Përfitimet financiare dhe ato të kujdesit shëndetësor rregullohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe ai i Kujdesit Shëndetësor. Megjithatë, analiza e kuadrit ligjor dhe institucional ka evidentuar mungesa të theksuara, veçanërisht në ofrimin e mbrojtjes së posaçme për të moshuarit. Pavarësisht përfshirjes së Shqipërisë në instrumente ndërkombëtare si Karta Sociale Evropiane, neni 23 i kësaj karte – që garanton të drejtën për mbrojtje sociale të të moshuarve – nuk është ratifikuar ende nga shteti shqiptar (Podgorica et al., 2020). Kjo tregon për një boshllëk midis angazhimeve ndërkombëtare dhe zbatueshmërisë së tyre në nivel kombëtar. Nevoja për forcimin e kuadrit ligjor dhe përmirësimin e mekanizmave institucionalë për përkujdesjen ndaj të moshuarve mbetet ende e mprehtë.

### **Problematikat dhe nevojat e grup moshës së tretë**

Të moshuarit përfaqësojnë një ndër grupet më të rrezikuara për përjashtim social dhe shpeshherë mbeten jashtë fokusit të politikave publike për ofrimin e shërbimeve. Studimet tregojnë se kjo kategori përballet me një gamë të gjerë problematikash që ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetës së tyre, duke kërkuar ndërhyrje të strukturuar në nivel politikash dhe shërbimesh (MOSHA, 2017; MSMS, 2019). Sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin, pritet një rritje e ndjeshme e raportit të varësisë të të moshuarit, duke arritur një dyfishim deri në vitin 2030 (MSMS, 2019). Po ashtu, të dhënat e MOSHA (2017) tregojnë se rreth 37% e të moshuarve e perceptojnë veten si “të varfër”, përqindje që rritet ndjeshëm në grup moshat më të avancuara.

Ndër sfidat më të mëdha që përjetojnë të moshuarit është varësia që lind si pasojë e sëmundjeve kronike, aftësisë së kufizuar apo problematikave të shëndetit mendor, të cilat e bëjnë të pamundur kryerjen e aktiviteteve të përditshme pa ndihmë dhe përkujdesje. Sipas OKB-së (2016), rritja e jetëgjatësisë shoqërohet me një rritje të rrezikut për sëmundje kronike, si dhe për çrregullime kognitive, përfshirë demencën dhe Alzheimer-in. Varësia funksionale të të moshuarit lidhet ngushtë me pamundësinë për të kryer në mënyrë të pavarur aktivitetet bazë të jetës së përditshme, si veshja, larja, ushqyerja, ecja, higjiena personale apo menaxhimi i shtëpisë. Këto kufizime ndikojnë negativisht në mirëqenien fizike dhe emocionale, duke sjellë pasojë si izolimi social, depresioni dhe humbja e dinjitetit (Oliveira & Pedreira, 2012).

Në vendet me nivel të ulët dhe të mesëm zhvillimi, ku mungesa e shërbimeve formale të përkujdesjes është e theksuar, barrën më të madhe të kujdesit e mbajnë familjarët dhe kujdestarët informalë. Kjo

gjeneron ndikime të drejtpërdrejta në dinamikën e familjes dhe përbën një sfidë shtesë në aspektin ekonomik, emocional dhe social.

Në këtë kuadër, moshimi i popullsisë duhet të konsiderohet një prioritet strategjik, që kërkon vëmendje të posaçme nga politika publike dhe sistemet e mbrojtjes sociale. Sipas UN (2015), plakja ndikon pothuajse në të gjitha sektorët e shoqërisë dhe kërkon zhvillimin e shërbimeve të përshtatura në banesë, sigurimin e mirëqenies materiale dhe garantimin e mbrojtjes sociale.

Në Shqipëri, sipas një studimi të Shoqatës Shqiptare të Gjeriatriisë dhe Gerontologjisë dhe të dhënave të INSTAT (2015), një përqindje e konsiderueshme e të moshuarve me aftësi të kufizuara dhe varësi nga të tjerët raportojnë vështirësi serioze për t'u përkujdesur për veten. Po ashtu, një përqindje e lartë e të moshuarve e perceptojnë gjendjen e tyre shëndetësore si të dobët.

Raporti Shëndetësor Kombëtar i Institutit të Shëndetit Publik (2014) thekson se përhapja e sëmundjeve kronike përbën një ndër sfidat më të mëdha të shëndetit publik në vend. Ky shqetësim është reflektuar edhe në Raportin Kombëtar mbi zbatimin e Strategjisë Rajonale të Planit Ndërkombëtar të Madridit për Moshimin, për periudhën 2012–2016. Indeksi i Vulnerabilitetit i përpiluar nga INSTAT (2015), i cili mat faktorë si të jetuarit vetëm, prania e aftësisë së kufizuar, burimi i të ardhurave dhe lloji i përkujdesjes, shënon një mesatare prej 1.14 në nivel kombëtar, me 35 bashki që e kalojnë këtë mesatare.

Ndërkohë, problematikat e shëndetit mendor, veçanërisht rritja e prevalencës së demencës dhe Alzheimer-it, po marrin një vëmendje gjithnjë e më të madhe. Sipas ISHP (2015), demenca përbën një shqetësim të rëndësishëm për shëndetin publik në Evropë dhe në Shqipëri, me ndikim të drejtpërdrejtë edhe tek kujdestarët familjarë. Indeksi Global i Mbikëqyrjes së Moshës (HelpAge, 2015) e vlerëson Shqipërinë me rezultate të ulëta në domenin e shëndetit dhe rekomandon përmirësimin e informimit të të moshuarve për problematikat e shëndetit mendor, si dhe orientimin e fushatave ndërgjegjëse drejt këtyre çështjeve.

## **PËRKUJDESI SOCIAL PËR TË MOSHUARIT**

Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit përbëjnë një komponent kyç të sistemit të mbrojtjes sociale, duke ofruar mbështetje për një kategori gjithnjë e më të rrezikuar të popullsisë. Në Shqipëri, zhvillimi i këtyre shërbimeve është ndjekur nga përpjekje të vazhdueshme reformuese që synojnë krijimin e një modeli më gjithëpërfshirës, efektiv dhe të qëndrueshëm.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2023–2030 (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale [MSHMS], 2023) thekson rëndësinë e zgjerimit të shërbimeve sociale për grupet vulnerabil, përfshirë të moshuarit, si dhe përmirësimin e aksesit në shërbime përmes fuqizimit të pushtetit vendor dhe partneritetit ndër sektorial. Strategjia mbështet zhvillimin e shërbimeve të përkujdesjes në komunitet dhe në familje, duke ndjekur parimet e de institucionalizimit dhe decentralizimit.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përkufizon shërbimin në familje si mbështetje për individët që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten dhe që nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestarët. Ky shërbim përfshin ofrimin e vakteve në shtëpi, furnizimin me barna, ndihmën për ruajtjen e higjienës personale, përmbushjen e nevojave të përditshme dhe mbështetjen psiko-sociale (Kuvendi i Shqipërisë, 2016).

Gjithashtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018, e përcakton shërbimin në familje si formë të shërbimit të kujdesit shoqëror për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara që nuk kanë mundësi të përfitojnë nga shërbimet ditore komunitare apo rezidenciale, dhe që nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo ndihmësi personal (Qeveria e Shqipërisë, 2018). Megjithatë, pavarësisht bazës ligjore dhe normative të ngritur, ky model vazhdon të jetë në fazë pilotimi në shumicën e

bashkive.

Në Bashkinë Tiranë aktualisht operojnë shtatë qendra rezidenciale për të moshuarit, prej të cilave vetëm njëra është publike, dhe gjashtë qendra komunitare që ofrojnë vakte ushqimore dhe aktivitete socializuese. Pas vitit 2020, është shënuar një zgjerim i shërbimeve në familje, veçanërisht si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, me theks të veçantë në shpërndarjen e vakteve për të moshuarit e vetmuar.

Pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve është e përqendruar në zonat urbane, ndërsa njësitë administrative rurale përballen me mungesë kapacitetesh dhe infrastrukture. Njësitë e vlerësimit dhe koordinimit të nevojave sociale pranë çdo njësie administrative, të parashikuara me ligj, nuk janë ende të operacionalizuara në të gjithë territorin. Kjo e bën të vështirë identifikimin dhe referimin e rasteve të të moshuarve në nevojë, veçanërisht për ata që jetojnë vetëm apo përballen me varësi funksionale. Në përmbledhje, përkujdesi social për të moshuarit në Shqipëri mbetet një fushë në zhvillim, që kërkon ndërhyrje të mëtejshme për forcimin e kuadrit institucional, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe garantimin e aksesit të barabartë në shërbime për të gjithë të moshuarit, në përputhje me standardet e kujdesit dinjitoz dhe gjithëpërfshirës.

## METODOLOGJIA

Studimi u konceptua dhe u zbatua në qasjen kërkimore cilësore, e cila synon të eksplorojë në thellësi përvojat dhe nevojat e të moshuarve në raport me shërbimet në banesë në Bashkinë Tiranë. Kjo qasje u konsiderua më e përshtatshme për të arritur qëllimin e studimit, duke mundësuar kuptimin e dimensioneve subjektive dhe kontekstuale të problematikës. Krahës rishikimit të literaturës dhe analizës së të dhënave dytësore, studimi u mbështet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave parësore përmes zhvillimit të fokus-grupeve.

### *Metoda e mbledhjes së të dhënave*

Të dhënat u mblodhën përmes fokus grupeve të realizuara tre kategori pjesëmarrësish: të moshuar, të afërm kujdestarë dhe profesionistë të shërbimeve sociale. Kjo metodë mundëson ndërveprim dhe shkëmbim të lirë të përvojave dhe perceptimeve brenda grupit dhe ndihmon në gjenerimin e njohurive të thelluara për çështjet e trajtuara (Morgan, 1997; Morgan & Krueger, 1998). Fokus-grupet janë veçanërisht të përshtatshme për të eksploruar fenomene që nuk janë kuptuar plotësisht, për të evidentuar nevoja të nënkuptuara ose të pa adresuara dhe për të sugjeruar mënyra të reja ndërhyrjeje

### *Përzgjedhja e pjesëmarrësve*

Përzgjedhja e pjesëmarrësve në studim u bë përmes një kampioni të qëllimshëm, me synimin për të përfshirë individë që kishin njohuri dhe përvojë të drejtpërdrejtë në lidhje me temën e trajtuar. Kampioni u përbë nga tre grupe të veçanta pjesëmarrësish:

- *Të moshuarit*, në këtë kategori u përfshinë gjithsej 18 pjesëmarrës (12 gra dhe 6 burra), të moshës 65 vjeç e lart, banues në territorin e Bashkisë Tiranë dhe frekuentues të qendrave komunitare. Dy fokus-grupet përkatëse u zhvilluan në Qendrën Komunitare “Qëndrojmë së Bashku” dhe në Qendrën Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”.
- *Profesionistët*, në këtë fokus-grup morën pjesë 8 persona (7 gra dhe 1 burrë), të cilët përfaqësonin shërbimet sociale publike dhe komunitare për të moshuarit në Bashkinë Tiranë. Të gjithë

pjesëmarrësit kishin ekspertizë në fushën e mbrojtjes sociale dhe ishin të përfshirë drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve për këtë grup moshë.

- *Të afërmit/kujdestarët*, ky grup përfshiu 4 pjesëmarrës (3 gra dhe 1 burrë), të cilët kishin rol aktiv në përkujdesjen e përditshme ndaj të moshuarve në mjedisin familjar.

### ***Zhvillimi i fokus-grupeve***

Fokus-grupet u hartuan dhe u moderuan mbi bazën e një udhëzuesi gjysmë të strukturuar, të ndërtuar në përputhje me objektivat kërkimore. Secili grup zgjati mesatarisht 60–90 minuta dhe u zhvillua në ambientet e qendrave komunitare me leje të mëparshme institucionale. Diskutimet u regjistruan me pëlqimin e pjesëmarrësve dhe më pas u transkribuan fjalë për fjalë për qëllime analize.

### ***Analiza e të dhënave***

Të dhënat u analizuan përmes analizës tematike të udhëhequr nga modeli i Braun dhe Clarke (2006). Procesi përfshiu pesë faza: (1) njohja me të dhënat përmes leximit të përsëritur; (2) kodimi fillestar i njësive kuptimore; (3) grupimi i kodeve në tema të përbashkëta; (4) rishikimi dhe rafinimi i temave; dhe (5) emërtimi dhe përshkrimi i temave përfundimtare. Analiza u krye në mënyrë sistematike për të siguruar përputhjen ndërmjet të dhënave empirike dhe qëllimeve të studimit.

### ***Konsideratat etike***

Studimi respektoi parimet bazë etike të kërkimit shkencor, përfshirë:

- *Pëlqimin e informuar*, të gjithë pjesëmarrësit u informuan verbalisht dhe me shkrim për qëllimin dhe natyrën e studimit dhe nënshkruan formularin përkatës.
- *Konfidencialitetin*, të dhënat personale dhe identifikueset e pjesëmarrësve nuk u regjistruan dhe u trajtuan me anonimitet të plotë.
- *Pjesëmarrjen vullnetare*, pjesëmarrësit kishin të drejtë të tërhiqeshin nga studimi në çdo moment pa pasoja.

### ***Kufizimet metodologjike***

Ndër kufizimet kryesore të studimit përfshihen:

- Përfaqësimi relativisht i kufizuar gjeografik i pjesëmarrësve, i cili mund të kufizojë përgjithësimin e gjetjeve për kontekste të tjera jashtë Tiranës.
- Përdorimi i vetëm i fokus-grupeve si burim të dhënash parësore mund të mos përfshijë perspektiva individuale të thelluara që mund të dalin nga intervistat individuale.

## **Rezultatet e studimit**

### **NEVOJAT E TË MOSHUARVE**

Katër tema kryesore u identifikuan si më të rëndësishmet nga pjesëmarrësit në këtë studim. Këto tema dhe nën tema u morën nga diskutimet për të gjitha grupet e fokusit të kombinuara brenda fushës në të cilën ata u mbështetën nga të dhënat cilësore. Temat dhe nën temat janë paraqitur në seksionet vijuese.

### **NEVOJAT FIZIKE**

Gjatë temës "të kesh shëndet të mirë fizik", pjesëmarrësit/et e kanë konsideruar ruajtjen e shëndetit fizik

si një komponent të rëndësishëm të plakjes mirë. Qasja ndaj kujdesit shëndetësor në aspektin e aksesit u vlerësua si shumë e rëndësishme nga të tri grupet, të moshuarit, profesionistët dhe të afërmit që kujdesen për të moshuarit.

### **Qëndrimi aktiv**

Kujdesi për veten është perceptuar si shumë e rëndësishme nga pjesëmarrësit në studim. Ata theksojnë faktin se është shumë e rëndësishme të lëvizurit, të bërit të aktiviteteve fizike, të lexuarit e të ndarit të mendimeve/emocioneve me të tjerët.

*“Të lëvizurit të mban gjallë. Atë ditë kur të mos mundem të lëviz, dije se kam vdekur”*

*“Shyqyr që e hapim gojën kur vimë këtu. Më mban gjallë fakti që do kem se çfarë të flas me shoqet/shokët e qendrës”*

Megjithatë, profesionistët, të afërmit dhe të moshuarit vetë theksuan se ju mungon aspekti ekonomike për ti plotësuar këto nevoja. Shpesh herë ata duan të bëjnë diçka, siç është p.sh ardhja në qendër, por nuk mundën të paguajnë autobusin.

*“Gjithçka blihet me leka. E ne leka nuk kemi”*

### **Mos pasja e sëmundjeve**

Të gjitha pjesëmarrësit/et përshkruan shëndetin fizik si të rëndësishëm, ata tentuan ta diskutojnë atë në lidhje me statusin e tyre aktual shëndetësor siç është qenia pa sëmundje dhe kontrollat shëndetësore periodike. Situata e pandemisë së Covid-19, e ka rënduar akoma shumë situatën e tyre fizike dhe atë psikologjike.

*“Shëndeti jo i mirë , shumë të stresuar dhe të frikësuar prej Covid .Kemi qenë në ankth gjithë kohës duke u ruajtur për mos të na zënë Covid . Kemi mbajtur maskë dhe gjithë kohës jemi kujdesur që mos të infektohemi”*

*“Shumë probleme me mëlcinë, diabetin, zorrët. Gjatë kësaj kohe kemi pasur frikë të shkojmë tek doktori për arsye të Covid “*

*“Vazhdojmë me të njëjtat avaze tonat , ilaçe si gjithmonë, aman ne copa copa jemi ..”*

Ata identifikojnë si shumë problematike marrëdhëniet me mjekët e familjes. Sipas tyre, nuk trajtohen me dinjitet dhe shpesh herë përcillen pa u vizituar.

*“Nuk jam e kënaqur për shërbimin. Kam marrë mjekime pa rimbursim për të cilat duhet të paguaj , ka shumë radhë për të marrë shërbim dhe ndihemi të lodhur. Nuk kemi moshë ne të presim aq gjatë, jo shko andej dhe shko këtej*

*..nuk kemi më moshën për të bredhur ....”*

*“Kam pasur një rast kur kam qenë shumë keq dhe më ka rënë të fikët , më kanë çuar me urgjencë në spital , këta të qendrës më kanë çuar dhe tek qendra shëndetësore këtu afër .Jam shtruar dhe në spital dhe nuk më kanë dhënë raport mjekësor”*

*“Kam kaluar Covidin. Kam marrë vetëm recetën nga mjeku i familjes. Kam blerë ilaçet vetë. Nuk më ka rimbursuar asgjë shteti. Të gjitha shpenzimet i kam hequr vetë . Nëse nuk do më ndihmonte vëllai do kisha vdekur tani, se nuk kisha lekë të blija ilaçet”*

### **Zakonet e shëndetshme të të ngrënit**

Të moshuarit theksuan rëndësinë e ngrënies së ushqimit të shëndetshëm, por edhe pamundësinë ekonomike për të përballuar një gjë të tillë.

*“Po të mos ishte ushqimi i qendrës, nuk e di se çfarë mund të ishte bërë me mua. Do të vdisja...”*

*Me 70. 000 lek pension, ku 16.000 paguaj faturën, pjesa tjetër ujë e drita, mendoje vetë sa më bie të blej ushqim, jo më ushqim të shëndetshëm.”*

Pjesëmarrësit shprehen se nuk kërkojnë ndihmë tek familjarët/fëmijët (nëse kanë) duke i justifikuar me faktin se po të kishin do i ndihmonin vetë.

*“Nuk i bëhem havale askujt unë. Kush të mundet, e di vetë që unë kam nevojë, qoftë edhe për një kile miell”*

### **Parandalimi i plakjes**

Profesionistët e identifikuan një çështje të tillë si shumë të rëndësishme. Ata theksuan se në kontekstin kulturor duhet të bëhet shumë për të ndryshuar perceptimin që ne kemi për plakjen.

*“Unë kam mamin tim, sapo mbushi 50 vjeçe, tha tani unë u plaka. Priste nga të tjerët dhe ajo filloi të ankohej. Duhet të mësohemi me një jetë më aktive, jo s dentare. Ne rrimë shumë në kafe.”*

Të afërmit theksuan se të moshuarit nuk ka të bëjë vetëm me moshën, por edhe me mënyrën se si vetë individi e percepton jetën e tij. Nëse do të donim që të plakeshim mirë duhet të punojmë që në rini për këtë moshë të jetës. *“çfarë ke mbjellë, do korrësh”*

### **Të pasurit e një pamjeje të mirë fizike.**

Interesante në studim ishte evidentimi i një teme të tillë si një nevojë shumë e rëndësishme për perceptimin e vetes. Kujdesi për pamjen e jashtme, pavarësisht kushteve ekonomike, është çështje kulturore. Në përgjithësi me kalimin e moshës, duket sikur edhe pamja e jashtme, kujdesi për flokët, veshjet, fytyrën, masën trupore, e humbasin rëndësinë. Në të vërtetë pjesëmarrësit në studim theksuan faktin se është një nevojë shumë e rëndësishme krijimi i kushteve të përshtatshme për të pasur një pamje të mirë fizike. *“Kur dukesh bukur, duket sikur edhe të tjerët të vlerësojnë më shumë”.*

## **NEVOJAT PSIKO-EMOCIONALE**

### **Ndjenja e gëzimit dhe kënaqësisë**

Të moshuarit, por edhe të afërm kujdestarë dhe profesionistë theksuan që të gjithë kanë nevojë të përjetojnë ndjenja gëzimi e kënaqësie. Në mirëqenien e të moshuarve, përjetimi i emocioneve pozitive iu jep kuptim jo vetëm ditëve, por vetë ekzistencës së tyre. Gëzimin/kënaqësinë në përgjithësi e lidhin me familjen, të pasurit afër tyre, të shëtimit, të realizuarit të aktiviteteve të përbashkëta me njëritjetrin, të mbledhurit në qendër e të ndarit të së përditshmes së bashku. *“Të takojmë fëmijët, mbesat nipërit, të dalim me ta, të kujdesemi për ata- kjo do të më gëzonte.”*

Të moshuarit diskutuan gjithashtu për rëndësinë e të jetuarit në të tashmen, pa menduar brengat nga e kaluara apo duke pasur frikë për të ardhmen, se çfarë do të ndodhë.

Ajo që u theksua në këtë studim ishte fakti që të moshuarit mund të kënaqen me shumë pak. Ata kërkojnë vëmendje, respekt, vlerësim dhe mirënjohje. Por, shumë pak prej këtyre elementëve i përjetojnë. Kanë problem kur dalin, kur udhëtojnë me autobus, kur shkojnë te mjeku i familjes apo te mjekët specialistë. Ndjejnë se përçmohen, nënvlerësohen dhe kjo iu ngjall shumë herë trishtim e iu mohon kënaqësinë. Mirënjohja u diskutua nga të gjitha grupet.

*Ne vuajmë për pak humanizëm, të marrim dashamirësi, sjellje dinjitoze njerëzore nga të tjerët. Është zhdukur njerëzimi. Është kthyer egërsia”*

### **Qëndrimi i pavarur**

Të moshuarit e vlerësonin si të rëndësishme pavarësinë dhe rehatinë në pleqëri. Autonomia u pa si thelbësore për të gjithë të moshuarit; një pjesë e të moshuarve e lidhnin autonominë me të qenit në

gjendje të lëvizin, ndërsa të tjerët biseduan rreth qëndrimit të pavarur dhe rutinave kryesore ditore.

*“E kemi të pamundur të funksionojmë vetë. Unë kam vështirësi në të lëvizur. Për punë as nuk bëhet fjalë. Shyqyr që kam vëllanë e nusen e tij që vinë çdo 10 ditë e më pastrojnë. Ndryshe, nuk e di çka do ishte bërë me mua. Ardhjen në qendër e kemi si angazhim. Rutina jonë është njësoj çdo ditë.”*

Pjesëmarrësit në studim shprehen se është shumë e rëndësishme që në vlerësimin e nevojave për të moshuarit të konsiderohet dhe aftësia e tyre për të qëndruar në shtëpi. Shumë prej të moshuarve do të donin të qëndronin aty, por ju mungon dikush që të mund t’i shoqërojë për të bërë pazarin, vizitat mjekësore, për t’i pastruar, etj. Pamundësia për ti përmbushur këto lloj nevojash vetë i bën ata të ndjehen të pavarur dhe të shikojnë se kush mund t’i ndihmojë.

### **Qëndrimi vigjilent**

Të afërmit dhe profesionistët theksuan faktin se ndonjëherë të moshuarit me të cilët ndërveprojnë e humbasin rrjedhjen e mendimit, tregohen konfuzë, harrojnë apo ngatërrojnë ngjarje/situata.

*“Shpesh herë jemi duke folur me ta, duket sikur janë duke të dëgjuar, kur krejt papritur të bëjnë një pyetje që tregon qartë se as nuk e kanë mendjen te ti apo tek ajo që ti je duke ndarë me ta”*

Edhe të moshuarit ndajnë të njëjtin shqetësim. Disa prej tyre shprehen se kanë filluar të kenë frikë se mos të asfiksohen e do të vdesin.

*“Në dimër ngrohem me gaz. Nuk fle rehat se kam frikë se mos nuk e kam mbyllur.”*

*“Më ndodh shpesh herë që kur jam në fund të shkallëve kujtohem nëse e kam mbyllur apo jo derën. Mendo, në këto situata, detyrohem të ngjis përsëri shkallët e të kontrolloj”.*

### **Qëndrimi pozitiv**

Shumë të moshuar, nga rrethanat e jetës, janë të detyruar të përballen me vetminë e stigmën. Kjo shpeshherë i mërzit, i zemëron dhe i detyron të përfshihen në një situatë mosbesimi për të ardhmen.

*“Disa herë ia kam uruar vdekjen vetes. Është e rëndë pleqëria. Ne e duam jetën, por jo këtë jetë... pa të afërm afër, pa kujdes, pa mbështetje...”*

### **Probleme që lidhen me shëndetin e mirë mendor.**

Ruajtja e mendjes theksohet në studim si element i rëndësishëm. Nevoja për të pasur një shëndet të mirë mendor lidhet fillimisht me diagnostikimin e hershëm të ndonjë sëmundje specifike që mund të kesh. Të gjithë bien dakord që parandalimi funksionon, sikurse edhe trajtimi i hershëm i bën pasojat e pleqërisë më të lehta për tu përballuar.

*“Shuma pak vëmendje ka në këtë aspekt të nevojave për të moshuarit. Shpesh herë ata perceptohen si të rrjedhur. Në eksperiencën time, ka shumë të moshuar që mes të tjerash kanë probleme të shëndetit mendor të pa trajtuara.”*

*“Kemi të tillë në qendër. Nuk dimë shumë shpesh si të veprojmë me ta. Duhet të ketë qendra të veçanta për trajtimin e tyre”.*

## **NEVOJAT SOCIALE DHE EKONOMIKE**

### **Marrëdhëniet me familjen**

Në fokus grupet me të moshuarit, ata vetë e vlerësuan rëndësinë e familjes dhe e panë atë si thelbësore në mirëqenien e tyre. Kur të moshuarit folën për rëndësinë e familjes, nënvizuan faktin që të funksionojnë në mënyrë optimale do të donin jo vetëm afër vetes familjarë, por edhe vetë mjedisin familjar, shtëpinë e tyre, orëditë, kujtimet.

Të gjithë pjesëmarrësit në studim theksuan se për një plakje të shëndetshme, të moshuarit do të preferonin të kalonin ditët e tyre në shtëpinë e tyre. Ato diskutuan mbi mjetet ndihmëse për ta bërë jetën e përditshme më të lehtë dhe për të qenë në gjendje më të mirë që të funksionojnë në mënyrë të pavarur. Të moshuarit përmendën se aksesit në teknologji ua ka lehtësuar komunikimin me familjarët e të afërmit, sidomos gjatë periudhës së pandemisë.

*“Jetoj vetëm. Dhe ata që të donin, nuk të duan më kur je i vetmuar”*

*“Janë zbehur marrëdhëniet. nuk kam kontakte , jetojnë jashtë shtetit dhe më kanë harruar.*

*Nuk të telefonojnë. Të tregojnë me gisht”*

*Vetmia të shkakton një mërzi. Komunikoj me djalin që është në Gjermani. Familjarët nuk të shikojnë fare*

### ***Marrëdhëniet shoqërore***

Të moshuarit e perceptuan socializimin me bashkëmoshatarët si diçka thelbësore në mënyrë që të funksionojnë në mënyrë optimale. Ata përmendën që përfshirja në aktivitete të përbashkëta si p.sh. duke shijuar vaktet me të tjerët janë të rëndësishme. Të moshuari gjithashtu folën për rëndësinë e të pasurit të një rrjeti social dhe të qenit i rëndësishëm për të tjerët në mënyrë që të funksionojë në mënyrë sa më optimale të jetë e mundur.

Të qenit i aftë për t'u përfshirë në aktivitete u konsiderua si e rëndësishme për të tri grupet e pjesëmarrësve, p.sh. duke marrë pjesë në aktivitete kulturore, aftësia për të përjetuar gjëra të reja, përjetimi i natyrës dhe shijimi i ushqimit të shijshëm ishin thelbësore. Gjithashtu, të moshuarit dëshironin të përfshiheshin edhe në veprime mirësie, duke ofruar kujdes për të tjerë të moshuar ose jo që mund të kenë nevojë për shërbimet e tyre. *Do të ishte shumë mirë sikur të kishim mundësi të dilnim, të organizoheshim, të shkonim të vizitonim qytete të ndryshme të Shqipërisë.*

*Vijmë këtu në qendër e luajmë domino me njëri-tjetrin, por vetëm kaq.*

*Na rrofshin këta të qendrës që na bëjnë aktivitete te ndryshme, sociale, sportive këtu në qendër, dhe nga liqeni na kanë çuar, ne kemi nevojë për më shumë aktivitete argëtuese dhe sociale po nuk kemi para që të shkojmë .*

### ***Komunikimi dhe informacioni***

Në aspektin e komunikimit ata vlerësuan se edhe nëpërmjet heshtjes ata komunikojnë shumë. Të moshuarit thanë se jeta iu ka mësuar se të bërtiturit nuk është mënyra më e mirë për të zgjidhur çështjet që mund të jenë shqetësuese. *Shyqyr që kemi të njohur këtu. Flasim e diskutojmë bashkë. Televizori rri gjithë ditën ndezur te unë. Më duket sikur flas me të.*

*Kam një telefon fiks, që e kam pasur që herët. Atë numër më dinë të gjithë. Por vetëm shoqet kujtohen. Asnjë i afërm.*

## **AKSESUESHMËRIA DHE SHËRBIMET NDAJ TË MOSHUARVE**

### ***Hapësira dhe transporti***

Të moshuarit theksuan se sa i rëndësishëm është mjedisi brenda shtëpisë, po aq i rëndësishëm është dhe mjedisi i jashtëm. Pjesëmarrësit/et përmendën se në mirëqeninë e një individi ka një ndikim shumë të madh mjedisi i jashtëm, lehtësirat në rrugë e trotuare, transporti urban, aktivitetet shoqërore, miqtë dhe shokët, banesa me lehtësira në pjesën e arkitekturës (të moshuarit që jetojnë në katëin e pestë të një pallati të vjetër, ku nuk ka ashensor, e kanë shumë të vështirë të dalin e të plotësojnë nevojat e tyre), etj.

*“Ka shume trafik , zona të gjelbëra nuk ka fare dhe ne nuk kemi më ku të dalim .. janë bërë vetëm pallate .. E si ka qenë Tirana në kohën tonë .. kishe qejf të dilje.. tani është bërë për turp të zotit, vetëm beton e ndërtesa. Pjesëmarrësit në studim theksuan faktin që nuk ka mjedise miqësore për të moshuarit, sikurse nuk ka infrastrukturë për ta. Mezi dalim. Kur shkoj te mjekja, unë e di si i ngjis shkallët.*

## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

### ***Përfundime***

- Nevojat e të moshuarve janë të ndërlikuara dhe kërkojnë një qasje të integruar ndër sektoriale për t’u adresuar në mënyrë efektive. Në Shqipëri mungojnë të dhëna të detajuara dhe studime sistematike që analizojnë nevojat për shërbime sociale në moshë të tretë, veçanërisht për ata që preferojnë të qëndrojnë në banesat e tyre dhe të përfitojnë shërbime në shtëpi.
- Të moshuarit përfaqësojnë një grup me rrezik të lartë për përjashtim social dhe mbeten të nënshërbyer nga sistemi aktual i shërbimeve sociale, veçanërisht ata që kanë aftësi të kufizuara ose që jetojnë të vetëm. Shumica shprehin dëshirën për të qëndruar në ambientet familjare, të cilat përfaqësojnë siguri psikologjike dhe lidhje emocionale.
- Pushteti vendor ka një rol thelbësor në hartimin dhe zbatimin e shërbimeve të kujdesit në komunitet. Legjislacioni për vetëqeverisjen vendore (Ligji nr. 139/2015) dhe ai për shërbimet e kujdesit shoqëror (Ligji nr. 121/2016) theksojnë detyrimin e njësive administrative për të garantuar akses të barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe të moshuarit.
- Në nivel vendor, njësitë për vlerësimin dhe koordinimin e nevojave, të parashikuara për çdo njësi administrative, ende nuk janë funksionale në masë të plotë. Përkundër kësaj, në vitet e fundit janë regjistruar përpjekje për zgjerimin e ofertës së shërbimeve, shpesh në bashkëpunim me sektorin jo-fitimprurës. Qendrat komunitare po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në promovimin e përfshirjes sociale dhe në ofrimin e ndihmës bazë.
- Nga këndvështrimi i të moshuarve, sfidat shëndetësore dhe humbja e pavarësisë janë faktorët kryesorë që ndikojnë në cilësinë e jetës dhe qëndrimin e tyre në banesë. Ata theksojnë nevojën për prani të profesionistëve të specializuar që t’i ndihmojnë jo vetëm në aspektin shëndetësor, por edhe në përfshirjen sociale dhe aktivitetet e përditshme.
- Zbatimi i projekteve pilote për shërbime të kujdesit në familje konsiderohet një hap strategjik për të testuar modelet e mundshme të ndërhyrjes dhe për të krijuar bazën për një shtrirje të mëtejshme të këtyre shërbimeve në shkallë vendi.
- Krijimi i ekipeve ndërdisiplinore, të përbëra nga infermierë, punonjës socialë, psikologë dhe specialistë të gjeriatisë, është thelbësor për të garantuar ofrimin e një shërbimi gjithëpërfshirës dhe për të shmangur fragmentimin e ndërhyrjes vetëm në dimensionin mjekësor.
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mbetet një komponent kyç për rritjen e kapaciteteve profesionale në vlerësimin e nivelit të varësisë tek të moshuarit, hartimin e planeve të individualizuara të kujdesit dhe monitorimin efektiv të procesit të përkujdesjes.

### ***Rekomandime***

- Rekomandohet realizimi i një procesi sistematik të hartëzimit të nevojave të të moshuarve dhe

familjarëve të tyre, bazuar në një qasje holistike dhe ndërdisiplinore. Një vlerësim i tillë do të mundësonte hartimin dhe zbatimin e projekteve të mirë-strukturuara, të afta për të adresuar nevojat reale dhe të shumëfishta të kësaj kategorie popullore.

- Është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të realizojnë një vlerësim të plotë dhe të koordinuar mbi shërbimet e integruara që i nevojiten të moshuarve. Siç tregon edhe ky studim, nevojat e tyre janë komplekse dhe kërkojnë ndërhyrje të koordinuar nga një spektër profesionistësh – përfshirë ata të fushës së shëndetësisë, shërbimeve sociale, psikologjisë dhe gjeriatisë. Për më tepër, projektet infrastrukturore duhet të përfshijnë komponentë që adresojnë aksesin dhe sigurinë për të moshuarit.
- Të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të moshuarve nuk janë të informuar në mënyrë të plotë për shërbimet që ofrojnë qendrat komunitare. Prandaj, sugjerohet zhvillimi i seancave të rregullta informuese në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Tiranë, me qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimin dhe aksesit ndaj shërbimeve ekzistuese.
- Është e rëndësishme të ndërtohen mekanizma të qartë orientimi për të moshuarit dhe familjarët e tyre, lidhur me institucionet publike ku mund të drejtohen për ndihmë, si dhe me funksionet dhe kompetencat e secilit institucion në fushën e përkujdesjes sociale.
- Rekomandohet forcimi i kapaciteteve të profesionistëve që veprojnë në nivel lokal, përmes trajnimeve të specializuara dhe të vazhdueshme që promovojnë një qasje gjithëpërfshirëse në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të të moshuarve.
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale duhet të shoqërohet me një rritje të qëndrueshme të burimeve njerëzore në sektorin e shërbimeve sociale, për të siguruar mbulim adekuat dhe cilësi të lartë të ndërhyrjeve, në përputhje me standardet bashkëkohore të përkujdesjes sociale.

## REFERENCA

- Athenosy, L., & Revenco, V. (2014). *Ageing populations in Europe: Challenges and opportunities for the CEB*. Council of Europe Development Bank. <https://coebank.org>
- Barrett, J., & Kirk, S. (2000). Running focus groups with elderly and disabled elderly participants. *Applied Ergonomics*, 31, 621–629.
- Bloom, D. E., Canning, D., & Fink, G. (2012). *Population aging and economic growth* (Commission on Growth and Development, Working Paper No. 32). <https://www.upenn.edu>
- Dharmo, E., & Koçollari, N. (2014). Older people quality of life. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 5(13), 385–390.
- Eurostat. (2021a). More than a fifth of the EU population are aged 65 or over. <https://ec.europa.eu>
- Eurostat. (2021b). *Ageing Europe - Statistics on population developments*. <https://ec.europa.eu>
- HelpAge International. (2015). *Global AgeWatch Index 2015: Insight report, summary and methodology*. <https://www.helpage.org/global-agewatch/>
- INSTAT. (2015). *Plakja e popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri*. <https://www.instat.gov.al>
- INSTAT. (2019). *Population projections 2019–2031*. <https://www.instat.gov.al>
- INSTAT. (2023). *Population and housing data*. <https://www.instat.gov.al/en/themes/population/>
- Ministry of Health and Social Protection. (2019). *National Action Plan on Ageing 2020–2025*. MoHSP.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2023). *Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2023–2030*. <https://shendetesia.gov.al>
- MOSHA. (2017). *Raport studimi: Vlerësimi i kushteve social-ekonomike, pjesëmarrjes shoqërore dhe gjendjes shëndetësore të të moshuarve në Shqipëri*. <https://mosha-network.org/>
- Oliveira, A. M. S., & Pedreira, L. C. (2012). Being elderly with functional dependence and their family caregivers. *Acta Paulista de Enfermagem*, 25(spe1), 143–149. <https://doi.org/10.1590/S0103-21002012000800022>
- Podgorica, N., Zenelaj, B., Deufert, D., Ganner, M., & Flatscher-Thöni, M. (2020). A narrative review on legal aspects

of older people in Albania. *Journal of Educational and Social Research*, 10(5).

- United Nations. (2015). *World population ageing 2015*. United Nations, Department of Economic and Social Affairs.
- UN DESA. (2023). *World Population Ageing 2023: Highlights*. <https://www.un.org/development/desa/pd/>
- Kuvendi i Shqipërisë. (2016). Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. <https://qbz.gov.al>
- Qeveria e Shqipërisë. (2018). Vendimi nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial...”. <https://qbz.gov.al>

Falënderime të veçanta recensentëve të artikujve të këtij numri të revistës LOGOS.

Prof. Asoc. Ridvana Mediu

Dr. Emira Spahaj

Dr. Dorina Minxuri

Prof. Erleta Çelmeta (Mato)

Prof. Asoc. Agim Muça

Prof. Asoc. Pranvera Kamani

Prof. Asoc. Edo Sherifi